

JANI THOMAJ

## NJË KLASIFIKIM I FRAZELOGJIZMAVE ME VLERË NDAJFOLJORE NË GJUHËN SHQIPE

Një ndër tipat më të pasur të frazeologjizmave gjuhësorë në shqipe është edhe ai ndajfoljor. Në një vështrim të përgjithshëm mbi problemet kryesore të frazeologjisë shqipe<sup>1</sup> e kemi përmendur edhe këtë, ku, përveç që e kemi ndarë si tip më vete, kemi dhënë edhe disa veçori të përgjithshme të strukturës formale e semantike të llojeve më të zakonshme. Tani në këtë punim po përpigemi të japim një klasifikim, i cili e përfshin më gjerë frazeologjinë ndajfoljore të shqipes. Gjer më sot ky klasifikim, si dhe për tipat e tjerë të frazeologjizmave, ka munguar. Ndërkaq na duket se ai është i nevojshëm, jo vetëm për të kuptuar strukturën dhe vlerën semantiko-funksionale të frazeologjizmave, por edhe për t'i shërbyer praktikës mësimore në hartimin e teksteve dhe në paraqitjen e materialit përkatës. Është thënë edhe më parë<sup>2</sup> që disa gramatikanë shqiptarë, ndërmjet «shprehjeve», «frazave», ose «lokucioneve» të përmendura në gramatikat e tyre, kanë rreshtuar edhe nga ato me vlerë ndajfoljore, si *shkel e shko*, *vesh më vesh*, *për fat të mirë*, *për fat të keq*, *shend e verë*, *orë më orë*, *ditë më ditë*, *javë për javë* (Cipo, S 22, 74, 81<sup>3</sup>), *kokë për kokë*, *që sot e kësaj dite* (Domi, S 91, 101) etj. Padyshim, këta autorë kanë vështruar **funksinin** gramatikor të këtyre togjeve dhe, duke ecur në këtë udhë, nuk kanë pasur parasysh edhe anë të tjera, që nuk lejojnë të përfshihen në një grup togjet e mësipërme me të tilla, si *alla turka*, *alla frënga*, *përmbys*, *për djallë*, *me të shpejtë*, *dy herë në ditë*, *mbë kalë*, *mbë këmbë*, *me kënaqësi*, *me të gdhirë*, *me guxim*, *me djallëzi* (Cipo, po aty). Përkundrazi, për një klasifikim të drejtë e të plotë të frazeologjizmave ndajfoljorë, si të çdo tipi tjetër, nuk mjafton vetëm një tipar, qoftë edhe funksioni, që është me aq rëndësi. Përveç këtij, këtu duhet të vlerësohen mirë edhe anë të tjera si **kuptimi**, **struktura**, **karakteri idiomatik** dhe mundësia e formimit të një **modeli** prodhues. Ana funksionale, së bashku me kuptimin tipësor kategorial, i grupon frazeologjizmat vetëm në plan të përgjithshëm leksiko-gramatikor dhe në këtë drejtim ato janë bazë për klasifikimin në tipat kryesorë: frazeologjizma emërorë, mbiemërorë, foljorë e ndajfoljorë. Përveç kësaj, vlera semantiko-funksionale është tipar themelor (bashkë me strukturën dhe karakterin idiomatik) për veçimin e frazeologjizmave gjuhësorë prej frazeologjisë letrare (proverbave, gjëzave etj.), togjeve të lira, fjalive dhe

1) Shih *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF 1964, II, 69-94, dhe *Probleme të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe*, SF, 1964, III, 55-75.

2) Shih *Probleme të frazeologjisë...*, SF, 1964, II, 72 v.

3) Për *orë më orë* etj. K. Cipo shënon edhe se tregojnë periodicitetin e kohës (po aty 74).

«lokucioneve» gramatikore (ndajfoljore, parafjalore, lidhëzore etj.). Në këtë pikë ende ka paqartësi, kur ngatërrohet çështja e kuptimit të një frazeologjizmi në krahasim me fjalën sinonime, me kuptimin tipësor kategorial dhe anën funksionale<sup>4</sup> të frazeologjizmave gjuhësorë e të fjalëve, që del në shesh brenda vargut të njësive gjuhësore bazë: **tingull-morfemë-fjalë-togfjalësh-fjali**.

Në vijën kryesore të këtij punimi do t'i përmbahemi mendimit që togjet frazeologjike janë ekuivalentë të fjalëve nga **funkzioni** si njësi të gjuhës dhe nga kuptimi tipësor kategorial, e kjo i dallon edhe togfjalëshat frazeologjikë «predikativë» prej fjalisë. Në këtë kuptim vlerën e fjalës e kanë edhe frazeologjizmat ndajfoljorë, gjë që i bën ata ekuivalentë me ndajfoljet, kurse në fjali marrin një funksion gramatikor të caktuar, të plotësorit. Përkundrazi, nga kuptimi mund të ketë ndërmjet tyre dallime, megjithëse këto dallime janë të tilla që nuk e prishin raportin sinonimik, në kuptimin e gjerë të termit<sup>5</sup>.

Në këtë punim nuk janë marrë në studim «lokucionet» ndajfoljore me strukturë **fjalë shërbyese + fjalë shënuese**, si *me këmbë, nën dorë, me një frymë, nën gunë, nën hundë, nën lëkurë, nën rrogöz, në tym, ndër sy, pas shpine, prapa diellit, prapa krahëve, për një qime etj.* Është e vërtetë që këto «lokucione» kanë karakter idiomatik, të fituar nëpërmjet një shndërrimi figurativ të kuptimit, dhe që janë ekuivalentë të ndajfoljeve të thjeshta *keq, fshehurazi, shpejt, kot, haptazi, larg etj.* (me dallime në përmbajtje dhe në vlerën ekspresive). Duke u nisur prej kësaj baze disa autorë i kanë përfshirë këto lokucione në grupin e frazeologjizmave gjuhësorë<sup>6</sup>. Në këtu i përmbahemi mendimit, të shprehur edhe më parë<sup>7</sup>, se një nga tiparet kategoriale, ndërmjet tipareve të tjera të domosdoshme, të frazeologjizmave është struktura e tyre e barabartë me një togfjalësh, në kuptimin gjuhësor të termit, d.m.th. përbërja prej jo më pak se dy fjalësh shënuese<sup>8</sup>. Duke pranuar këtë, mendojmë se «lokucionet» e sipërhënuara nuk mund të trajtohen si frazeologjizma, sepse:

4) Ndryshe nga kuptimi gramatikor i termit *funksion*, këtu me këtë term kemi parasysh atë vlerë që ka një njësi gjuhësore bazë (tingulli, morfema, fjala, togfjalësh, fjalia) në lidhje me njësitë e tjera, që formojnë një sistem mjetesh me të. Brenda këtij sistemi, njësia prej njësisë dallohet nga ky funksion (p.sh. fjala dhe frazeologjizmi kanë funksion emërtues, shprehin një nocion, fjalia ka funksion komunikues etj.). Përveç barazisë nga funksioni, në këtë kuptim të termit, fjala dhe frazeologjizmi janë ekuivalentë edhe nga kuptimi tipësor kategorial, d.m.th. që të dyja këto njësi kanë kuptim unik (në këtë rast edhe frazeologjizmi ka një kuptim, unik, megjithëse përbëhet nga 2-3 gjymtyrë). Përkundrazi, kur krahasohen kuptimet e mëvetësishme të një frazeologjizmi me të fjalës koresponduese (sinonime), mund të ketë ndryshime të tilla (nuanca, shprehësi, ngarkesë emocionale etj.), që nuk lejojnë të flasësh për identitet të plotë ndërmjet tyre. Këto ndryshime përcaktojnë edhe bashkëpërdorimin e fjalës e të frazeologjizmit në gjuhë, me veçoritë përkatëse, d.m.th. në raporte sinonimike.

5) Shih edhe V. N. Telija, *O terminje «frazema»*, në «Problemy lingvističesko-vo analiza», M. 1966, f. 188: «togjet idiomatike... janë ekuivalentë funksionalë të fjalëve». Gjithashtu shih edhe T.A. Djegterjova, *Puti razvitiya sovremjenoj lingvistiiki*, M. 1964, III, f. 183: «... Shprehjet frazeologjike linden, si rregull, si sinonime përshkruese të fjalëve dhe shprehjeve që tashmë ekzistojnë në gjuhë, por nga kjo gjë nuk janë të tepërta, sepse dallohen për një karakter emocional më të lartë, i cili i rrit mundësitë komunikative të gjuhës».

6) P.sh. për rus, A. I. Mollotkov, *Frazeologizmy ruskovo jazyka i principy ih leksikografičeskovo opisanja* në «Frazeologičeskij silovar ruskovo jazyka», M.1967,17.

7) *Probleme të frazeologjisë...*, SF, 1964, II 81-82.

8) Shih edhe S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*.

1. Këto «lokucione» nuk kanë në strukturën e tyre së paku dy fjalë shënuese. Në rastet e dhëna na duket se te fjala shërbyese (parafjala) mbizotëron vlera e një «formanti gramatikor kompensator», d.m.th. ajo shërben për të shprehur, së bashku me mbaresat e fjalës kryesore, ato marrëdhënje gramatikore, që s'arrin t'i shprehë vetëm fjala me treguesit gramatikorë enklitikë (me mbaresat rasore). Nga pikëpamja gramatikore del se në këso rastesh kemi, si të thuash, vetëm një fjalë në një trajtë të caktuar (p.sh. në rrjedhore ose kallëzore), e cila po nga pikëpamja gramatikore është e barabartë në funksion me trajtat e tjera (p.sh. me rrjedhoren ose kallëzoren pa parafjalë, me dhanoren etj.) ose në krh. me një gjuhë tjetër i korespondon një trajte rasore pa parafjalë. Në shqipe, me sa duket, vetëm rasat dhanore e gjindore arrijnë të shprehin me treguesit gramatikorë enklitikë, pa ndihmën e parafjalëve, gjithë marrëdhënjet që mbajnë përsipër (për gjindoren si një farë kompensatori mund të merret dhe nyja e përparme). Rasat e tjera, përkundrazi, kanë nevojë për mjete të tjera gramatikore, si parafjalët. Po t'i mbahemi këtij mendimi, atëherë nga pikëpamja frazeologjike **pas shpine, prapa diellit** etj. janë fjalë, vërtet me karakter idiomatik, por jo frazeologjizma, sikurse nuk janë të tillë as fjalët e veçanta «(e di) *ujë* (mësimin)», «(bredh) *udhëve*» etj.

2. «Lokucionet» *me këmbë, nën dorë* etj. janë pothuaj që të gjitha rezultat i një reduktimi, rrjedhojë prej konstruktesh të plota frazeologjike, si *merr me dorë e jep me këmbë* (ose *e priti me këmbët e para*), *jap nën dorë, e tha me një frymë, fsheh nën gonë, i shkoi nën hundë, e ka* (djallëzinë) *nën lëkurë, ja shkoi ujët nën rrogoz, flas* (turrem) *në tym, sy ndër sy, ja ngul thikën pas shpine, shko prapa diellit, flas prapa krahëve, e gjeti për një qime* etj. Pas një cungimi të jashtëm (strukturor) dhe një ngjeshjeje (kompresimi) të brendshme (semantike) njësitë që kanë dalë, kanë marrë mbi vete gjithë peshën kuptimore të frazeologjizmave të mëparshëm, por nuk janë më frazeologjizma, sepse nuk kanë më të gjitha tiparet kategoriale të frazeologjisë, në radhë të parë tiparin strukturor. Po kjo gjë ndodh edhe te *u a mbathi* (< *u a mbathi këmbëve*), *s'ja var* (< *s'ja var torbën*), *s'ma pret* (< *s'ma pret koka*) etj.

Frazeologjizmat ndajfoljorë të shqipes janë ekuivalentë të njësive njëfjalëshe ndajfoljore, sepse sikurse këto tregojnë nocione të kohës, të mënyrës etj., d.m.th. nocione të cilësisë së veprimeve ose të rrethanave, në të cilat kryhen këto veprime. Kjo kushtëzon edhe karakteristikat gramatikore të tyre: ata plotësojnë foljet, emrat foljorë dhe pjesoret e nyjëzuara, me të cilat lidhen, dhe **për pasojë** në sintaksë kryejnë funksione të caktuara, të plotësve të mënyrës e të rrethanës.

Në klasifikimin e tanishëm të grupit të madh të frazeologjizmave ndajfoljorë të shqipes kriter bazë, si më i lehtë dhe më praktik, është mbajtur ana strukturore, por në mënyrë të pashkëputur nga ana semantike-funksionale. Kjo bëhet jo se struktura është tipar më i rëndësishëm se përmbajtja, por sepse është ana më e dukshme dhe, siç na del nga të përmblodhur të frazeologjizmave në tipa, megjithëse në përgjithësi është e vështirë që në frazeologji të flasësh për **tipa** në kuptimin gjuhësor të

SF 1968, I: «Një togfjalësh përbëhet së paku prej dy fjalësh, por jo prej dy fjalësh çfarëdo, por prej dy fjalësh shënuese. Ky është togfjalëshi i thjeshtë, fjalët shënuese janë gjymtyrët e tij, ndërsa fjalët shërbyese (nyjat, parafjalët etj) janë, krahas trajtave të fjalëve, mjetet e lidhjes së togfjalëshit, por jo gjymtyrët e tij», f. 76. Shih edhe O.S. Ahmanova, *Silovar lingvističeskikh terminov*, 1966, 426 te «Slovo-soçetanije... 1. Bashkim i dy ose më shumë fjalëve shënuese...».

termit. Prandaj shpeshherë jemi të detyruar të analizojmë edhe raste të veçanta frazeologjizmesh, të cilët është vështirë t'i gruposh, të paktën në çifte.

Mbi bazën e këtyre kritereve dhe të materialit konkret, frazeologjizmat me funksion ndajfoljor të shqipes i kemi ndarë në dy grupe të mëdha: frazeologjizma me lidhje të jashtme (sintagmatike) të pashprehura dhe frazeologjizma me lidhje të jashtme (sintagmatike) të shprehura. Duhet thënë që, megjithëse ky kriter i ndarjes në dy grupe të mëdha është mbështetur në një veçori të jashtme të frazeologjizmave, ai e lehtëson shumë punën e klasifikimit. Gjithashtu ai gërshetohet edhe me tipare të vetë frazeologjizmave, siç janë mënyra dhe mjetet e shprehjes së lidhjes së tyre brenda sintagmës, elementët nistorë e të brendshëm konstitutivë etj. Padyshim, mbetet një detyrë për të ardhmen që krahas këtij klasifikimi mbi një tipar të jashtëm të frazeologjizmave, të përpunohet ndonjë klasifikim tjetër mbi bazën e strukturës së brendshme semantike e formale të vetë frazeologjizmave.

#### I. GRUPI I FRAZELOGJIZMAVE NDAJFOLJORË ME LIDHJE TË JASHTME (SINTAGMATIKE) TË PASHPREHURA.

Ky grup është relativisht i gjerë, por nga struktura më i thjeshtë se grupet e tjera. Tipar i përgjithshëm i frazeologjizmave të këtij grupi është struktura me përsëritje të një fjale ose me bashkëlidhje të dy fjaleve semantikisht korelative (sinonime, antonime etj.). Frazeologjizmat me përsëritje të së njëjtës fjale dhe më pak ata që formohen nga dy fjale të lidhura semantikisht, përbëjnë nga ana strukturore grupin më të thjeshtë të frazeologjizmave ndajfoljorë, shkallën e parë në fushën e frazeologjisë gjuhësore.

Ky grup në shqipe mund të ndahet më tej në dy nëngrupe të mëdha:

##### A. Frazeologjizma të formuar me përsëritjen e një fjale të vetme.

Format e përsëritjes së kësaj fjale dhe mjetet e mënyrat e lidhjes së brendshme janë të ndryshme. Këto forma, mënyra dhe mjete kanë rëndësi për vlerën dhe kuptimet e ndryshme ndajfoljore të togjeve. Nga lloji i lidhjes së komponentëve dallohen frazeologjizmat me bashkërenditje dhe ata me rënditje të gjymtyrës që përsëritet.

1. **Përsëritje me bashkërenditje.** Këtu mbizotëron bashkërenditja e thjeshtë, me lidhëzën **e**, e një ndajfoljeje të përsëritur, si **anës e anës, fët e fët, fit e fit**<sup>9</sup>, **hollë e hollë, larg e larg, mbarë e mbarë, mirë e mirë, shpejt e shpejt** etj. [«. . qehajaj e pyeti si e kishte hallin me bujqësinë dhe bujku *iu përgjigj anës e anës*». (Xoxa LV III 73); «Sektorë kemi dhe do t'i shtojmë, shoku agronom, *u shkoi kryetari anës e anës*» *fjalëve të agronomit*» (Hosteni, 10. 12. 1968, 6); «Dale ta mendojmë një herë, si *vihet në votë fët e fët*. Mos u nxitoni!» (Marko, AM 358); «Pse, ti kujton se *ndërruan mend fët e fët* miqtë e ngushtë të agajt?» (Marko, AM 74); «Të kishe kruar trutë e të mendoheshe mirë, kur ia dhe dhe jo ma *zgjidhe qesenë ashtu fët e fët*...» (Xoxa, LV II 37); «— Ti e ke larë, o bej, qëkur, me zjarrin që i vure kasolles e sot *jemi fit e fit, as më ke, as të kam ndonjë borxh*... *iu përgjegj Kozi*...» (Xoxa, LV III 32); «Pastaj zanat nisin e *pyesin Mujin hollë e hollë* për nënë e babë, për vëlla e motër, për gjithë

9) Po të pranohen **fët, fit** si ndajfolje, në etapën e sotme të shqipes: e bëri **fët** (= menjëherë); doli **fit** (= baraz).

Jutbinën e Krahinën» (Kuteli, TM 64); «— Ty të tha kështu? /— Të më thosh mua, ja thosh stapi kohës, po e *solli lark e lark*» (Kuteli NT 57); «Atëhere merr grueja e *i difton mbarë e mbarë* gjithçka kishte ba» (PP, I/I 323); «Vajza mbështolli shuk letrën, e *ngjeshi mirë e mirë* me gishta dhe e futi në gojë.» (Nëndori, 1967 IX 86); «Posa të shikosh që të ma kenë çarë trupin, të *marrësh shpejt e shpejt* pjesën e trupit që do të ketë rënë përdhe.» (DK, 64) etj.]

Një rast tjetër i këtij grupi, më i rrallë, është kur si gjymtyrë e dytë ndajfolja përsëritet në shkallë krahasore, si *keq e më keq, mirë e më mirë, thellë e më thellë* etj. [*«Neve mirë e më mirë ata keq e më keq»* (PP, I 230); «.. dalë nga dalë *po qenërisht* pa bërë esap theroritë, *po futej thellë e më thellë* në zemër të Shqipërisë» (Noli, HS 114) etj.]. Mbi bazën e vlerës së gjymtyrës së dytë, këta mund të quhen edhe frazeologjizma me intensifikim.

Këta frazeologjizma përgjithësisht tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit me nuancë të veçanta si të ritmit e të shpejtësisë (*fët e fët, shpejt e shpejt*), të shkallës (*fit e fit, thellë e më thellë*), të ritmit e të mënyrës së mirëfilltë (anës e anës, *hollë e hollë, larg e larg, mbarë e mbarë*) dhe të cilësisë (*mirë e mirë, keq e më keq, mirë e më mirë*).

2. **Përsëritje me nënrenditje.** Këtu një rol të rëndësishëm lot lloji i nënrenditjes dhe mjetet që vënë në lidhje gjymtyrën e përsëritur. Këto mjete me shprehjen e raporteve të caktuara ndikojnë mbi kuptimet ose nuancat që marrin togjet në sistemin e përgjithshëm të togjeve të tjera ndajfoljore. Ato, në kuptim të gjithanshëm, sjellin në konstruktet një ndajfjalë themelore që, së bashku me kuptimin leksikor të fjalëve shënuese, i bën frazeologjizmat shprehës të kohës, të vendit, të mënyrës etj.

Një nga këto mjete është parafjala *më*, me kuptim të përgjithshëm vendor, te togjet *breg më breg, çip më çip, degë më degë, derë më derë, fshat më fshat, gojë më gojë, faqe më faqe, gur më gur, kokë më kokë, krua më krua, ledh më ledh, lug më lug, nofull më nofull, shtek më shtek, vesh më vesh, vërë më vërë* etj. [*«Shkon e breth/ leth më leth, /brek më brek,»* (Çajupi, M 81); «Patën rastin *ta njohin çip më çip botën.*» (Shuteriqi, Ç I 12); «.. iu fut të çajë lumin e *ardhur degë më degë*, sikur desh t'u bëjë pritë me gjoksin e vet dhe të kopesë, valëve të ndërkyera.» (Xoxa, LV II 97); «.. prandaj *dërgoi derë më derë* për të gjetur këtë...» (PP, I 434); «Filloi Mahmuti të *hyjë derë më derë*, në të tri lagjet, bile dhe në Buzë.» (Marko, AM 67); «Këto ngjarje të *dëgjuaara udhë më udhë e vatër më vatër.*» tregojnë një pjesë të margaritarëve të zemrave të njerëzve tanë.» (ZP, 20.2.1969, 2); «.. edhe *dolli vetë fshat më fshat* për të shikuar njerëzit dhe për të bërë listat.» (Noli, HS 35); «Dhe ata, të tjerë, që ishin të njohur të hoxhës dhe që me të flisnin gjëra që nuk i flisnin hapur, i *kishin përhapur gojë më gojë* në fshat.» (Marko, AM 104); «Fjalët *kalojnë gojë më gojë*, ndrashen dhe marrin përpjestime të çuditshme.» (ZP, 18.1.1969, 2); «Për guximin qi un kishë pasun/ **Gur më gur do ta kërktoj**» (KLSH); «Vajza që kishte mësue të kërcente si kecat e *kaloj përroin gur më gur, pa u lagur fare*» (Nëndori, 1967 IX 84). «Ajo e ka zakon *ta shpjerë njerinë krua më krua e të mos i japë ujë.*» (Kuteli, NT 55); «Si u lodh së *bredhuri shteg më shteg e lug më lug.*» Muji u ul i lodhur...» (Kuteli, TM 62); «E *kërkova vend më vend* po s'e gjeta» (Pop.); «Kështu mora prapë atë udhën e gjatë, *duke qëndruar vend më vend.*» (FF, 72); «.. si i hypi kalit, *eci vënd më vënd e mal më mal*, sa arriti natën pa ditur në Egjipt.» (PP, I 355); «Dhe *hapi gojën nofull më nofull*, ca nga gjumi e ca nga çudia.» (Xoxa, LV II 18); «.. *ishte lye* me yndyrë *vesh më vesh.*»

(Nëndori, 1967 IX 82); «Petriti *qeshi vesh më vesh*. Nuk i vinte rëndë nga shakatë.» (Karadaku, RrP 13); «Dëgjua, moj! ... *pëshpëritej vesh më vesh* te pusi i Trokthit.» (Xoxa, LV II 89); «Në këtë çast që *biseda* e të dyve po *rridhte vesh më vesh*.. u dëgjuan, papritur, ca goditje të forta...» (Sinaeri, DP 119); «nga frika iknë të tërë, / *u futnë vërë mbë vërë*.» (Çajupi, M 144) etj.].

Në përgjithësi frazeologjizma të tillë tregojnë vend (**breg më breg, derë më derë, fshat më fshat, gur më gur, krua më krua, ledh më ledh, lug më lug, shtek më shtek, vërë më vërë** etj.). Ideja e vendit jepet me dy lloje mjjetesh: me mjete leksikore — gjymtyrët përbërëse tregojnë vende (**breg, derë, fshat, gur, krua, ledh, lug, shtek, vërë**) dhe me mjete gramatikore — parafjala më (si treguese vendi). Nga ana tjetër, përsëritja i jep gjithë grupit të frazeologjizmave të tillë idenë për një shtrirje të veprimit, për një lëvizje të kudoshme dhe intensive si dhe për zgjerim kufijsh të vendit ku kryhet veprimi, zgjerim pa kufi e pa cak.

Frazeologjizmat e tjerë ruajnë, gjithashtu në kuptim të përgjithshëm, idenë e vendit, por duke e dhënë këtë jo si rrethanë, po si veti të procesit. Për këtë arsye ata janë më afër semantikisht me ndajfoljet e mënyrës (**çip më çip, degë më degë** — në kuptimin e mësipërm, **majë më majë, nofull më nofull, vesh më vesh** — në kuptimin e fundit). Ka të tillë që i mbajnë të dyja kuptimet dhe diferencimi varet nga konteksti (si **degë më degë: kur flet ai hidhet degë më degë // lumi u mbush degë më degë; vesh më vesh; u fëlliq vesh më vesh // flisnin vesh më vesh // vesh më vesh** fjala shkoi deri te ai etj.). Le të krahasohen shembujt e mësipërm me këtë: «Pastaj pa pritur, zuri nga biseda. *U hodh majë më majë e degë më degë* e më në fund tha: ...» (Isufaj, E. 18).

Kuptimet e frazeologjizmit **vesh më vesh** («*u lye* me yndyrë **vesh më vesh**» ose «*qeshte vesh më vesh*» dhe «*fjala u përhap vesh më vesh*» ose *flasin vesh më vesh*») vijnë prej dy bazash të ndryshme të figurës konkrete prandaj ato janë aq të largëta sa në këtë rast mund të flasim edhe për formime të pavarura, me lidhje homonimike ndërmjet tyre. Kështu **vesh më vesh II** lidhet me tipin **gojë më gojë**, krh. f.9.

Një tok frazeologjizmesh ndajfoljorë, me gjymtyrën e dytë të nënrenditur me parafjalën **më**, kanë kuptim të qartë mënyre, pavarësisht nga semantika e veçantë e gjymtyrëve dhe struktura, që janë pothuaj të njëjta me ato të frazeologjizmave të mësipërm. Si gjymtyrë të përsëritur në këtë rast kemi zakonisht një emër dhe më rrallë një ndajfolje. Kështu: «— *Vramë mendjen* sot, gjithë ditën e perëndisë, të dy me Leksin, **kokë më kokë**, porsi ata qetë, që prisnin nën zgjedhë» (Xoxa, LV II 231); «.. i detyruan Shpiragajt të *mbliidhen kokë më kokë* dhe të shikojnë punën e vazdës.» (Xoxa, LV III 60); «Ajo e panjohur i kishte detyruar njerëzit të *mbliidheshin kokë më kokë* e të kërkonin armë, vetëm armë» (Abdihoxha NK 281) — bashkë, së bashku, tok; «*I lëshuan kuajt vrap* në fushën e luftës **tym më tym**» (Kuteli, TM 46) — shpejt, rrufe; «*Fjala shkoi gojë më gojë* e i ra në vesh edhe Pjetër Shinit» (Kuteli, TM 257). «Dhe këto «marifete» dhe «heroizma» pastaj *tregoheshin gojë më gojë* dhe shtoheshin e zbukuroheshin nga ata që kishin më shumë humor e fantazi» (Nëndori, 1968 V 70, krh. edhe **gojë më gojë** f. 7); «*Biseduan gju më gju* për këre çështje, dhanë e muarën me njeri-tjetrin.» (ZP, 15.10.67, 2); «Këtë detyrë do ta kryejnë më mirë ata shkrimtarë, piktorë, muzikantë dhe artistë që *do të rrojnë gju më gju* me popullin, që do ta duan atë me të gjitha forcat e shpirtit të tyre.» (E Hoxha, FKT3); «*Kur vlesh gju më gju* me ta e zë e kuvendon, e ndjen sa shpirt të larmishëm

kanë.» (ZP, 20.2.1969, 2); «Plaka shastiset, po e merr shpejt veten edhe nis e **pyet rrënjë më rrënjë.**» (Kuteli, NT82) — hollësisht, me imtësi; «Ajo i vonon shumë, po **ja lëshon fjalën zjarr më zjarr:** «Mi je zotrote?» (Kuteli, NT 84); «— Ç'domethënë bolshevik? — **ia ktheu i biri flakë më flakë**» (Shuteriqi, Ç I 145) — shpejt, menjëherë; «.. **u pati qëndruar bejlerëve brisk më brisk, dhëmbë më dhëmbë e flakë për flakë.**» (Xoxa, LV II 253); «Revizionistët.. shpallën «të gabuar».. vijën e **luftës thikë më thikë** kundër imperializmit» (ZP, 9.1.1969, 2); «.. ata.. **patën shkuar majë më majë**, së lashti e së voni, me bejlerët e Fierit» (Xoxa, LV III 313); «Por ajo **flitte kot më kot**» (Stërmilli, SD 59) — kuturu, përçart etj. Këta frazeologjizma tregojnë shkallë të ndryshme të mënyrës së veprimit, kryesisht shkallën më të lartë, si **tym më tym, rrënjë më rrënjë, zjarr më zjarr, flakë më flakë, brisk më brisk** etj. Kjo është arritur me anë të zgjedhjes së gjymtyrëve që përsëriten, të cilat shënojnë sende të shpejta, të holla etj., kurse përsëritja e saj në pjesën e dytë me nënrenditje u jep frazeologjizmave kuptim intensiv, si ndajfoljet **shumë, tepër ose fare, krejt** etj. Prandaj këta frazeologjizma mund të përfaqesin nga kuptimi me sipërorët e ndajfoljeve koresponduese, si **shumë shpejt, shumë keq, tepër hollësisht, fare kot** etj.

Shkurt, frazeologjizmat ndajfoljore me përsëritje të nënrenditur me parafjalën **më** tregojnë kryesisht vend, kohë dhe mënyrë, me nuanca të veçanta iterative, intensive, shkalle etj. Mbi bazën e kuptimit themelor të parafjalës **më**, d.m.th. të kuptimit vendor, ngrihet në disa frazeologjizma edhe kuptimi i kohës, si të thuash, kuptimi i «vendit që zë në kohë» veprimi i caktuar.

Vend, kohë e mënyrë tregojnë edhe frazeologjizmat ndajfoljore me përsëritje të nënrenditur me parafjalën **për**, e cila gjithashtu tregon vend, por edhe drejtim të lëvizjes.

Frazeologjizmat ndajfoljore me kuptim të vendit, të ndërthurur me atë të mënyrës, si në rastin me parafjalën **më** edhe në ato me **për** ndërtohen gjithnjë me gjymtyrë emërore: «Besimi ngrihej, vishte gryksen e bardhë të doktorit dhe vraponte derisa **ndeshej ballë për ballë** me fantazmën» (Abdihoxha, NK 60); «Mori të kthejë rrugën, që të mos ndeshej me ta.., kur **u gjend ballë për ballë** me Shpiragajt» (Xoxa, LV III 312); «Shqiptarët **luftuan çap për çap**, duke mbrojtur çdo çip të atdheut» (Noli HS 113); «.. **kishin luftuar** ngaherë **bri për bri**, si një e vetme» (Kuteli TM 111) etj.

Këtu duhet theksuar se frazeologjizmat e këtij grupi kanë kuptim vendor vetëm kur nuk janë në kuptim të figurshëm dhe me karakter të theksuar idiomatik. Ndërkaq ata në përgjithësi kanë prirjen të zhvillohen figurativisht dhe, duke humbur karakterin konkret, duke u larguar nga kuptimi nistor, nuk tregojnë më vend, po mënyrë. Ky proces ende nuk është përfunduar, prandaj disa herë nuk ka qartësi në se frazeologjizmi tregon vend apo mënyrë, si te shembulli i mësipërm me **bri për bri** ose: «Në luftë kush mund të dalë, kush **qëndron ballë për ballë?** (Çajupi, M 126) — «përkundrejt» ose «trimërisht»; «.. kishte frikë nga takimi **ballë për ballë** me axhë Ferhatin» (Xoxa, LV III 226) — **përkundrejt** ose **haptas** etj. Në raste të tjera vlera e frazeologjizmit del më e qartë, si p.sh. «Muji s'guxon të **më dalë ballë për ballë**» (Kuteli, TM 84) — «haptas»; «**Nuk do të luftojmë ballë për ballë, po krah për krah për dheuthin tonë**» (Kuteli, TM 207) — «si kundërshtarë» etj.

Për frazeologjizmat që tregojnë kohë ka një lëkundje tjetër. Ata në përgjithësi ndërtohen, si dhe konstruktet me **me**, me fjalë që shënojnë

kohë, qofshin emra, qofshin ndajfolje si **ditë, natë, javë, orë, vit, çast, sot** etj., me ndonjë ndajfolje tjetër si **aty** dhe me ndonjë ndajfolje pasthirmore, si **fët** etj. Më të thjeshtët janë ata që ndërtohen me ndajfolje, si **sot, aty** etj. «**Aty për aty** *iu kujtua* historia e kallajxhiut të vrrarë në ato livadhe.» (Marko, AM 261); Këshilli antifashist i fshatit *u mblodh aty për aty*» (Nëndori, 1967 IX 65) — «menjëherë»; «**Sot për sot** *s'e bëjmë* bukën tonë, po shpejt do ta bëjmë» (KLSH); «Dërvishi i thotë që **fët për fët** unë *të vras*» (PP I 240) etj. Me këto bashkohen edhe variantet e frazeologjizmeve me **me për/në** (si **flakë për (më, në) flakë** — «menjëherë» etj.), të cilët, siç thamë më lart, shkojnë drejt frazeologjizmeve të mënyrës.

Ndonjë konstrukt me pjesëz pasthirmore (**hë** etj.), duke e vështruar në origjinë nuk mund të përfshihet këtu, meqenëse s'ka komponentë me vlerë kuptimplotë (shënuese) — krh. për këtë f. 4 dhe shënimin 8: «**Hë për hë** Hëna *duhej të strehohej* nëpër vende, që vetëm Erveheja dhe i plotfuqishmi i dinin.» (Marko, AM 327); «**Hë për hë** *ne jemi shumë keq.*» (Abdihoxha, NK 112); «**Hë për hë** *do të jetë siç thoni*, po mos u dëshpëroni se munt nonjë ditë t'i vinjë mendja» (Postoli, LK 77); «Prej tyre **hë për hë** *nuk kërkojnë* që të marrin pjesë në pastrimin e pyllit (AK, 43) etj.

Grupi më i pasur formohet me emrat që tregojnë kohë. Tipare themelore të këtij janë dy:

a) Bashkërisht togjet përmbajnë edhe kuptimin e drejtpërdrejtë edhe atë frazeologjik. Semantema e tyre përmbahet në komponentin që përsëritet, por pa një transformim të figurshëm kjo bazë mbetet përmbajtje reale e një togu me përsëritje të thjeshtë. Kështu është gjendja kur themi, p.sh.: «**Tërë këtë javë, ditë për ditë** kam vajtur në punë»; «**Vit për vit** këtë tokë e kam mbjellë me grurë»; «**Natë për natë** dëgjoj lajmet e fundit» etj., me kuptim «çdo ditë», «çdo natë» etj. Përkundrazi, kur semantema pëson një ndryshim të figurshëm, duke u kthyer vërtet në semantemën e kuptimit tërësor të togut, kuptim që nuk përputhet plotësisht me këtë semantemë, nuk e mbulon në të gjitha pikat atë dhe ka në vetvetë elementë të hiperbolës e të simbolikës, atëhere togu ka kaluar nga një përsëritje e thjeshtë në një frazeologjizëm me përsëritje. Kuptimi i frazeologjizmit përgjithësohet, si të thuash ngrihet në një nivel më të lartë (nga abstraksioni) nga baza ku mbështetet dhe njëzohet, si kuptimi i njëjese njëfjalëshe shpesh, **dëndur** etj. Pra, **natë për natë, ditë për ditë** etj. marrin kuptimin «shpesh», «**dëndur**» dhe jo «**çdo natë**», «**çdo ditë**»: «.. unë **natë për natë** *nuk dëgjoj* gjë tjetër nga ati im ose nga ca miqt e tij, që vijnë dhe fjalosen me të veçse Greqia do të marrë vendin tonë.» (Postoli, LK 23); «Thashëthemet e *shtonin* numrin e ushtrisë Turke **ditë për ditë**, aqë sa edhe ushtarët nisnë të tregonin shënja frike» (Noli, HS 37); «**Ditë për ditë** po kjo punë *është* me ty» (KLSH); «Traga e gjerë e *thelluar vit për vit* nga rrotat e qerreve..» (Xoxa, LV II 104) etj.

Këta frazeologjizma idenë e kohës e japin me mjetin leksikor që përsëritet. Vetë përsëritja e komponentit, d.m.th. përsëritja në formë, bëhet shprehje, pasqyrë e përsëritjes së veprimit të foljes, me të cilën lidhet frazeologjizmi, duke dhënë me këtë edhe idenë e frekuencës, të dëndurisë e të intensitetit dhe në një masë më të vogël edhe të durativitetit. Këtu kemi një shembull paralelizmi të formës me përmbajtjen.

Duhet thënë megjithatë se ky zhvillim nuk është aq i mbaruar, shkëputja nga semantema nuk është aq e qartë dhe karakteri idiomatik është tepër i zbehtë, prandaj edhe vetë këto raste janë të dyshimta.

b) Vargu i formimeve të tilla është i hapur, padyshim brenda fushës së

caktuar semantike (me fjalë që shënojnë kohë). Nga kjo pikëpamje, d.m.th. nga ana strukturore, këtu kemi si të thuash, «tip formimi», gjë që s'është karakteristikë për frazeologjinë në përgjithësi. Megjithkëtë mund të themi se jo të gjitha formimet kanë arritur shkallën e frazeologjisë. Më me siguri do të flisnim këtu për frazeologjizma me **natë, ditë, orë, vit**, kurse ata me **javë, muaj, çast** etj. janë ende në shkallën e parë.

Shembujt me këtë strukturë të frazeologjizmave që tregojnë mënyrë, janë më të shumtë. Fjalët bazë janë: **dorë, ballë, krah, dhëmbë, fjalë, pikë, fill, kohë, flakë** etj.: «— Sa metra duhen?! — Nja 500-600 metra **dorë për dorë**.» (ZP, 21.2.1969,2); «.. nëmos më shumë, **dorë për dorë do të mundohem** që ca kohë ta lëmë pa punë, e më vonë ta gremis në ndonjë sektor sa më të largët.» (Estrada, 1967 IX 10) — «tani për tani; përkohësisht, dora dorës»; «*Marshimi dorë për dorë* i burrit dhe i gruas në harmoni ndjenjash, qëllimesh e idealesh, drejt shoqërisë komuniste..» (ZP, 8.2.1969, 1); «**Dorë për dorë** me këtë komb, të lidhur me miqësi.. *do të mund...*» (Postoli, LK 56) — «së bashku, bashkë»; **ballë për ballë** (shembujt më lart); «Ma do zemra, ma ka ënda *të lozëm ballë për ballë* (Çajupi, V 63); «*Nuk do të luftojmë ballë për ballë, po krah për krah, për dheuthin tonë*» (Kuteli, TM 207); «.. u qëndrojnë armiqtve **dhëmbë për dhëmbë**» (Ylli, 1967 X 14); «Plaku Zan Erzeni i *numëron emër për emër* gjithë viktimat, midis të cilëve edhe vëllanë e tij Kadri.» (Marko, AM 13); «Ajo.. **fjalë për fjalë** i tregoi atij se ndë atë fshat rri edh'e Bukur e Dheut» (PP, I 170); «Kalorësi i Fytyrës së Vrerës ur ju dërgon.. ti *tregoni pikë për pikë* të gjitha ato që ngjanë në këtë aventyrë» (DK, 162); «Nukë munt *t'ia çmonj* bukurinë hollësisht e **pikë për pikë**» (DK, 212); «Kaçaku e *pyeti fije për fije* për punët e pazarit» (Shuteriqi, Ç I 214); «Në qoftë se krijimtaria jonë letrare artistike e realizmit socialist nuk i përgjigjet sa duhet aktualitetit, nuk është vënë plotësisht në vijën e parë të luftës së partisë dhe të masave punonjëse për thellimin e pandërprerë të revolucionit, kjo nuk do të thotë se ajo ka dalë jashtë radhëve të kësaj lufte dhe duhet mënjauar, se çdo vepër e re që *do të pasqyrojë flakë për flakë* realitetin, do të krijohet nga hiçi.» (E Hoxha, FKT 3); «Amatorët përpiqen ta këthejnë frymëzimin politik të momentit në një frymëzim artistik, *duke iu përgjigjur* kështu **flakë për flakë** aktualitetit» (Estrada, 1968 I 15); «Problemi kryesor që ka preokupuar shokët që muarën pjesë në diskutim është *përgjigja flakë për flakë* ngjarjeve të kohës.» (Drita, 20.1.1968, 2); «*E kam pastruar* këtë grur **kokërr për kokërr**» (KLSH); «*Uroi kokë për kokë*» (KLSH); — «*Lufta fitohet* me luftë — iu përgjegj ashpër Coli. — **Plumb për plumb**.» (Shuteriqi, Ç II 175) etj. Frazeologjizmat **dorë për dorë, ballë për ballë** (në një kuptim), **krah për krah** kanë pothuaj të njëjtin kuptim: «bashkë, së bashku, si miq»; **fjalë për fjalë, emër për emër, pikë për pikë, fije për fije, kokërr për kokërr** dhe më larg **kokë për kokë** gjithashtu bashkohen nga kuptimi: «hollësisht, me imtësi, një për një»; këta bashkohen gjithashtu edhe nga pikëpamja e nuancimit, nga shkalla dhe intensiteti, kurse **dhëmbë për dhëmbë** e **plumb për plumb** vetëm nga intensiteti. Të gjithë këta frazeologjizma nuk kanë kuptim iterativ, përkundrazi, disa prej tyre, si **flakë për flakë**, shprehin çastësi.

Duhet thënë se lidhjet e frazeologjizmave të këtij lloji me togfjalëshat e lirë gjenetike janë ende të gjalla, për arsye se këta të fundit jetojnë e përdoren gjerësisht. Kështu që konteksti do të na shkoqisë në se kemi një frazeologjizëm apo një togfjalësh të lirë. Le të krahasohen me shem-

bujt e mësipërm këta të tjerët: «Të dy, *dorë për dorë*, u futën në ujë» (Xoxa, LV III 307); «*Krah për krah* që të dy burrat duallnë në rrugë.» (Postoli, LK 83); «— Mua do më mbeste të shkulja mustaqet *fije për fije* nga turpi.» (Xoxa, LV II 50); «...Jo, or jo!.. Ja (më jep) të tretën mbi mishin e egër (të rosave të egra), ja po rosa të buta, *kokë për kokë*» (Xoxa, LV II 38) etj.; afër me këto është edhe *plumb për plumb* dhe *emër për emër* (shembujt më lart). Nga ky ballafaqim do të shohim shkëputjen e frazeologjizmave prej bazës, zhvillimin kuptimor dhe idiomatik të tyre, por edhe ruajtjen e thelbit të kësaj baze: *dorë për dorë* — «së bashku», «bashkërisht» etj.

Së fundi, lidhur me konstruktet me nënrenditje me *me e për*, po shënojmë që në disa raste nënrenditja del edhe me *në, më, ndër* etj. si: *gju më gju e gju për gju* (Çajupi, V 93), *dhëmbë më dhëmbë e dhëmbë për dhëmbë, natë më natë e natë për natë, flakë më flakë e flakë për flakë, sy më sy, sy në sy, sy ndër sy e sy për sy* etj. Po në përgjithësi kjo nuk sjell ndryshime në tiparet kategoriale të frazeologjizmit, gjë që vërteton se këtu kemi të bëjmë me variante të të njëjtit frazeologjizëm me të njëjtën nënrenditje.

Frazeologjizmat e ndërtuar me nënrenditje me parafjalën *pas i* gjejmë vetëm në kuptim të kohës e të mënyrës. Të parët në përgjithësi shënojnë një kohë që është e gjatë a që zgjat gjer në skaj, pra kanë një nuancë durative. Si të tillë ata kanë kuptimin e përgjithshëm «gjithnjë, përherë, gjithmonë, për një kohë të gjatë, vazhdimisht». P.sh. «**Brez pas brezi**, në fiset që kanë jetuar pranë natyrës, si dhe në rigatën e ciganëve, *fitonjës dilte* gjithnjë ai që ishte më i fuqishëm, ai që mundte kundërshtarët.» (Xhai, DC 120); «Në të janë përmbledhur legjenda, gojëdhëna, kronika të vjetra, ngjarje të jetës shoqërore, që janë *ruajtur gojë më gojë, brez pas brezi*» (ShF, 24); «Këtë betim *do ta mbajmë brez pas brezi* dhe në jetë të jetëve.» (SF, 1967 I 151); «Sa të larta ishin shtëpitë e qytetit të saj, sa me mjeshtëri dhe mundim *ishin ndërtuar dhe ruajtur brez pas brezi* atje në këmbë të malit.» (Shaplo, BH 100); «Kështu kish lindur grindja e mëria, që *ishin zgjatur brez pas brezi* gjer te Mrikalemi e Dardhojmeli.» (Kuteli, TM 195); «**Brez pas brezi e kanë kallëzuar** këtë legjendë.» (Marko, AM 14); «— Ne *jemi gjysh pas gjyshi në këtë vend* e ju na vini që prapa diellit, e na mësoni.» (Xoxa, LV II 218); «Ata të dy.. *ruan e trashëguan jetë pas jete*.» (Kuteli, TM 22) etj. Në ndonjë rast kemi nuancën e përsëritjes periodikisht, të përsëritjes së vazhdueshme po me intervale, si te *kohë pas kohe, herë pas here* (ende të papërngjitura) etj.: «**Kohë pas kohe** *vinim* e shihnim edhe ne të sëmurin.» (KLSH); «.. *tuke shpurë të holla herë pas here* tek e Bukur e Dheut» (PP, I 171) etj. Gjymtyra që përsëritet këtu, siç shihet, është një emër që tregon kohë ose që përdoret në kuptimin e kohës, të periudhës (brez, jetë, gjysh). Edhe fjalët, me të cilat lidhen frazeologjizmat në sintagmë, tregojnë përgjithësisht veprime që mund të zgjasin në kohë, si: *mbaj, ruaj, kallëzoj, jam, rroj* etj.

Me kuptim të mënyrës përdoren frazeologjizma të tillë, si: *fjalë pas fjale, çap pas çapi (hap pas hapi), këmbë pas këmbe, mik pas miku, bisht pas bishti* etj. [«**Fjalë pas fjale**, *siç e porositi kryekusari*, Z. Kristo *shkrojt*..» (Postoli, LK 99); «Këto të gjitha *kanë për të ngjarë fjalë pas fjale siç jua them*.» (DK, 239) — «pikërisht, ashtu tamam»; «**Fjalë pas fjale** ata *nisën të pyesnin* plakën pse nuk doja të futesha në kooperativë.» (Marko, AM 365); «— Është komshia jonë. S'e duroj dot.. . më *ndjek çap pas çapit!*» (ZR, 24.1.1969, 4); «Një dallgë e madhe, *ushqyer çap pas çapi* nga ujrat që gjente përpara, iu përplas kërres së Ndonit dhe për-

mbysi e vuri përpara me pelë e me kalorës.» (Xoxa, LV II 98); «**Hap pas hapi** e *ndiqte* hija e paragjykimeve, e opinioneve të këqia.» (ZP, 22.1.1969, 3) — «vazhdimisht»; «**Këmbë pas këmbe** *vinte* Vita dhe nusja e Leksit, me furkat e leshit në duar.» (Xoxa, LV II 8); «**Mik pas miku** *çoi fjalë* te Toli për të bijën.. donte ta bënte për të birë.» (KLSH); «— Mos kërkoje të lëshonte flori, ustai yt, si gomari i Nastradinit, që *m'iu qepe* ashtu **bisht pas bishti?**» (Xoxa, LV III 253) — «prapa» etj.

Prej këtyre duhet të dallojmë frazeologjizmat me kuptim mbiemëror, që kanë të njëjtën strukturë, nganjëherë edhe të njëjtën gjymtyrë, si: **lëng pas lëngu, zdërr pas zdërr, mik pas miku** etj. — «shumë i largët në lidhje gjaku ose lidhjet shoqërore».

Një nënrenditje në frazeologjinë shqipe me parafjalën **pa**, mund të kemi në rastet si: «Po buça len diku hekrat e kanjelen e *ikë rrugë pa rrugë* (PP, I/II 323); «Ju desh të shkasin nëpër një tatëpjetë të xhveshur e pastaj *t'i futen* një përroi të thatë **rrugë pa rrugë**» (Shuteriqi, Ç II 217); «Të gjithë u nisën. *I ranë rrugë pa rrugë*. Ecnin shpejt.» (ShP, 1967 XI 20); «**Dashur pa dashur** edhe ti *shkon me mendjen e tij* (KLSH); «Kështu Rrema *ishte bërë dashur pa dashur*, vegla qorre e hoxhës.» (Marko, AM 266) etj. Në këto raste, gjymtyra që përsëritet është një emër ose një pjesore. Nganjëherë kjo strukturë del me bashkërenditje me lidhëzën e: «.. nuk do të dridhej ashtu për prindërit dhe do t'i dilte zot asaj kur pleqtë të *qaheshin vend e pa vend*.» (Shaplllo, BH 63); «Turku i Stambollit.. *me rrahë njerëz punë e pa punë?!*» (KLSH); «Udhëtonte njësi i shtatëshes partizane, *duke kaluar shkurre e driza, udhë e pa udhë*..» (ShP, 1968 VI 12); «Shalët e çaplyera që në rini e të ngrira ashtu, nga lëvrimet e motit, nga *të ecurit udhë e pa udhë* e nga kalorimet maje shale, nuk mund të përputheshin dot si këmbët e drejta të beut.» (Xoxa, LV III 87); «**Rrugë e pa rrugë** oficerët e sigurimit **dolën** në një livadh.» (Bashkimi, 18.3.1969, 3); «Atë e prisnin nga Durrësi. **Rrugë e pa rrugë e soll**i një shofer.» (Karadaku, RrP 5) etj.

Formimet e këtij lloji më të zakonshme janë me gjymtyrë emërore dhe më rrallë me pjesore. Në përgjithësi ato tregojnë mënyrë veprimi (**rrugë pa rrugë** «kuturu...», **vend e pa vend, punë e pa punë** «kot»), por një mënyrë të papërcaktuar, ashtu si te «lokucioni» **pak a shumë**, prandaj ato barazohen kuptimisht me ndajfolje me kuptim të po asaj gjendjeje papërcaktueshmërie. Duket se kjo gjendje krijohet nga natyra e konstruktit, d.m.th. nga bashkë — a nënrenditja e një pohimi me një mohim, ose, si të themi, nga lidhja e dy të kundërtave. Shih në krahasim me këto edhe konstruktet — fjali **bërë e pa bërë** (parakalimi), **zënë e pa zënë** (dielli), **dalë e pa dalë** (hëna) etj., që po t'i trajtonim si frazeologjizma gjuhësorë të mirëfillët, d.m.th. me tiparet kategoriale të frazeologjizmave (dhe jo të fjalive), do të shtjelloheshin përsëri si me një përmbajtje të papërcaktuar mirë, të përafërt, jo të prerë; përafërsisht, **në të zënë** (të diellit), **në të dalë** (të hënës), **në të bërë** (të parakalimit), pa e saktësuar në të vërtetë **para a pas** parakalimit, **para e pas** daljes së diellit etj. Por padyshim, frazeologjizmat **vend e pa vend, punë e pa punë** etj., nën ndikimin e vazhdueshëm të idiomatikës së tyre, kanë ecur më përpara edhe në njëzimin kuptimor e për pasojë janë bërë edhe më përcaktues për tiparin a rrethanën e veprimit.

Një grup tjetër përbëjnë togjet me nënrenditje pa ndonjë parafjalë, po me një emër në emërore dhe një në dhanore — rrjedhore të shquar ose, si formë më e vjetër, në kallëzore të shquar, si: **dita ditës / dita**

ditën, nata natës / nata natën, viti vitit / viti vitin, java javës / java javën, hera herës / hera herën, dora dorës / dora dorën, këmba këmbës / këmba këmbën etj. [«E ata që nuk kujdesen me e ruejt shëndetin e tyre, dita ditës vazhdojnë ta vrasin vetëhen» (Stërmilli, SD 87); «Na *ndiqnin këmba këmbës*» (Kuleti, NT 100); «Po ata të zënë në mes të dy zjarresh, të *ndjekur këmba këmbës* kushedi se ku e kishin lënë vrapin» (Shuteriqi, Ç II 221); «Skënderbeu e *ndoqi* ushtrinë veneciane *këmba këmbës* gjer në portat e Shkodrës» (Noli, HS 52); «... do t'i *ndjekim gjurma gjurmës* e *këmba këmbës* gjersa t'i lodhim e t'i shtijem të gjitha në dorë.» (Kuteli, TM 76) etj.]. Jo rrallë i gjejmë këto togje edhe si kompozita, gjë që shprehet në të shkruar bashkë ose me vizë lidhëse, si te «Rregullat e drejtshkrimin të shqipës» (1967) E § 2, 14 etj. Edhe në paçin përfunduar në kompozita ato kanë kaluar patjetër përmes gjendjes frazeologjike, po kompozimi këtu flet në favor të njëzimit të tyre, pra të shkallës së lartë të qëndrueshmërisë dhe të dëndurisë së përdorimit. Mirëpo në shqipe s'kemi strukturë kompozite me dy emra, prej të cilëve i dyti nënrenditet në rasën dhanore-rrjedhore të shquar a në rasën kallëzore të shquar pa parafjalë; bile nuk gjejmë me këtë strukturë as togje të lira. Kjo na shtyn të mendojmë se këtu kemi të bëjmë me mbeturitë fjalish eliptike, kuptimi i të cilave është kompresuar, është rrudhur dhe është ngarkuar mbi dy gjymtyrët emërore, por patjetër pas elipsës së njësisë predikative. Struktura me kallëzoren sikur e mbështet më tepër këtë mendim, sepse të sjell në mend më lehtë një fjali të dikurshme, mbase *këmba (ndjek) këmbën, dora (ndjek) dorën* etj. Po mund të jenë edhe reduktim i një konstrukti me nënrenditje me parafjalën **pas: nata (pas) natës, këmba (pas) këmbës** etj.

Nga vlera semantiko-funksionale këta frazeologjizma janë të njëjtë me ata me nënrenditje me **për: nata natës — natë për natë, dora dorës — dorë për dorë** etj. Përsa i përket trajtimit të tyre si kompozita, kjo është më tepër një zgjidhje e praktikës drejtshkrimore, ndërkohë që ata ruajnë ende tiparet kategoriale të frazeologjizmave, megjithëse herë-herë paraqiten në kapërcyell.

Këto janë llojet kryesore të konstrukteve me nënrenditje të frazeologjizmave me një gjymtyrë të përsëritur. Mund të thuhet për të gjitha së bashku se kuptimi i gjymtyrës që përsëritet është në përgjithësi semantemë, kurse nuancat (iterative, durative, intensive, e shkallës etj.) jepen, përveç me anë të kuptimit leksikor të gjymtyrëve, edhe me vetë konstruktin (me përsëritjen formale), me llojin e nënrenditjes, si dhe me mjetin nënrenditës.

Theksojmë përsëri se të dy grupet (me bashkërenditje e me nënrenditje) janë në një shkallë më të ulët të qëndrueshmërisë e të idiomatikës, përgjithësisht janë të motivueshëm në vijë të drejtë e kjo bën që të jenë më afër togjeve të lira me përsëritje<sup>10</sup>, në krahasim me tipat e tjerë strukturorë të frazeologjizmave ndajfoljorë. Tek ata, më shumë se në tipat e tjerë, në zbulimin e vlerës semantiko-funksionale luan rol konteksti, më ngushtë, folja të cilën plotësojnë. Disa lloje prej

10) A.I. Mollotkov, në parathënieën e *Fjalorit frazeologjik të gjuhës ruse 1967* f. 15 (Frazeologičeskij slovar ruskovo jazyka, Moskva 1967; A.I. Mollotkov, *Frazeologizmy ruskovo jazyka i principy ih leksikografičeskovo opisanja*, f. 15) megjithëse konstrukte të tilla analoge për rus. i numëron si elemente jofrazeologjike, d.m.th. i nxjerr jashtë kufijve të frazeologjisë, thekson: «Togfjalësha të tillë mund të jenë në vetvete prototipa të frazeologjizmave ose mund të shërbejnë si model strukturor për formimin e frazeologjizmave.»

tyre formojnë vargje relativisht të hapura, brenda një fushe leksikore, e në këtë drejtim përvijojnë kufijtë e një tipi, në kuptimin gjuhësor, d.m.th. të një sistemi më vete formimi me mundësi të mëtejshme pa-surimi e zhvillimi.

Një pjesë e këtyre frazeologjizmave kanë një zhvillim semantik ekzocentrik, d.m.th. kuptimi frazeologjik nuk del nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse të frazeologjizmit, po është ngritur mbi to, është shkëputur dhe është njëzuar pas një «zhvendosjeje» të figurshme (si p.sh. **dorë për dorë, pikë për pikë, krahë për krahë, dhëmbë për dhëmbë** etj.). Karakteri frazeologjik i këtij grupi është më i qartë. Përkundrazi, konstruktet **natë për natë, vit për vit, fshat më fshat** etj., me gjithë karakterin përgjithësues të kuptimit, janë të tipit endocentrik, sepse vlera e drejtpërdrejtë kuptimore e gjymtyrëve për kuptimin tërësor të konstrukteve është ende shumë e qartë. Këto përbëjnë grupin që anon më tepër nga tipi gramatikor i përsëritjes. Për përsëritjen si mjet gramatikor, si mjet i shprehjes së aspektit të foljes dhe i shkallës sipërore të mbiemrit e të ndajfoljes shih edhe E. Lafa: «Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten» në «Studime filologjike» 1966, IV f. 119-139. Aty janë trajtuar edhe disa togje me përsëritje të një ndajfoljeje dhe me vlerë ndajfoljore, si **fët e fët, shpejt e shpejt** etj., por gjithnjë nën një vështrim gramatikor të përsëritjes si mjet për shprehjen e shkallës sipërore.

Tejdukshmëria e strukturës, karakteri endocentrik i zhvillimit kuptimor, vlera e theksuar gramatikore e përsëritjes dhe mungesa e një idiomatizimi të plotë të këta konstrukte (**natë për natë, nata natës** etj.) lënë shteg që ata të trajtohen edhe si jofrazeologjizma, si «konstrukte analitike të ndryshme... për kategoritë që mungojnë», në të cilët «në plan të parë del struktura», në opozicion me **sy ndër sy** etj., ku «problemi është për përmbajtjen, i varur nga kuptimi, nga fjala **sy**». (Shih Xh. Lloshi, «Shënime për fjalën dhe togfjalëshin», në «Studime filologjike» 1966 IV, f. 196). Ndërkaq duhet thënë se konstrukte të tilla analitike nuk formohen vetëm për kategori që mungojnë, gjersa kanë edhe njësi një-fjalëshe koresponduese (me nuanca në kuptimet e mëvetësishme) dhe me përsëritjen nuk jepen vetëm kategoritë gramatikore të shkallës (te mbiemri), të aspektit (te folja) etj., por edhe elementi semantik suplementar, që i shtohet kuptimit bazë.

## B. Frazeologjizma të formuar nga dy fjalë që kanë lidhje kuptimi.

Shënojmë që në krye se ky grup frazeologjizmesh formohet në pjesën dërrmuese me bashkërenditje. Janë shumë të rralla rastet me nënrenditje, si (**flet**) **kodra pas bregut**, (**shkoi**) **dushk për gogla** e ndonjë tjetër [«— More, more, ti qënke djall me brirë, arvanitis, kajmene. — **Dushk për gogëlla**, qir Koço.» (Kuteli, NT 103) etj., — një frazeologjizëm episodik, që duket se vjen prej një modeli fjalie «shkoi dushk këmbyer për gogëlla», me kuptimin «shkoi me të hedhur» ose «kot, dëm»].

Fjalët që bashkërenditen janë më shumë emra e ndajfolje dhe më pak folje.

Për **natë e ditë a ditë e natë** vlejné po ato vërejtje që kemi thënë rreth veçorive semantiko-funksionale të konstrukteve **ditë për ditë, natë për natë** etj., veçse këtu është më e theksuar nuanca durative, e cila në

këtë rast del si vazhdim i pandërprerë: «Trimat e bajraktarit *përgjonin ditë e natë* dhe po të nxirrje kokën jashtë të vrisnin.» (Nëndori, 1967 IX 81); «Atje mbylli jetën e saj nga bota dhe me gjëlpërën në dorë *dit'e natë lëftonte* me varfërinë.» (Postoli. LK 11); «*Po robtohen dit'e natë* me krrabë në dorë, të gjejnë ndonjë fije bari për gjënë.» (Xoxa, LV II 52); «— E? Si do ta falënderosh ti partinë? / — *E kam falënderuar ditë e natë.* . .» (Marko, AM 89) etj.

Me këto duhet bashkuar edhe **me sot e nesër** ose **me sot me nesër**, **në këmbë e në dorë**, me bashkërenditje kopulative ose jokopulative.

Më të shumtët e frazeologjizmave të formuar me emra tregojnë mënyrë, pa ndonjë nuancim tjetër përveç shkallës: «Ai as që e mori mundimin të pyeste të shoqen, në ishin të vërteta këto që thuheshin, por i rrinte asaj **hundë e buzë**.» (Bashkimi, 13.7.1968, 3); «Të nesërmen e mbledhjes së këshillit popullor drejtori i ndërmarrjes *u paraqit* në zyrë **hundë e buzë**.» (Hosteni, 1968 VII 3); «Fija bënte sikur *rrinte buzë e hundë*, po në gropëzat e faqeve i furfurinte një dritë e ëmbël.» (Kuteli, NT 77); «. . bejlerëve *u pati qëndruar majë e brisk*.» (Xoxa, LV III 8); «Kish raste kur edhe në kishë s'vinte esëll. Ahere të kishe veshë e ta dëgjonje se si i bënte **lesh e li**<sup>11</sup> troparet e shënjta.» (Sinaeri, DP 117); «Një çikë të mungojë gruaja në shtëpi *bëhen* të gjitha **lesh e li**» (Xhai, DC 82); «Ai i ka përzier dhe i *ka bërë lesh e li* idetë e shoqërisë sonë mbi brezin e ri.» (AK, 115); «. . ai vetë, edhe në këtë natë të llahtarëshme që e *kishte bërë botën kashtë e koqe*, ishte toptan, me gjithë familjen.» (Xoxa, LV II 109); «Këta njerëz mund të jenë, deri në një farë shkalle, të lumtur vetëm atëhere, kur *hidhen kokë e këmbë* në dallgën e luftës së egër.» (AK, 244); «. . ju ishit gati, bile plot zjarr, dëshironit të *futeshit kokë e këmbë* në punën më të lodhëshme, më të mërzitur.» (AK, 211); «*Ra këmb'e kokë brenda* vetë me fjalët që tha» (KLSH) etj. Kuptimisht këta frazeologjizma shtjellohen: **hundë e buzë** «rëndë», **majë e brisk** «keq», **lesh e li** «rrëmujë», **kashtë e koqe** «rrëmujë», **kokë e këmbë** «tërësisht». Por ata nuk janë larg edhe nga kuptimi mbiemëror, gjë që bëhet në mënyrë të veçantë më e qartë kur me ata lidhet ndonjë fjalë tjetër plotësuese, — karakteristike për mbiemrin, p.sh. «— Unju, trim i xhaxhait, unju, se *nuk i dilet me ta*, ashtu, *duar sallë e kashtë e koqe*, siç u katandis shtëpia e madhe e Shpiragajve.» (Xoxa, LV II 253), ku **kashtë e koqe** vihet në një plan me kompozitën mbiemërore **duarsallë** dhe merr këtu kuptimin «të shpërndarë»; «Ti, nëno, u zemërove kur mora unë Malinë, se ajo ishte një vajzë fukarai dhe nga shtëpi e këputur; e, megjë nuk solli dot pajë, ti *i rrije* ahere *tërë hundë e buzë*.» (Xhai, DC 80); «Mal agaj largohej nga dhoma e së bijës, *duke tundur kokën i pakënaqur*, dhe *tërë hundë e buzë* futej në dhomën e së motrës.» (Abdi-hoxha, NK 83); «Kujton ajo se ia kam unë fajin dhe ka dhjetë vjet që më *rri tërë hundë e buzë*, sikur t'i ketë ngrënë gomari bukën.» (Papa, M 163); «Hyn Mazllëmi *tërë hundë e turi*.» (Hosteni, 1969 I. 10) — me kuptimin «rëndë», por edhe **i(e) zemëruar, i(e) rëndë**; «— Sikur po rënkton dheu! . . *tha* Vita *gjithë sy e veshë*.» (Xoxa, LV II 144); «Vështroi i kënaqur fshatarët që *ishin gjithë veshë e sy*» (Xoxa, LV II 129) — me

11) Mund të merret edhe së bashku me foljen **bëj** (**bëj lesh e li**) dhe të trajtohet si foljor me kuptimin **ngatërroj**. Kështu mund të analizohen edhe frazeologjizma të tjerë, si: **bëj hi e pluhur** (ose **pluhur e hi**), **u bë pikë e vrer** etj. — si të përbërë prej një gjymtyre të thjeshtë foljore dhe një gjymtyre të përbërë (frazeologjike) ndajfoljore.

kuptimin «gati, ngrehur, me vëmendje të madhe», por edhe «i vëmendshëm, i gatshëm për të dëgjuar mirë» etj.

Me kuptim vendor me këtë lloj konstrukti frazeologjizmat në shqipe janë të rrallë: «Ujë në hajat, ujë në oborr, *ujë bot'e qiell!*» (Xoxa, LV II 102) — «kudo»; «Uji i ftohtë e *drodhi fund e krye* dhe e pruri në vete.» (Nëndori, 1967 IX 90) — «kudo». Por kuptimi vendor këtu shpeshherë mbulohet nga kuptimi i mënyrës, p.sh. «. . e gjithë kjo kulturë e përgjithshme duhet të *përshkohet fund e krye* nga ideologjia jonë marksiste-leniniste.» (E. Hoxha, FKT 55); «Legjenda e Krishtit *është fund e krye e sajuar*, fantastike, joreale.» (ShF, 34) etj., me kuptim të përgjithshëm «krejtësisht, tërësisht, e gjithë»; po kështu edhe *anë e kënd, fund e maje* etj. Kuptim vendor të mirëfillët kanë, siç do të shihet më poshtë, edhe disa frazeologjizma me gjymtyrë ndajfoljore.

Kuptimi tërësor i frazeologjizmit në këtë grup varet në përgjithësi nga vlera e gjymtyrëve. Kështu frazeologjizmat që kanë si gjymtyrë ndajfolje mënyre kanë edhe kuptim mënyre; p.sh. «*Flisnin mbarë e mbrapsht* për ato që do të ngjisinin.» (Marko, AM 346); «grindeshin, u binin kuajve dhe *shanin mbarë e prapë* gjithçka mbi dhe.» (Abdihoxha, NK 293); «*Folën mbarë e mbrapshtë* gjer sa i zu gjumi» (KLSH); «Të kam thënë, zoti komisar, *fol urt'e butë*.» (DK, 161); «*Mendoi hollë e gjatë* për studimet që do të bënte më ndonjë qytet të math t'Italisë.» (Shuteriqi, Ç I 212); «Megjithatë ajo drejtimin e kishte marrë pa *u mendue hollë e gjatë* për tek shtëpia.» (Nëndori, 1967 IX 79); «. . dhe *treguan në shtëpi gjerë e gjatë* gjithë sa u fjalosën me dërvishin.» (PP, I 420); «Puna s'bëhet me një natë, / *do mentuar gjer'e gjatë*». (Çajupi, V 109); «Shima, pasi e pa se vetëm një shteg shpëtimi kishte, *foli gjatë e gjerë* me Salën dhe me shokët e ekipit.» (Marko, AM 326); *Do ta marr çupën gjallë a vdekur*<sup>12</sup>» (KLSH) etj.

Është interesante të vihet re këtu se si bashkërendohen gjymtyrë me një lidhje të caktuar kuptimore, përgjithësisht sinonime a antonime, por që në rrethimin fjalësor përkatës kanë edhe vlerë të mëvetësishme të pabashkërenduar njëra me tjetrën. Kështu në shqipe përdoren, paralel me frazeologjizmat e mësipërm, edhe konstruktet: *fol mbarë!*, *foli butë*, *mendon hollë*, *mendoi gjatë*, *foli gjatë* etj. Me sa duket këtu kemi pasur një proces të kundërt me shpërbërjen e frazeologjizmave [si tek rastet «*ua mbathi*» (— këmbëve), «*s'ja var*» (— torbën), «*s'ma pret*» (— koka) etj.]. Përkundrajt procesit të cungimit të frazeologjizmit, shpërbërjes së tij dhe për pasojë të kalimit nga plani i frazeologjisë në planin e fjalës, kemi procesin tjetër të zgjerimit të sintagmës me anë të bashkërendimit të një gjymtyre tjetër të lidhur kuptimisht me njerën fjalë të sintagmës dhe për pasojë kalimin nga plani i fjalës në atë të frazeologjisë: *foli mbarë + e mbrapsht*, *foli urtë + e butë*, *mendon hollë + e gjatë*, *foli gjatë + e gjerë* etj. Te ky fenomen vërehen dy veçori:

1) Për shkak të një ecurie të tillë të formimit të frazeologjizmit ruhet ende e qartë, e tejdukshme struktura e jashtme dhe e brendshme e konstrakteve, ato janë të motivueshme nga ana semantike e strukturore dhe kjo i afron me togfjalëshat e lirë.

2) Gjymtyra e dytë, duke u njëzuar semantikisht me të parën, ka në gjithë konstruktin një funksion kompensator, plotësues dhe intensifikues.

Me kuptim vendor janë frazeologjizma të tillë, si *poshtë e lart* (**lart**

12) **Vdekur** me vlerë ndajfoljore.

e poshtë), kryq<sup>13</sup> e tërthor, rreth e rrotull etj. [«Nga ç'shoh unë, ia dashka zemra këtij cjapi të dalin fjalët që *thuhet poshtë lart* për Italinë.» (Xoxa, LV II 178); «Adilit i erdhi më keq për 'të se sa për ditën që pati humbur duke *bredhur poshtë e lart*, nëpër pluhurin e vapën e madhe të qytetit.» (Xoxa, LV II 57<sup>14</sup>); «Pyet *poshtë e lart* ata që ngasin qetë e ata që kullosin dhentë.» (Kuteli, NT 79); «Ata ja kishin frikën dhe kur ai *s'ishte* në fshat, po *xhandar poshtë e lart*.» (Marko, AM 264); «*Dualëm lart e poshtë nëpër botë* që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë.» (Kuteli, TM 62); «... *kam shkelur kryq e tërthor* tërë bjeshkën.» (Kuteli, TM 78); «Një djersë e hollë i bulonte mi ballin e math e të mvrejtur, *të çarë kryq e tërthor*<sup>15</sup>, si një bukë e ardhur mirë e e shënuar me pirun.» (Shuteriqi, Ç I 7); «Një buçitje rrënqethëse .. kambanash. . *u përhap tej e mbanë* mbi fushë.» (Xoxa, LV II 105-106); «Zdruj, zdruj na vajti me link në dhomën e gostisë. *pa rreth e rrotull* dhe pastaj kërcit iku. .» (PP, I 384); «Kapedanët *rreth e rrotull* po *qanin* si foshnja dhe vajtonin pas mënyrës tradicionale me këngë dhe me kujë.» (Noli, HS 115); «*E tuke trapitur andej e kënde*, gjeti përdhe një plloçkë.» (PP, I 147) etj.l.

Lidhur me shembujt e mësipërm shtojmë se karakteri frazeologjik është në përgjithësi i dobët. Në mënyrë të veçantë kjo vihet re te **rreth e rrotull**, sidomos kur përdoret si lokucion parafjalor, p.sh. «. . vëzhgonin **rreth e rrotull** shtëpisë. .» (ZP, 15.X.1967, 2). Në këto raste lokucioni ka shkuar drejt përngjithjes dhe nga pikëpamja drejtshkrimore mendojmë se duhet shkruar së bashku (*rretherrotull*). Në gjuhën e shkruar kjo ka filluar të gjejë pasqyrimin e vet: «. . *rretherrotull* kullës. .» (Nëndori, 1967 IX 78), «. . *rretheqark* lëmit. .» (Xoxa, LV III 149) etj. Pa dyshim këtu s'kemi më tiparet e frazeologjizmit. Në rastet e tjera mendojmë se «është kryer një farë procesi deetimologjizimi, i cili ka krijuar atë «zhvendosje» në strukturën e brendshme të togfjalëshit, që e kalon këtë nga plani sintaktik në planin leksikor, por akoma me një strukturë «të veçantë» brenda këtij plani. — më kompleks se fjala nga forma, dhe në shumë raste edhe nga kuptimi.»<sup>16</sup>

Në ndonjë konstrukt kemi të ndërthurur me kuptimin e vendit edhe kuptimin e mënyrës, si te **kryq e tërthor**; te **poshtë lart** (« — Ç'thotë defteri yt, bakall? / — Po, me gjithë të sotmet *bëhen poshtë lart* nga njëzet e katër lekë.» — Xoxa, LV II 43 — «afërsisht, rreth») — me bashkërenditje jokëpujore ndajfoljesh, kemi një kuptim të qartë mënyre.

Ndonjë nuancim i veçantë këtu për një grup frazeologjizmesh nuk na del, prandaj nga kjo pikëpamje duhen parë veç e veç të gjitha rastet.

Togjet **sot e tutje**, **tani e tutje**, **rallë e tek**, **pak a shumë** etj. kanë përgjithësisht përmbajtje njëplanëshe, pa idiomatikë dhe pa ndonjë zhvillim të dukshëm kuptimor, prandaj mendojmë se duhet të merren jo si frazeologjizma, po si togfjalësha të lirë ose si «lokucione» gramatikore.

Janë edhe pak frazeologjizma të formuar me gjymtyrë foljore, si **shkel e shko**, **ec e jak** (a **çap e jak**), **qesh e ngjesh** dhe **folë e qesh** (a **qesh e folë**)<sup>17</sup>. Ky grup i vogël veçohet jo vetëm nga natyra e gjym-

13) Me vlerë ndajfoljore.

14) Gjindet edhe **poshtë e përpjetë**: «I shkante Evropës **poshtë e përpjetë**.» (KLSH)

15) Mund të merret edhe me kuptimin e mënyrës, sidomos po të shihet lidhur me krahasimin e mëpasmë: «. . **kryq e tërthor**, si një bukë e ardhur mirë e e shënuar me pirun.»

16) Shih V.N. Telija, *vep. e cit.*, f. 192.

17) Shih e shkruaj mendojmë se ende nuk është formuar si frazeologjizëm.

tyrëve përbërëse, po edhe nga disa veçori të tjera të përmbajtjes (veçori semantiko-funksionale) dhe të formës (të strukturës dhe të formëzimit):

a) Nga ana semantiko-funksionale këta janë në të shumtën e rasteve frazeologjizma ndajfoljorë mënyre.

Kur këta frazeologjizma lidhen dhe plotësojnë një folje (me përjashtim të këpujës **jam** në një kallëzues emëror) ose një pjesore të nyjshme, kanë vlerën e ndajfoljeve të mënyrës, si: «Mirëpo nja dy gra, që të arrinin normën sa më parë, e *bënin* punën **shkel e shko**.» (Xhai, DC 64); «Numrimi i faqeve *nuk duhet bërë shkel e shko*, por me seriozitet të madh.» (Mësuesi, 27.8.1965, 2); «*Bëhet* puna **shkel e shko**, fluturon cilësia.» (Estrada, 1968, II 66); «... rëndësia e krosit është nënvleftësuar, ose ai *është organizuar shkel e shko*.» (SP, 2.3.1965, 1); «...seanca *zhvillohet shkel e shko* dhe pa interes.» (DP, 1961 IV, 62); «Punët ahare do *shkojnë* si sahat e jo ashtu ara-mara e **shkel e shko**, si gjer tani!» (FG, 192); «Puna stërvitore është nënvleftësuar dhe *është bërë shkel e shko*, sa për të kaluar radhën.» (SP, 7.12.1965, 2); «Këta të dytët ose *do t'i zhvillojnë* detyrat **shkel e shko**, sa për të paraqitur diçka, ose do të kërkojnë ndihmën e shokëve.» (Mësuesi, 4.2.1966, 2); «... *punohet shkel e shko*, pa e vlerësuar kohën e punës, pa zbatuar disiplinën dhe rregullin në punë» (Mësuesi, 19.2.1965, 3); «E *punonin shkel e shko* atë pak tokë dhe kohën tjetër ia kushtonin pazarit.» (ShA, 1956 XII 37); «... njohuritë të *fitohen* mirë e jo **shkel e shko e shpejt**.» (AP, 1960 VIII 28); «Sot ka ardhur koha që aktivitetet të *zhvillohen* sa më të organizuara, jo **shkel e shko** e jo duke shfrytëzuar terrenet sportive të kolektivave të tjerë.» (SP, 18.12.1962, 2) etj. «Llozet e hartës së molisur e të *punuar shkel e shko* po thyeshin, muret po shëmbeshin...» (NL, 26); «Retë qëndronin pezull mbi kambanaren si arna të ndyra dhe të *qepura shkel e shko* në një kadife mavi.» (VA,283) etj. *Bâme pak fjalë qesh e njesh*, mandej me një bakshish i vüeme kapak punës.» (F, II 4); «Ajo ja zgjati me rrëmbim, ai ja mori dhe që të dy *vazhduan qesh e folë* në kasollen e vogël, me duart në duar.» (TB,161) etj. «Punëtorët do t'i kenë të plotësuar të gjitha nevojat e tyre brenda në kantier dhe *nuk do të mundohen çap'e jak* çdo ditë duke bërë një orë rrugë.» (Bashkimi, 8.12.1946, 2); «Përse nuk rri këtu në gjirin tonë / Të rrosh i ngrënë, i çlodhur, i gëzuar / Po **çap e jak roptishesh** pa pushuar?» (Kristo, F 5); «*Bariste çap e jakë* nëpër shtëpi». (KLSH) etj.

«Fjalori i gjuhës shqipe» (1954) **shkel e shko** e barazon me «lokucionin» ndajfoljor «pa kujdes» (f. 526), kurse **qesh e ngjesh** e trajton si foljore «ve në lojë, i hedh thumba» (f. 350). Në shembujt e mësipërm duket që këta frazeologjizma lidhen zakonisht me folje që tregojnë të bërë, si **bëj, zhvilloj, organizoj, korigjoj, kryej, punoj** etj. dhe me emra, si **punë, detyrë** e të tjerë të sferave më të gjera se foljet. Është interesant të vihet re këtu edhe shtjellimi që u bëhet frazeologjizmave, me fjalë a fjali të tjera që tregojnë mënyrë, si: «... **shkel e shko** dhe *pa interes*», «... *ara-mara e shkel e shko*...», «... **shkel e shko**, *sa për të kaluar radhën*...», «... **shkel e shko**, *sa për të paraqitur diçka*...», «...**shkel e shko**, *pa e vlerësuar kohën e punës* etj.», «... **shkel e shko e shpejt**...», «... **shkel e shko**, *si të punonin angari*...» Kjo përforcon përmbajtjen mënyrore të frazeologjizmit.

Nëqoftëse këta frazeologjizma lidhen dhe plotësojnë një emër, ose foljen këpujore **jam**, atëherë ata tregojnë tipar, pra kanë përmbajtje

(vlerë semantike-funksionale) mbimërore p.sh. «Kjo. hedh dritë mbi **punën shkel e shko** që kanë bërë ata» (Puna, 5.7.1960, 2); «Ato në fund të fundit tregojnë. **punën shkel e shko** dhe pa përgjegjësi.» (Mësuesi, 29.10.1965, 3); «Dhoma ishte mjaft e madhe, e mobiluar pak dhe me një **pamje shkel e shko**»<sup>18</sup> (BA, I 86) etj. «Kështu përgatitja **është shkel e shko**, bile edhe për vetë atë që është caktuar të japë mësim.» (Mësuesi, 28.1.1966, 3); «Ai **është fol e qesh** me të gjithë.» (Domi, S 30) etj.

Nga të katër këta frazeologjizma **shkel e shko** dhe **ec e jak** kanë kryesisht vlerë semantiko-funksionale ndajfoljore, kurse **qesh e ngjesh** dhe **fol e qesh** kryesisht mbimërore. Në kuptim dhe funksion ndajfoljor të gjithë ata janë sinonimikë me «lokucionet» ndajfoljore me **me** ose **pa** (*pa kujdes, pa ndaluar, me thumba, me të qeshur* etj.). Po në shkrimet dhe përkthimet e Dh. Paskos gjejmë ndonjë edhe në formë «lokucioni» me **me** (si: *veprimtari me shkel e shko, punë me shkel e shko* etj.), formë që s'është aq e përhapur dhe që, me sa duket, do të ketë dalë nga një të kuptuar të gjymtyrëve si emra (si: *punë me të shkelur e të shkuar* etj.).

Ka edhe kontekste, në të cilat s'del e qartë vlera semantike-funksionale e frazeologjizmit. Kjo vihet re kur frazeologjizmi mund të lidhet edhe me foljen edhe me emrin, sipas interpretimit tonë. Në këto raste emri, me të cilin lidhet frazeologjizmi është i pashquar: «Nuk lejojmë të bëhet **punë shkel e shko**<sup>19</sup>, të lakmohet pas normës.» (ZP, 6.6.1967, 3) «të bëhet **shkel e shko**» ose «**punë shkel e shko**»; «. . . bëjnë një **punë shkel e shko** për edukimin e nxënësve.» (Mësuesi, 30.10. 1964, 1) — «**bëj shkel e shko**» ose «**një punë shkel e shko**» etj. Po kjo do thënë edhe kur në rrethimin fjalësor të frazeologjizmit bën pjesë një emër foljor, që ka edhe kuptimin e veprimit, edhe atë të rezultatit e të sendit vetë, p.sh. «**ushqimi shkel e shko**» — «të **ushqyerit shkel e shko**» ose «**ushqimi shkel e shko**». Pjesët e tjera të kontekstit nganjëherë ndihmojnë në skjarimin e gjendjes, p.sh. «. . . i hedh një **sy shkel e shko**, pa u thelluar.» (Mësuesi, 24.6.1966, 2) — «i hedh **shkel e shko**» — ndajfoljore; «. **ushqimi shkel e shko**, që i furnizonte seminarit sipërmarrësi i drekërave.» (KZ, 217) «**ushqimi shkel e shko**» — mbimërore.

Konstrukt i **shkel e shko** përdoret nganjëherë edhe me vlerë semantiko-funksionale foljore, p.sh. «**shkel e shko** e prapa mos shiko» (KLSH); «**shkel e shko** zëmëra ime, / mos bjerë në hidhërime.» (N. Frashëri, LV 19); «Prandaj, në qoftë se don të fitojsh, **shkel e shko** e mbrapa mos shiko.» (Stërmilli, KS 246) etj. Në këtë rast karakteri frazeologjik i tij vihet në dyshim.

b) Nga ana e formës (e strukturës dhe e formëzimit) këta frazeologjizma, deri në fazën e tanishme, ashtu si na e japin materialet e grumbulluara, qëndrojnë me një këmbë në fushën e frazeologjisë dhe me tjetrën në fushën e kompozitave (përngjitjeve). Është e vërtetë që shkrimi i tyre si një fjalë e vetme nuk është argument, as shkak për të thënë se janë përngjitur përfundimisht, por megjithatë është një tregues i jashtëm i këtij procesi në zhvillim e sipër, ashtu siç e përcepton ndjenja gjuhësore e atij që shkruan, pra është një pasojë. Më përpara ka ecur ky proces te **shkel e shko** dhe **ec e jak** dhe është në fillim te **qesh e ngjesh** e **fol e qesh**. Këtu nuk mund të na shërbejnë si premisa as edhe njëzimi

18) Në tekst: **shkel-e-shko**; **pamje** me kuptim rezultativ.

19) Në tekst *shkeleshko*.

semantik, as edhe faktori akcentologjik, të cilët si tek të katër këta frazeologjizma, ashtu edhe tek kompozitat (fjalët e përngjitura) janë pothuaj të njëjtë.

Na duket se si kriter themelor këtu duhet të vihet **formëzimi** gramatikor, d.m.th. ekzistenca e trajtave për njësitë trajtëndryshuese dhe mungesa e trajtave, por ekzistenca e lidhjeve të caktuara gramatikore, për njësitë jotrajtëndryshuese. Në lidhje të ngushtë me njësitë foljore (shih më lart «shkel e shko e prapa mos shiko» etj.) njësitë ndajfoljore na duket se perceptohen si konstrakte me strukturë analitike dhe me veçoritë kategoriale të frazeologjizmave, ashtu siç e kemi shtjelluar më lart. Përsa u përket njësave mbiemërore gjendja mund të themi është në kapërcyell<sup>20</sup>, por anon më tepër drejt përngjitjes. Në shumë kontekste, për më tepër, vihet re një barazim funksional i njësave të tilla me njësi të tjera mbiemërore, p.sh. «Një punë e tillë **shkeleshko** dhe e *pakualifikuar*, shpesh herë e *zhvilluar* edhe me nervozizëm, . . zëvendëson mosinteresimin dhe indiferentizmin me mbikqyrje dhe tutelë.» (Mësuasi, 23.7.1965, 2); «. . të bëhet një luftë e papajtueshme kundër punës *gjysmake* dhe **shkeleshko** n'art.» (KP, 1960, I 34); «Punëtorët. . filluan të ndjejnë përgjegjësinë e madhe morale për punën e *pakujdesëshme* dhe **shkeleshko**, e cila i sillte dëm pasurisë socialiste.» (ZP, 27.2.1965, 2) etj. Padyshim, ky paralelizëm nuk duhet të kërkohet gjithnjë, d.m.th. s'duhet të ngrihet në kriter, për të pranuar përngjitjen, për më tepër se mungon edhe një formëzim mbiemëror i plotë. Për njësitë emërore puna është më e qartë, procesi i përngjitjes pothuaj është përfunduar. Si fazë e parë ka qenë një substantivim pa trajtëformime, por me lidhje gramatikore të qarta e karakteristike për njësitë emërore, p.sh. «. . fërkoj duart, sikur me këtë fjalë të paskish shpaguar atë **qesh e ngjesh**», me të cilën zu bisedën Piloja dhe vazhdoi Leksi.» (Xoxa, LV III 202). Si fazë të fundit kemi një përngjitje të plotë me trajtëformime të qarta e karakteristike për njësitë emërore, p.sh. «Në këto e sipër u dëgjua një zhurmë e çuditshme që vinte nga dhoma e poshtme e pallatit, një **çapejak**<sup>21</sup> *njerëzish*, një pëshpëritje zërash të mbytur.» (S, 295); «Mbi shkallët e gjata ishte një **çapejak**<sup>22</sup> *i vazhdueshëm*, një mizëri grash. .» (S, 266); «Kum! kum! kolla e hallës aty pranë. **ÇapejakU** *i të jatit*. Hungrimi i balos.» (Nëndori, 1963 VIII 61); «Futi pasqyrën në xhep dhe *filloi* **çapejakUN** gjatë bregut të detit.» (Abdihoxha, NK 10); «Në këtë mënyrë, me **çapejakET** e të dërguarve për marrëveshje, koha kalonte. .» (S, 334) etj.

Si tipar i përbashkët formal i këtyre frazeologjizmave është edhe struktura: bashkërenditje këpujore e dy foljeve në urdhërore njëjës. Me gjithë këto tipare të përbashkëta, siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, këta frazeologjizma nuk kanë gjithnjë të njëjtën vlerë semantike-funksionale as ndërmjet njëri-tjetrit as në vetvete. Natyra gramatikore e gjymtyrëve nuk përcakton atë të frazeologjizmit. Gjithashtu edhe zhvillimi i tyre nuk është i njëjtë: njëri mund të jetë edhe foljor ose mbiemëror, tjetri jo, njëri mund të ketë arritur edhe deri në fazën e përngjitjes e tjetri jo etj. Por veçoritë kategoriale të frazeologjizmave

20) Kur themi në **kapërcyell** nuk mendojmë se tek të njëjtat njësi procesi i përngjitjes është në mesin e rrugës, në të kryer e sipër, por se mund t'i gjejmë, në raste të ndryshme, edhe si frazeologjizma edhe si përngjitje.

21) Në tekst **çap-e-jak**

22) » » **çap e jak**.

(kuptimin leksikor, funksionin, strukturën etj.) ata i kanë që të gjithë.

Së fundi, kemi një grup frazeologjizmash me bashkërenditje, po të një strukture tjetër: gjymtyra e dytë është një emër me parafjalë, pra, kemi një bashkërenditje dy gjymtyrësh joekuivalente nga struktura. Të tillë janë **fill e për pe, orë e pa kohë, rrallë e për mall** e ndonjë tjetër. [«Pastaj tyxhari e *kishte pyetur fije e për pe mbi gjën'e gjallë*, shqerrat, lopët, buajt, buallcat, pelat, derrat. . .» (Xoxa, LV II 229); «Në këtë gjen-dje shpirtërore më pëlqente të *sillja nëpër mend fije e për pe ngjarjet e asaj dite*.» (Nëndori, 1968 XII 100); «Dhe i rrëfeu *fije e për pe gjithë ngjarjen* me tre ortakët. . .» (Xoxa, LV III 10); «E mora mënjandë dhe i *tregova fill e për pe* atë që kishte ndodhur në xhadë.» (Karadaku, RrP 38) etj. — «hollësisht»; «Me gratë duhet të jesh i hedhur, — i pat thënë kryetari me një ton shoqëror, — jo si ti që i *var turitë or'e pa kohë*.» (Shaplllo, BH 67); «E, o burrë, të dhëmburat të kanë zënë, që po më *thërret kësisoj or'e pa kohë?*» (Xoxa, LV II 183-189); «Pse s'thua ti. . . andaj më *ngriheshe or'e pa kohë*, e jo ashtu, si i ha zemra sime mëje. . .» (Xoxa, LV III 93) — krh. edhe FGjSh 435 te **PRORE**; «Nga qentë iu kujtue beu i madh, që vinte nga Elbasani në çiflik **rrallë e për mall** për të gjuajtë.» (Nëndori, 1967 IX 76) etj.]. Këta janë të ngjashëm me grupin **vend e pa vend** etj. dhe në përgjithësi tregojnë mënyrë e kohë. Megjithëse nga gjendja e sotme e strukturës, e funksionit dhe e kuptimit në mund t'i përfshijmë këta frazeologjizma në një nëngrup, nga ana e formimit dhe e veçorive të tjera që kanë të bëjnë me lidhjet paradigmatiche dhe sintagmatike<sup>23</sup> të frazeologjizmit, ata dallohen njëri nga tjetri. Kështu mendojmë se **fill e për pe** dhe **orë e pa kohë** do të kenë ardhur prej strukturash me bashkërenditje gjymtyrësh leksikisht dhe gramatikisht homogjene, si: **për fill e për pe, pa orë e pa kohë**, kurse **rrallë e për mall** nga një bashkërenditje kundërshtore gjymtyrësh as leksikisht as gramatikisht homogjene, si: **rrallë por për mall**<sup>24</sup>. Nga lidhjet sintagmatike, siç duket nga shembujt e mësipërm, dallohet në mënyrë të veçantë frazeologjizmi **fill e për pe** prej dy të tjerëve — ai ka lidhje më të hapura, formon sintagma më të gjera, ku përfshihet jo vetëm folja, po edhe emri për të cilin bëhet fjalë. Krh. p.sh. *pyes (flas, tregoj, rrëfej* etj.) **fill e për pe për (mbi) diçka** dhe *ngrihej orë e pa kohë ose vinte rrallë e për mall*.

Siç është thënë edhe më lart (shih f. 15), frazeologjizmat e formuar me bashkëlidhjen e dy fjalëve semantikisht korelative janë, me ndonjë përjashtim fare të rrallë, me bashkërenditje. Mendojmë se kjo duhet shpjeguar me rolin e gjymtyrës së dytë në një strukturë të tillë. Në përgjithësi kjo gjymtyrë, nga ana e funksionit që kryen në strukturën e frazeologjizmit, është ekuivalente me gjymtyrën e parë, megjithëse semantikisht, të shumtën e rasteve ajo e plotëson atë, duke shënuar cakun e kundërt (**natë e ditë, kokë e këmbë, botë e qiell, fund e krye, fund e maje, mbarë e prapë, gjerë e gjatë, gjallë a vdekur, lart e poshtë, ec e jak** etj.), ose duke i shtuar një element plotësues e përforcues (**hundë e buzë, kashtë e koqe, hollë e gjatë, rreth e rrotull, majë e brisk, lesh e li, sy e veshë, urtë e butë, kryq e tërthor, fill e për pe, orë e pa kohë, rrallë e për mall** etj.), ose së fundi, duke e çuar më tej, në një tjetër lloj,

23) Shih V.G. Gak, *Besedy o francuzskom sllove*, M. 1966, f. 9.

24) Krh. **për fill — për pe, pa orë — pa kohë** si emra në të njëjtën rasë me të njëjtën parafjalë dhe **rrallë — për mall** si ndajfolje dhe emër në një rasë të caktuar e me parafjalë.

veprimin e gjymtyrës së parë (**shkel e shko, folë e qesh, qesh e ngjesh**).

Bashkërenditja në të gjitha rastet është këpujore, po vetëm me lidhëzën *e*<sup>25</sup>. Kjo nuk mund të zëvendësohet me asnjë lidhëzë tjetër këpujore (as me **dhe, edhe**), gjë që tregon se sa thellë ka shkuar ngurosjja formale e këtyre frazeologjizmave. Siç duket, lidhëza e fonetikiist ka lehtësuar afrimin e dy gjymtyrëve të frazeologjizmave, kurse në rastet e përngjitjes (në delokutivët), del në funksionet e një zanoreje lidhëse (**ecëjak, çapejak, shkeleshko**), megjithëse fonetikiist është *e* panevojshme. Ruajtja e saj do shpjeguar me moshën e re të këtyre formimeve dhe me prirjen për t'u ruajtur e qartë struktura.

## II. GRUPI I FRAZELOGJIZMAVE NDAJFOLJORË ME LIDHJE TË JASHTMË (SINTAGMATIKE) TË SHPREHURA.

Grupi i frazeologjizmave me përsëritje që pamë gjer tani, me gjithë lidhjet e brendshme të bashkërenditjes e të nënrenditjes, nuk i ka të shfaqura lidhjet e jashtme, d.m.th. nuk ka mjete lidhëse ose mjete të tjera gramatikore për të shprehur lidhjet sintagmatike. Grupi i dytë, që do të shtjellojmë më poshtë, ka të tilla mjete, lidhëza krahasuese dhe parafjalë. Si lidhëzat edhe parafjalët përbëjnë kufirin nistor dhe janë elementë të domosdoshëm të frazeologjizmave; ato shprehin marrëdhënjet gramatikore të frazeologjizmave me fjalët e tjera në fjali. Gjithë këta frazeologjizma lidhen me folje dhe plotësojnë ato. Por kur elementi krahasues ka rënë, atëhere folja vetë është bërë gjymtyrë e frazeologjizmit.

Si elementë krahasues në ndërtimin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe përdoren si dhe sa, kurse si parafjalë **me, për, në / tek, pa**.

### A. Ndërtimet frazeologjike me elementë krahasues

1. **Me lidhëzën *Si***<sup>26</sup> Me këtë lidhëz formohen frazeologjizmat si sytë e ballit, si në pëllëmbë të dorës<sup>27</sup>, si dritën e syrit, si sëpata pa bisht, si qe të vjedhur, si qeni në vreshtë, si kau balash, si cjapi te kasapi, si e jëma e Zeqos majë thanës, si kali qorr (si kalë karroce), si kripa në ujë, si peshku në zall, si peshku pa ujë, si këmbët e dhisë, si dhëntë pa bari, si rrodhja pas gunës, si mishi me thoin (me kockën), si gjëlperat majë më majë, si macja me minë, si dhëntë në vathë, si veza në kulaç, si këpurdat pas shiut, si kali në lëmë, si bukën me djathë, si kofini pas së vjelash, si frëngu pulën, si breshka te nallbani, si Baka me Zekën,

25) Bën përjashtim **gjallë a vdekur**, që gjendet rrallë edhe **gjallë e vdekur**, si një riformim analogjik i gabuar.

26) Mbase këtu do parë një parafjalë dhe jo një lidhëz.

27) Ky frazeologjizëm me foljet **shoh, duket** përdoret me lidhëzën krahasuese, kurse me foljen **mbaj** pa këtë lidhëz: «*Të m'i mbash këta djem në pëllëmbë të dorës e të m'i velësh me përralla.*» (Kuteli, NT 65); «*Si mbath unë? Si mbaj në pëllëmbë të dorës?*» (Shuteriqi, Ç II 167); «*Ata duhej ta mbanin në pëllëmbë të dorës Ervehën, se ajo kërkonte t'u çelte sytë grave.*» (Marko, AM 278); «*Po dhe Xhoni rrit n'sallone. /Do më mbajë n'pëllamb të dorës.*» (Estrada, 1967 XII 9) etj. Megjithatë, në të dyja rastet ai ka kuptimin ndajfoljor «shumë mirë», me nuancat përkatëse, sipas foljeve me të cilat lidhet: «shumë qartë», «shumë mirë ekonomi-kisht» etj.

si burri me burrin, si maçoku në thekërr, si gjel në pleh, si rrufeja në qiell të kaltër, si flakë e kashtës (si flakë kashte), si dy e dy bëjnë katër, si rruar qethur, si buka që hamë etj.

Para se të analizojmë këtë grup frazeologjizmesh, shënojmë se me të njëjtën strukturë ka në shqipe edhe frazeologjizma mbiemërorë, sepse mund të krahasohen jo vetëm cilësitë e veprimeve, por edhe cilësitë e sendeve. Kështu janë mbiemërorë frazeologjizmat: **si qimja në qere, si rreth unaze, si gur varri, si pulë e lagur, si kalë pa fre, si mëngë në mes të kurrizit** etj. («Vështronin... të pikëlluar arën e tyre të shkretuar, me ndonjë fije gruri të rrallë si qimja në qere.» (Xoxa, LV II 8); «Mes i saj si rreth unaze.» (Çajupi, V 81); «... ndejë harrue si gur vorri e mendjen hu.» (KLSH); «Anglia kalon një krizë shumë të rëndë ekonomike, natyrisht dhe politike, ajo është bërë si pulë e lagur, rron nën hijen e daj Samit.» (E. Hoxha, FVH 2); «Shima bëhej vaj dhe si pulë e lagur i afrohej gardhit e i fliste Zanit.» (Marko, AM 42); «E ka atë djalin si kalë pa fre.» (KLSH); «Unë këtë punë e kam (si) mëngë në mes të kurrizit» (KLSH, mbl. A. Kostallari, Përmet) etj.

Frazeologjizmat e grupit ndajfoljor tregojnë në përgjithësi mënyrë<sup>28</sup>: «... kontrollin ta organizojë si duhet, duke ruajtur si sytë e ballit ligjet dhe rregullat e vendosura nga partia.» (E. Hoxha, FKT 25); «... e donin si sytë e ballit zonjzën Ceco.» (Kuteli, NT 70); «Gruaja, kur të ka djallë, / të do si sytë ndë ballë.» (Çajupi, V 236); «Kish lindur dielli e ndriçonte gjithë vëndin, që dukej si në pëllëmbë të dorës.» (Çajupi, V 119); «Këtej, nga kati i dytë i shtëpisë së Terpos, fshati dukej si në pëllëmbë të dorës.» (Xhai, DC 73); «Ta kam gjetë një vejushë nja 50 vjeçe, që duket 20 vjeçe, që ka me të rritë fëmijtë e ka me të mbajtë ty si në shplakë të dorës...» (Estrada, 1967 VIII, 68); «E donte të birin si dritën e syrit.» (KLSH); «Pasurinë e përbashkët un e ruej si dritën e syve, sepse unë luftoj me mish e me shpirt për interesin e përgjithshëm.» (Hosteni, 1969 I, 6); «Shkoi si spata pa bisht.» (KLSH); «Pse të bëjmë muhabet si qe të vjedhur?» (KLSH, mbl. H. Pulo, Labëri) — «në errësirë, pa dritë; me frikë»; «Ashtu është, po disa herë njeriu shkon si qeni në vresht! Një informatë e gabuar të jepet dhe ja tek të fiku dreqi! (Petrela, KV 284); «Kingu, dy Kenedët vriten si qentë në vreshtë.» (E. Hoxha, FVH 2); «Kaloj rrugës si kau balash e ndodh që dëgjoj t'i flasin njeri tjetrit: «Merre se ta lashë.» Na dolli boja fare...» (Estrada, 1967 VII 71); «Njihet si kau balash.» (KLSH) — «lehtë, menjëherë»; «— Na paska ardhur si cjapi te kasapi» (Sinaeri, DP 125) — «kuturu, verbërisht, pa ditur se ku vete e ç'e pret.»; «Qysh flet dhe kjo nusja, si e ëm'e Zeqos majë thanës...» (Xoxa, LV III 61); «GORI — Ç'flet ti, more, ç'flet? Ne kërkujmë të drejtat tona dhe qeveria të dërgon ty për të na pajtuar me sipërmarrësit, se u qenka prishur qejfi... Dëgjoni, shokë, dëgjoni... / PALI — Ai zotëria flet si e ëma e Zeqos majë të thanës.» (Papa, M 186) — «kot, në tym.»; «E kishte vënë përpara e vetë vinte pas, menduar, si kali qorr, pa hapur gojën...» (Xoxa, LV III 51); «Gjithë ajo bagëti... po i tretej si kripa në ujë.» (Xoxa, LV II 136); «... tue u përppjekë si peshku në zall.» (KLSH); «Tërë marifeti është që Ballit t'i tërhiqen masat e ai të mbetet si peshku pa ujë.» (Shuteriqi, Ç II 293); «Vaj halli po të kishin të gjithë; do të bë-

28) Termi mënyrë është përdorur në kuptim të përgjithshëm, pavarësisht nga funksioni sintaksor i frazeologjizmit në fjali (si plotës mënyre, krahasimi etj.). Mund të kemi edhe krahasim mënyrash. Këtu përfshihet gjithashtu cilësia e veprimt, shkalla etj.

*heshin barabar, si këmbët e dhisë*<sup>29</sup>, si ti — unë.» (Kuteli, NT 70); «Po nuk qenë komunistët në ballë, të tjerët *mbetën si dhent pa bari*. . .» (Shuteriqi, Ç I 110); «Më shumë aktualë. . . *Të kapemi* pas temës së ditës si. . . *hë*. . . si *rrodhja mbas gunës*.» (Estrada, 1968 I 69); «*Janë lidhur si mishi me kockën*» (KLSH); «Shkojnë si gjëlpërat majë më majë» (KLSH); «Vetëm me të madhen *pat shkuar si macja me minë*.» (Shuteriqi, Ç I 85); «Hej ç'na zuri këtu, *mbledhur si dhentë në vathë*.» (Xoxa, LV II 64); «. . . Gre-majt matanë dhe Koz Dynjaja në mes, si *veza në kulaç, po korruin* pa pushim.» (Xoxa, LV III 80); «*Dolën* ca patriotë *si këpurdha pas shiut*.» (KLSH); «Pas piketimeve për ngritjen e trasesë e të urave. . . puna *do të shkonte si thika në gjalpë*.» (Hosteni, 1968 XV 8); «*Ç'vjen si kofini pas së vjelash?*» (KLSH) «— vonë, pas kohe»; «Heshti, megjithëse atë arë e *kishte paguar si frengu pulën*.» (Marko, AM 48); «Usta Metja për këtë çati *kërkonte si frengu pulën*, se, «pa shko e hip zotrote aty!» — thoshte.» (Drita, 9.2.1969, 3); «*Vajti (e gjeti) si breshka te nallbani*.» (KLSH); «Ata të dy *shkojnë* gjithnjë si *Baka me Zekën*.» (KLSH) — «bashkë, pa u ndarë»; «Në mos, ahere *do të lëftonin* si *burrë me burrin*, për të mbrojtur jetën nga e keqja.» (Noli, HS 124); «*Kapardiset* *si maçoku në thekërr*» (KLSH); «Ai *ngrehur e shkrefur* si kaposhi majë plehut, sa herë që shkon rrugës e *mban kokën lart si kalliu pa bukë*.» (Hosteni, 1969 I 10)<sup>29</sup>; «Mua vetëm për punën e një dokumenti . . . *më solli si kalin në lëmë* për gjashtë muaj.» (Hosteni, 1968 XXIII 3); «*Na erdhi si rrufeja në qiell të kaltër*» (KLSH) — «papurit, papandehur»; «*Ju shua inati si flaka e kashës / si flakë kashte*» (KLSH) — «shumë shpejt»; «*Këtë e di si dy e dy bëjnë katër*» (KLSH) — «me siguri të madhe»; «Ehuha! Sa na vijnë në ditë si ti! Ti dëgjonim të gjitha ato që thoni ju, *do të kishim dalë si rruar qethur*.» (Hosteni, 1968 IX 3); «kur morën vesh se zotimin NSHN-ja e *kishte ngrënë si bukën me djathë*, u alarmuan dhe nisën një ekip prej katër vetësh.» (Hosteni, 1968 XXIII 2); «Që do kemi luftë së shpejti, *këtë e di si buka që hamë*.» (Xoxa, LV III 259) etj.

Mënyra këtu jepet nëpërmjet një krahasimi, d.m.th. si gjymtyrë krahasuese është përdorur një frazeologjizëm. Krahasimi bëhet me sende e veprime të tipizuara gjatë përsëritjes, megjithëse motivohen lehtë. Ky krahasim mund të kuptohet po të perceptohet togu i fjalëve si tërësi, si njësi frazeologjike dhe jo duke shikëputur vetëm gjymtyrën e parë. Gjymtyra e dytë (emër, mbiemër a pjesore qoftë) luan në përgjithësi kundrejt gjymtyrës së parë, brendapërbrenda strukturës së frazeologjizmit, rol përcaktues, kufizues, cilësues e plotësues. Domosdoshmëria e bashkërendimit të kësaj gjymtyre me të parën është një nga premisat për frazeologjizimin e konstrakteve të këtij lloji. Një premisë tjetër është edhe përdorimi i shpeshtë e i zakonshëm i këtyre togjeve në gjuhë. Po t'u shtojmë këtyre edhe tiparet semantiko-funksionale dhe strukturore, atëherë kemi pothuaj gjithë veçoritë kategoriale të frazeologjizmave. Këtë të fundit (anën strukturore) do ta rimarrim më poshtë. Për konstruktet me strukturë fjalie gjithashtu do të flasim përmbledhtas në fund të kësaj ndarjeje.

Në përgjithësi këta frazeologjizma tregojnë një shkallë të lartë të cilësisë së veprimit, prandaj kuptimisht shtjellohen me shkallën sipërore të ndajfoljeve koresponduese (*si sytë e ballit, si në pëllëmbë të dorës, si dritën e syrit, si macja me minë, si kofini pas së vjelash, si frengu pulën* etj. — «shumë mirë», «shumë qartë», «shumë keq», «shumë vonë»,

29) Edhe mbiemërore.

«shumë shtrenjt» etj.<sup>30</sup>). Gjithashtu në përgjithësi ata kanë ngarkesë emocionale, diku më të vogël e diku më të madhe, si tek: **si qeni në vreshtë, si kalë qorr, si këmbët e dhisë, si rrodhja pas gunës, si macja me minë, si breshka te nallbani, si Baka me Zekën** etj.

Nga ana semantike dhe strukturore, me përjashtimet që vijnë prej ndryshimeve ndërmjet frazeologjisë dhe fjalës, këta frazeologjizma janë të barabartë me gjymtyrët krahasuese me **si**, p.sh. **iku si lepur, sillet si pelivan, rron si qen, ecën si patë, punon si kalë, rrëshqet si ngjalë, ha si ujë, luftoi si luan** etj.

Gjithashtu edhe me këta frazeologjizma mund të përdoren, në kontekste të njëjta, njësitë ndajfoljore njëfjalëshe, si: duket *shumë mirë, si në pëllëmbë të dorës*; ecën *kuturu, si kalë karroce*; flet *kot, si e jëma e Zegos majë thanës*; «... do të bëheshim *barabar, si këmbët e dhisë*...» «... *mbledhur, si dhentë në vathë*»; «... në mes, *si veza në kulaç*»; «... e pagoi *shtrenjt, si frengu pulën*»; «... luftonin *trimërisht, si burri me burrin*» etj. Në këto raste, motivimi është edhe më i qartë, frazeologjizmi kryen funksion suplementar në fjali dhe krijohet përshtypja sikur s'është më frazeologjizëm. Ndërkaq ai s'ka humbur ndonjë veçori kategoriale të frazeologjizmit.

Struktura e këtyre frazeologjizmave, me përjashtim të kufirit nistor, është e ndryshme, si nga natyra morfologjike e gjymtyrëve ashtu edhe nga lloji i lidhjeve gramatikore të gjymtyrës brendapërbrenda konstruktit frazeologjik, d.m.th. nga lidhjet paradigmatiche. Për këtë anë nuk ka këtu ndonjë farë rregullsie, që të na lejonte të bënim një përgjithësim, një sistemim ose një grupim. Me rëndësi është këtu të vemë re që ngurosjia formale (në gjymtyrë e në strukturë) është në atë shkallë që është e domosdoshme dhe tipike për frazeologjizmat. Kështu gjymtyrët kanë një vend të ngulitur, kurrësesi nuk mund të ndërrojnë vend dhe nuk durojnë fjalë të tjera të ndërfiten në mes të tyre. Është i fiksuar lloji i lidhjes dhe mjeti lidhës i gjymtyrës së dytë me të parën, madje gjer në atë shkallë sa nuk krijohet as paralelja antonimike e frazeologjizmave; p.sh. kemi: **si sëpata pa bisht, si peshku pa ujë, si dhentë pa bari, si kofini pas së vjelash**, etj., por për të dhënë kuptimin e kundërt, as si togje të lira e aq më pak si frazeologjizma, nuk ekzistojnë «si sëpata me bisht, si peshku me ujë, si dhentë me bari, si kofini para (ose gjatë) së vjelash» etj. Frazeologjizmat lidhen zakonisht me një fjalë, me sinonimin e saj ose me një grup të vogël fjalësh. Është ngurosur **së paku** një gjymtyrë e frazeologjizmave në një formë të caktuar. Kjo mund të provohet duke i marrë frazeologjizmat një për një: t'i kthejmë në shumë emrat njëjës ose anasjelltas, t'i shquajmë emrat e pashquar ose anasjelltas etj. — atëhere frazeologjizmat do të shpërbëhen. Këto tipare strukturore përbëjnë të gjitha së bashku disa nga veçoritë kryesore kategoriale të frazeologjizmave.

2. **Me lidhëzën SA.** — Me kufi nistor lidhëzën **sa**, frazeologjizmat me strukturë togu janë të pakët në gjuhën shqipe. Të tillë janë: **sa frengu pulën** («... e bleu **sa frengu pulën** dhe e shiti për një copë bukë» — (Xoxa, LV III 172); «*Do të na kushtojë sa pula frëngut*, por ama do të na kenë zili të gjithë.» — Hosteni, 1967 XXI 4); **sa gjatë gjerë** («u shtri **sa gjatë gjerë**» — FGjSh, 482); **sa gishtat e dorës** («*Ishim sa gishtat e dorës, pak*» — KLSH); **sa për sy e faqe**, si variant i konstruktit **për sy e faqe** («Po

30) Krh. për rus. Ll. V. Nikolenko, *Frazeologičeskie oboroty, vypollnjajushčije funkciju narečija*, në «Ruskij jazyk v školje», 1955 V. 23.

mbreti trathtar i fshehu armët e ua dha këmbëve, duke e lënë Bazin e Canes të zbrazë n'ja dy herë **sa për sy e faqe**» — Shuteriqi, Ç I 64; «**Sa për sy e faqe** të 20.000.000 zezakëve amerikanë *u është dhënë e drejta e votës.*» — Mësuesi, 8.8.1966, 4; «Dhe së fundi, një ditë, e lodhur dhe e trembur, **sa për sy e faqe u detyrua të thotë**: unë nuk dua të martohem me të.» — ZR, 27.9.1967, 2; «. . . ato *i japin një sovranitet sa për sy e faqe*»<sup>31</sup> regjimit të Bonit. . .» — LB, 159) etj.

Pak më shumë janë frazeologjizmat me strukturë fjalie, si: **sa çel e mbyll sytë** (synë) — «shumë shpejt», **sa të hanë qentë** — «shumë; tepër», **sa të hanë lopët** — «poashtu, **sa të thuash pesë** — «shumë shpejt», (me) **sa kishte në kokë** — «fort, me zë të lartë», **sa të hante syri** — «rreth-errotull e larg», **sa të thotë goja** — «shumë», **sa të jetë jeta** — «përherë, përjetë» etj. [«*I gllapiste* thelat e mishit *sa çel e mbyll sytë.*» (Shuteriqi, Ç II 345); «Këta, **sa çel e mbyll sytë, u grinë me shpatë** ose *u detyruan të merrnin arratinë.*» (HS, 207); «Maqina u trondit, rënkoj dhe u turr si një lingua i madh. Drurët gjatë arave të shkreta *zhdukeshin sa çel e mbyll sytë.*» (Karadaku, RrP 5); «Gjashtëmbëdhjetë vjet e fejuar dhe kurrë nuk e kisha parë të fejuarin tim, kur, ja, **sa të hapësh e të mbyllësh sytë, fejesa u prish.» (Brahimi, ZP 113); «. . . s'i kishin hequr akoma trastat nga krahët kur, fup! **sa çel e mbyll sytë**, mu përpara tyre, na *u del një plak stërplak.*» (PR, 47); «. . . se baltë Korça *ka sa të hanë qentë.*» (Bulka, MÇ 107); Po, pa më thuaj, ku do të gjesh ti një nuse të tillë. ? Në qytet? Po. . . në qytet *ka sa të duash. . .*, pa asnjë lek. . . **sa të hajë edhe qeni.**» (Marko, AM 210); «Tashi çupa *ka sa të hanë lopët*, se djemtë janë në mërgim.» (Kuteli, NT 84), «Lisi, **sa të thuash pesë, / pritë**, bënet pjesë-pjesë.» (Çajupi, V 238); «— Letrën, lavire, ku e çove? — *thërriste sa kishte në kokë gjermani.*» (Nëndori, 1967 IX 87); «. . . po i jepte zjarrin e tij të fundit detit të qetuar dhe kënetës së turbulluar, që *shtriheshin përpara sa të hante syri*» (Xoxa, LV II 140); «*Tërë vendin, sa të hanin sytë, e kishte mbuluar* qiqi i asaj mesdite të nxehtë qershori.» (Zaloshnja, HT 51); «M'i zuri **sa të thotë goja**» (KLSH) — «m'i shiti shumë shtrenjtë»; «*Do ta ruaj sa të jetë jeta*» (KLSH) etj.].**

Ky grup frazeologjizmesh, si dhe ata të trajtuar më lart me **si** (**si dy e dy bëjnë katër, si buka që hamë** etj.) dhe ata me kufi nistor **ku** (**ku ha pula gurë, ku rafsha mos u vrafsha** etj.), që kanë strukturë fjalie, në veçoritë kryesore kategoriale nuk ndryshojnë nga frazeologjizmat e tjerë gjuhësorë. Pyetjes në se kemi fjali apo njësi frazeologjike në këto raste duhet t'i përgjigjemi duke mbajtur parasysht këto veçori të tyre:

a) Kuptimi i tyre është i njëzuar, i asaj natyre si te të gjithë frazeologjizmat gjuhësorë. Nga kjo anë ata identifikohen me fjalët, me ndajfoljet.

b) Përdoren vetëm në planin e dytë të përmbajtjes, në planin e nënkuptuar, frazeologjik. Pra, ata dallohen nga fjalja jo nga struktura, po nga përmbajtja. Kjo përbën idiomatikën e tyre.

c) Fjalët përbërëse kanë humbur tiparet themelore të mëvetësishme të fjalës, si kuptimin e pavarur, format e pavarura, lidhjet e pavarura etj.

e) Dënduria e përdorimit i ka bërë konstrukte të zakonshme e të qëndrueshme në gjuhë.

31) Lidhur me vlerën ndajfoljore ose mbiemërore, që mund të marrë ky frazeologjizëm në varësi nga folja ose emri që plotëson, krh. edhe f. 20 për **shkel e shko** etj. Po kështu: «*japin sa për sy e faqe*» — ndajfoljore, ose «*sovranitet sa për sy e faqe*» — mbiemërore.

d) Kanë forma variante, me ndryshime të gjymtyrëve të veçanta: p.sh.: «Vetëm sa të çduket mjegulla, cikma do të bjerë sa çel e mbyll sytë.» (BP, 110); «(Partizanët) dalin ku s'i pret. Sa çel e mbyll synë të këcejnë sipër.» (Hosteni, 1968 XIII 2); «Diskutimet muarën valë sa të hapësh e të mbyllësh sytë.. Diskutimet muarën valë sa të mbyllësh e të hapësh sytë.. Diskutimet muarën valë sa mbyll e hap sytë.» (Hosteni, 1968 XXII 4); «Befas, me një shpejtësi dhe shkathtësi të pangjarë për moshën e tij të thyer u hodh përpara dhe sa hap e mbyll sytë e rrëmbeu librin nga duart e së shoqes. Të gjitha këto zgjatën vetëm një hop.» (Abdihojha, NK 173) etj. Padyshim, jo të gjitha variantet janë të një vlere nga ana e normës letrare. Të gjitha ndryshimet në gjymtyrët nuk janë shprehëse të lidhjeve sintagmatike të jashtme në fjali, kurse në tërësi frazeologjizmat nuk kanë format paradigmale të fjalisë (ndryshime strukturore tërësore), që varen nga raportet ndërmjet fjalish në periudhë. Kështu, nuk ekzistojnë format frazeologjike: sa çela e mbylla sytë, sa çelim e mbyllim sytë, sa hëngrën qentë, sa të themi pesë, sa thamë pesë, ku ka ngrënë pula gurë, ku hanë pulat gurë, ku rënçim mos u vrafshim etj. Gjithashtu nuk ekzistojnë disa herë as strukturat e plota me lidhje të qarta fjalie, si: sa çel e mbyll sytë ti, ku rafsha e mos u vrafsha unë, sa të thuash ti pesë etj. Mirëpo, kjo e fundit, për shkak të formave variante frazeologjike (më shumë me ndryshimin e gjymtyrës foljore) mbetet një masë ende e pasigurtë, gjë që jep shkas edhe për mendimin se kemi në këso rastesh fjali dhe jo frazeologjizma (p.sh. ka sa të hanë qentë / kishte sa të hanin qentë; thërriste sa kishte në kokë / thërrisja sa kisha në kokë, e dimë si buka që hamë / e di si buka që ha etj.). Por, e theksojmë edhe njëherë, këto mbeten gjithnjë forma variante të frazeologjizmit, mundësia e ndryshimit të të cilit është një gjë e pranuar, brenda një diapazoni jo të plotë formash, d.m.th. jo në tërë sistemin e formave të mundshme. Padyshim, gjendja nuk është aq e qartë dhe procesi nuk është gjithnjë i përfunduar. Këta frazeologjizma ruajnë strukturën e njësisë gjenetike të tyre (të fjalisë) dhe megjithëse janë të tipit ndajfoljor, jo rrallë kanë edhe forma paradigmmatike, si këto që përmendëm së fundi. Por, duke i marrë në tërësi, jo veç e veç, si komplekse, tiparet themelore kategoriale të këtyre konstrukteve, mendojmë se duhet t'i trajtojmë si njësi të frazeologjizuara ose në frazeologjizim e sipër, në kuptimin gjuhësor.

Nga ana semantiko-funksionale frazeologjizmat me strukturë fjalie me sa tregojnë mënyrë, kohë, vend, sasi me nuancë sipërie. Prandaj duhen përqasur, gjatë shtjellimit, me shkallën sipërore të ndajfoljeve koresponduese.

## B. Ndërtimet frazeologjike që nisin me një parafjalë.

Parafjalët në konstrukte të tilla nuk janë elementë fakultativë, po elementë konstitutivë të frazeologjizmave. Me tërë konstruktin frazeologjik ato tregojnë një rrethanë a një tipar të veprimit që shpreh folja, me të cilën lidhen dhe kanë si paralele të tyre strukturore e funksionale «lokucionet» gramatikore ndajfoljore. Më të zakonshme janë konstruktet me parafjalët **me** e **për** dhe më të rralla **me në**, **nga**, **tek** etj.

1. **Konstrukte që nisin me parafjalën ME.** — Konstrukte të tilla ka me bashkërenditje e me nënrenditje.

a) Konstruktet me bashkërenditje përbëhen kryesisht nga emra ose

mbiemra të substantivuar. Parafjala **me** përsëritet zakonisht edhe para gjymtyrës së dytë, pra kemi, si të thuash, një përsëritje strukturore të brendshme: gjymtyra e dytë si strukturë përsërit gjymtyrën e parë. Po kjo mund edhe të mos bëhet. Emrat që bashkërenditen, kanë një farë afërie semantike njëri me tjetrin dhe janë përgjithësisht të një fushe leksikore. Frazeologjizma të tillë plotësojnë folje, mbiemra pjesorë, «lokucione» foljore dhe nganjëherë bashkëvenë edhe me kallëzuesin emëror. P.sh. «Njeriu **jepet** pas një gjëje **me mish e me shpirt**, çkrihet pas saj, ëndëron e ëndëron vjete me radhë.» (Gjata, K I 13); «. . **u dha me mish e me shpirt** pas çështjes së zgjimit të ndjenjave kombëtare të arbëreshëve.» (HLSH, II 208); «Bajram Curri **punoj me mish e me shpirt** për forcimin dhe mbrojtjen e shtetit të ri shqiptar.» (Bashkimi, 7.9.60, 3); «Nasi **luftonte me mish e me shpirt** për popullin (Gjata, PJ 64); «**Me mish e me shpirt** dua (me gjithë zemër): **Dua me mish e me shpirt** që ta mbaroj këtë punë.» (KLSH, mbl. V. Xhaçka, Devoll); «. . **do ta mbronin atë me mish e me shpirt.**» (Mësuesi, 8.1.65, 4); «**Përpiqej me mish e me shpirt**, jepte e merrte gjersa më në fund çau mjergullën, hapi sytë dhe vështrroi përreth.» (Nepravishta, PNF 178); «Partia jonë kërkon. . . edhe nga punonjësit e drejtësisë të **mobilizohen me mish e me shpirt** për kryerjen e detyrave tona» (DP, 1961 VI 71); «Unë besoj, xhaxha, **besoj me mish dhe me shpirt**, plot pasion.» (D, 115); «. . **përpiqej me mish e me shpirt.**» (Ç, 132); «. . **dëshiroj me mish e me shpirt.**» (TP, 110); «. . **përkrrah me mish e me shpirt.**» (DMH, 127); «Qazimi na u bë i njohur në gjithë qytetin si njeri i **dhënë me mish e me shpirt** pas grave të zanatit, pas rakisë dhe bixhozit.» (Abdihoxha, VS 129); «**I lidhur me partinë me mish e me shpirt.**» (SKÇ, 325); «. . **i hedhur me mish e me shpirt** në lëvizjen patriotike.» (Gurakuqi, VZ 88); «Në socializëm pronare të mjeteve të prodhimit janë masat punonjëse, të cilat janë të **interesuara me mish e me shpirt** që t'i përsosin pa ndërprerë format shoqërore të prodhimit.» (BFM, 365); «. . **i ish përveshur punës me mish e me shpirt.**» (Musaraj, ÇR 45); «. . **i ishte vumë punës me mish e me shpirt.**» (Mësuesi, 26.6.62, 4); «Kjo është historia tragjike, por edhe heroike, e një udhëheqësi të thjeshtë popullor, i cili **është me mish e me shpirt besnik** ndaj interesave të popullit.» (Drita, 5.3.1967, 4) etj. Po kështu: «. . **mora vesh me rrënjë e me degë** fisin e saj.» (Xoxa, LV III 173); «. . e **njoh me rrënjë e degë e ia di dhëmbët e dhëmballët.**» (Sinaeri, DP 115); «. . **filloi të shajë me rrënjë e me degë.**» (RP, IV 156); «Por edhe ideologjia kundërrevolucionare, kur mposhtet kundërrevolucionin nga revolucionin, **mbrohet me thonj e me dhëmbë** gjer në vdekje.» (M. Shehu, ZD 2); «Ariu dha fjalë **të sulet në ballë/ me këmb'e me duar.**» (Çajupi, M 149); «**Këta flisnin me gjak të ndezur, me këmbë e duar.**» (Marko, AM 257); «. . të vinë me **qen e me mace.**» (Estrada, 1967 XII 62); «. . **të ftohen të marrin pjesë me kuç e me maç.**» (ZP, 15.3.68, 4); «. . **po djegim me zjarr e flakë** kanunin.» (ZR, 27.9.67, 2 — i dalë me një zgjerim të strukturës); «**Me bukë e krypë pret** mikun në derë.» (Xoxa, LV II 193); «Kam shpresë **t'i marrim këto me hir e me pahir, me dhëlpëri a me trimëri.**» (Noli, HS 31); «. . atyre që e **prisnin me lepe e me peqe, thyer më dysh e me dorë në zemër.** . nuk ua zuri fare me gojë urdhërin.» (Xoxa, LV III 102); «I lumtë një mijë herë auktorit se këto janë **shkruar me din e me iman.**» (DK, 104); «Si duket ai fqinji im e ditka mirë turqishten. . ., i **qe përgjegjur me të qeshur e me të ngjeshur** bujku i varfër.» (Xoxa, LV II 232) etj. Nganjëherë vetë frazeologjizmi është kallëzues emëror, p.sh. «. . të na lajmërosh. . se kush **është me mish e me shpirt** me ata.» (Shuteriqi, Ç II

295) etj.; në këtë rast ai mund të merret edhe me vlerë mbiemërore.

Përgjithësisht ky grup frazeologjizmesh tregon mënyrën e veprimit. Frazeologjizmat **me mish e me shpirt, me rrënjë e me degë, me thonjë e me dhëmbë, me hir e me pahir, me zjarr e flakë** etj. kanë kuptim qartësisht ndajfoljor dhe përqasen kuptimisht me ndajfoljet, por shënojnë edhe një shkallë më të lartë si dhe intensitet, përforcim. Në këtë anë ata kanë më shumë shprehësi në krahasim me njësitë njëfjalëshe. Siç ndodh zakonisht, edhe me frazeologjizma të tillë në fjali përdoren fjalë e shprehje sinonime që përsërisin afërsisht po atë kuptim me qëllim të përforcimit, të rritjes së intensitetit e të shkallës, si të shembulli: «**me lepe e me peqe, thyer më dysh e me dorë në zemër.**» ose: «Rozeta ishte *thellësisht* fetare, **me mish e me shpirt** [fetare], fetare *në kulm.*» (Ço, 114) etj.

Fusha leksikore e foljeve, me të cilat lidhen këta frazeologjizma, nuk është njësoj e gjerë; siç shihet edhe nga shembujt e sjellë, frazeologjizmi **me mish e me shpirt** ka një fushë më të gjerë se të tjerët, bile mund të themi se ka një fushë të hapët.

b) Konstruktet me nënrenditje janë më të shumta edhe si njësi, edhe si strukturë. Më të zakonshëm e më të shpeshtë janë frazeologjizmat me strukturë **me + emër + parafjalë + emër** dhe **me + emër + mbiemër** (ose një fjalë tjetër me funksion cilësues — përcaktues). Konstruktet **me + emër + parafjalë + emër** kanë si parafjalë para emrit të dytë një parafjalë të rasës kallëzore (zakonisht **në, (ndër), (nëpër)**). Të tillë janë: **me gisht në gojë, me bisht në (ndër) shalë, me kokë në torbë (trastë), me duar në presh / me presh në duar (dorë), me shpirt në gojë (në / ndër dhëmbë), me dorë në zemër (me zemër në dorë), me mend në kokë, me buzë në gaz, me qefin në kokë, me pishë në dorë, me armë në dorë, me lotë ndër faqe, me brekë nëpër këmbë** etj. [P.sh. «Ne s'e bëmë të gjatë. U nisëm në drejtim të grykës, duke i lënë gjermanët **me gisht në gojë.**» (Rafail, NG 76); «Fashistët, që *kishin mbetur me gisht në gojë*<sup>32</sup>, zbritën *me një pëllëmbë hundë.*» (Sinaeri, DP 122); «. . ca ua japin këmbëve e *ikin fluturimthi me bisht në shalë.*» (Kuteli, X 72); «Erdhe *pa ftuar dhe ikën me bisht në shalë.*» (Marko, QF 346); «Ujku *shkoi* nga kish ardhë, / *me kokë poshtë, me bisht në shalë.*» (Çajupi, M 139); «. . u zhduk si qen i zgjebosur, **me bisht ndër shalë.**» (Kallamata, SL 31); «Blinim abetare. . I *sillnim fshehur, me kokë në torbë*, se të vrisnin. .» (Kuteli, NT 93); «Kur ishte nënkryetar i këshillit nacional-çlirimtar. . më 1943, atëhere po. . lodhesh ca dhe *punonte me kokë në torbë.*» (Bashkimi, 17.9.1960, 2); «. . di ç'do me thënë të *rrosh* gjithnjë **me kokë në torbët, nën një ankth të paduruar, pa miq, pa shokë, pa familje, pa shtëpi, pa grua?**» (Andoni, DÇ 102);

32) **Me gisht në gojë** së bashku me foljen **lë** mund të merret si një frazeologjizëm i vetëm: **lë me gisht në gojë** «habis, çudis së tepërmi», ose mund të trajtohet edhe si mbiemëror, p.sh. «Ekspozitat. . i **lanë me gisht në gojë** edhe biznesmenët më të shkathët të perëndimit» (Hosteni, 1968 XXIII 9); «Por kryetari frëngëlliti kamxhikun vitëve të kalit. E ky i uruar u bë erë, duke marrë me vete kalorësin e kooperativës e **duke lënë me gisht në gojë** dy nënkryetarët.» (Hosteni, 1968, XXIII 6) — «të habitur, të shastisur.» Po kështu me kuptim jokalistar mund të merret si frazeologjizëm foljor edhe **mbetem me gisht në gojë** — «habitem, çuditem së tepërmi», që është një «njësi supletive semantike» e frazeologjizmit **lë me gisht në gojë**, sikurse folja **mbetem** kundrejt foljes **lë**. Për këtë shih edhe Xh. Lloshin, **Shënime për fjalën dhe togfjalëshin**, në «Studime filologjike», 1966 IV f. 199, në lidhje me frazeologjizmat «pësorë» — «veprorë», **më del boja** — i **nxjerr bojën, më shkon mendja** — **çoj mendjen, më del nami** — i **nxjerr namën** etj. dhe me «konkordancat, semantike» **dal** — **nxjerr, shkoj** — **çoj, hyj** — **fus** etj.

«... *hidhen me kokë në torbë.*» (Tira, ZA 189); «... *me kokë në torbë bëmë përpara.*» (Jorgaqi, EP 75); «*Me kokë në trastë* = me rrezik: Partizanët *ishin gjithnjë me kokë në trastë*» (KLSH, mbl. M. Muho, Tërbaç); «*Po në zëncin ndonjë me presh në dorë, besa!*» (Shuteriqi, Ç II 319); «... *i kanë kapur njerëzit tanë me presh në duar* dhe i kanë asgjësuar sa mbyll e hap sytë.» (Nëndori, 1968 IX 67); «... *me tërë këtë punë të kujdesëshme, nuk po e kapnin me duar në presh.*» (Drita, 17.3.1968, 3); «... *u zu me duar në presh* për një maskarallëk që bëri.» (S, 301); «Partizanët... *luftonin me shpirt në dhëmbë.*» (Frashëri, TNV 7); «*Arriti me shpirt në dhëmbë* te dera e shtëpisë së tij.» (L, 163); «*Ne këtë shoqëri e mbajshim me shpirt në dhëmbë*, mbasi nuk kishim fonde.» (Mësuesi, 12.6.58, 3); «... *arriti me shpirt në gojë* në kasollen e të varfërit.» (100 P, 354); «... *del në krye me shpirt në gojë.*» (Kuteli, TM 172); «*Ai tërë ditën mbarte duhan me shpirt në dhëmbë*, grinte në havan rrëzave.» (Abdiho-xha, NK 224); «... *vazhdon me shpirt ndër dhëmbë* luftën.» (Thirrje PKSH, 7); «*Kuçedra fashiste... po përpëlitet e po përpiket të trembë* popullin tonë, po bëhet trim me zor, si kofini pas të vjelit, po *mbahet me shpirt ndër dhëmbë*» (Thirrje PKSH, 70); «*Po jetoj me shpirt ndër dhëmbë* / s'ngrihem dot i mjeri n'kambë.» (Jakova, KL 101); «*Ata mësonin me përdhunë* dhe e *mbaronin* liceun *me shpirt ndër dhëmbë.*» (Kokona, VJ 123); «*Me gjithë humbjet e mëdha armiku qëndron* me *dëshpërim* dhe *me shpirt ndër dhëmbë.*» (RUP, 1960 XI 45); «— Shoku Hysen, mos dredho! *Na fol me dorë në zemër* dhe kolektivi do të tregohet i drejtë me ty» (Karadaku, RrP 11); «*Muji i pret me dorë në zemër*, u shtron të ngrënë e të pirë.» (Kuteli, TM 76); «... *ia lashë zotrisë sate, që, me dorë në zemër... të gjykosh* e të vendosësh.» (Xoxa, LV II 244); «*Interesi i të dy palëve është që të flasim hapur, me dorë në zemër* e nga pozita të barabarta.» (Nëndori, 1968 IX 60); «*Jam i bindur — mendonte — se ai më pret me zemër në dorë.*» (S, 304); «*Të shkruaj ty me zemër në dorë,* / (Më mësoi të flas kështu Partia ime).» (ZP, 9.2.1969, 3); «*Të rritet vajza e ta pëlqejë vetë. Ashtu me krye në thes nuk e fejoj vajzën unë.*» (Nëndori, 1968 IX 126); «... *vepron me mend në kokë.*» (KLSH); «... *i shpëtuan me qefin në kokë.*» (Bashkimi, 20.9.46, 2); «... *më shiqoi me buzë në gaz.*» (Stërmilli, SD 57); «... *ligjërojnë amblas e me buzë në gaz.*» (Stërmilli, SD 52); «P.P. *ia ktheu të panjohurit me pishë në dorë*: — Tashi të erdhi sosja.» (Sinaeri, DP 125); «*Shqiptarët e këtyre dy qyteteve qëndruan me armë në dorë* kundër padrejtësisë dhe dhunës grabitqare.» (Kuteli, TM 60); «*Gjermanët ikën me brekë nëpër këmbë.*» (Petrela KV 255); «*U kthye dhe iku me brekë nëpër këmbë*, vajti në Fier.» (Zaloshnja, KN 43); «... *me lotë ndër faqe u betova* se do ta përmbush dëshirën e saj.» (Stërmilli, SD 199 etj.).

Nga shqyrtimi i materialit për këtë lloj frazeologjizmesh dalin këto vërejtje:

1) Shumica e frazeologjizmave të tillë lidhen me një grup të kufizuar foljesh. Kështu p.sh. *me gisht në gojë* lidhet vetëm me foljet *lë* dhe *mbes* (mbetem), *me bisht në shalë* lidhet me foljet *iki*, *kihehem*, *shkoj* (jo me të gjitha foljet e lëvizjes)<sup>33</sup>, *me presh në dorë* (dhe variantet formale të

33) Më të ngushtë e kanë fushën e lidhjeve sintagmatike frazeologjizmat me kuptim intensiv të veprimit; ata lidhen kryesisht me foljet e lëvizjes, bile jo me të gjitha foljet e lëvizjes, po vetëm me ato që në vetvete shprehin veprim intensiv (*vrapoj, rend, fluturoj, turrem etj.*). Këtu kemi nga njëra anë, një kufizim leksikor, sipas numrit të kufizuar të foljeve të lëvizjes dhe nga ana tjetër, një kufizim semantik, që përcaktohet nga kuptimi i gjymtyrëve të frazeologjizmit (si *këmbë* te

saj) me foljet **zë, kap** etj. Kjo karakteristikë flet për një përqendrim të kuptimit tek këta frazeologjizma dhe për një kufizim strukturor të mëtejshëm, gjë që në fund të fundit është një shfaqje e idiomatizimit të modelit fillestar të tyre.

2) Më shumë se në llojet e tjera të frazeologjizmave këtu vëmë re variante leksiko-gramatikore, si: **me kokë në torbë / ~ torbët / ~ trastë, me duar në presh / me presh në dorë / ~ në duar, me shpirt në gojë / ~ në dhëmbë / ~ ndër dhëmbë, me bisht në shalë / ~ ndër ~, me dorë në zemër / me zemër në dorë** etj. Kjo gjë, siç mendojmë, ka ardhur nga shpeshpërdorimi, zakonisht nuk ka sjellë ndryshime në kuptimin e frazeologjizmave, me përjashtime të ralla, si te **me dorë në zemër** «miqësisht; me dashamirësi», por edhe «singerisht» dhe **me zemër në dorë** «haptas; singerisht», por edhe «miqësisht». Duket qartë që procesi i frazeologjizimit të tyre ka mbaruar, sepse kanë gjithë tiparet kategoriale të frazeologjizmave. Por në ndonjë rast, si te **me lotë në sy** etj., ruhen ende shumë të qarta gjurmët e semantemës.

3) Përcaktimi i këtij lloji frazeologjizmesh si ndajfoljor duhet bërë, poashtu si për tipat e tjerë, mbi bazën e vlerës që kanë ata kundrejt gjymtyrës (foljore), me të cilën lidhen dhe të cilën e plotësojnë. Por edhe mbi këtë bazë, interpretimi mund të jetë i ndryshëm. Kështu p.sh. **me bisht në shalë** mund të shtjellohet «me turp» dhe «i turpëruar». Kjo vjen nga që konstrukte të tilla përdoren edhe si ndajfoljore edhe si mbiemërore. Përgjithësisht, kur ato lidhen me folje dhe plotësojnë atë, atëherë tregojnë mënyrën e veprimit që shpreh folja dhe në këtë barazohen me «lokucionet» gramatikore ndajfoljore të ndërtuara me njësi leksikore të mëvetësishme dhe një parafjalë, si: **me turp, me vështirësi, me dashuri, me zgjuarësi, me dëshirë, në faj, në rrezik** etj. ose me ndajfoljet **bujarisht, trimërisht** etj. Së bashku me këto kuptime ato tregojnë edhe shkallë, si **me kokë në torbë, me qefin në kokë, me pishë në dorë, me shpirt ndër dhëmbë** etj. dhe kanë ngarkesë emocionale të theksuar, si **me bisht ndër shalë, me dorë në zemër, me brekë ndër këmbë** etj. Në rastet kur në fjali këto konstrukte janë gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror, plotës kallëzuesorë ose kur lidhen e plotësojnë një emër jofoljor, pesha mbiemërore e kuptimit të tyre është më e madhe. P.sh. «Vetë, si ç'më sheh, **jam me një këmbë në varr.**» (Shuteriqi, KP 40) — «shumë plak»; «Ja, edhe Stefani **mbetej me gisht në gojë.**» (Shuteriqi, Ç I 13) — «i çveshur, pa gjë»; «Edhe n'andërr **më shfaqesh me buzë në gaz.**» (Stërmilli, SD 19) — «e qeshur»; «**Je njeri me lakra në kokë** ti Petrit.» (Nëndori, 1968 V 100) — «me mbeturina, i prapambetur»; «**Ishte një ushtri e rraskapitur, me shpirt në dhëmbë,** po akoma e zonja për luftë.» (LP, 375); «. . babai është një plak i mirë dhe simpatik, **me mend në kokë,** por që ka filluar të bëhet si fëmijë.» (AK, 136); — «i zgjuar»; **Hima, me kryet në qiell,** me duart si putra, thuase edhe murin e trashë të kalasë së qytetit e përsheshte me një të goditur.» (Abdihoxha, NK 53) — «shumë i gjatë»; «Ai, **po t'ishite me mend në kokë** dhe me nder, kurrë nuk do ta braktiste arën që i lanë të parët.» (Marko, AM 239); «U gëzua se do të përfitonte ara nga ky **njeri me mend në kokë.**» (Marko, AM 65) — «i zgjuar» etj. Këtu është fjala për disa konstrukte, sepse nuk mund të vihet një kufi i prerë

*me të katra këmbët*; sikurse kjo kemi edhe te grupet e tjera të frazeologjizmave, si *me mend te me mend në kokë* etj., që lidhen zakonisht me folje që tregojnë veprim të njeriut si *veproj, sillem* etj.; *vesh te vesh më vesh* etj. që zakonisht lidhen me folje që tregojnë të dëgjuar, të folur etj. si *flitet, pëshpëritet*) etj.

dallimi për të gjitha. Ndodh që edhe në raste të tilla frazeologjizmi të jetë ndajfoljor, p.sh. «Po edhe Ganiu *ish me kokë në torbë*.» (Shuteriqi, Ç II 149) — «në rrezik»; «.. t'i merрте qepët për asgjë kur ti *ishe me litar në grykë* e i shiste tri herë më shumë.» (Kuteli, NT 71) — «në hall të madh» etj. Duhet shtuar se si tipat e tjerë edhe këta frazeologjizma kanë të njëjtën vlerë edhe kur lidhen jo me foljen, po me emrin foljor që del prej saj, si: *lënja me gisht në gojë*, *kapja me presh në duar*, *sjellja me mend në kokë*, *pritja me dorë në zemër* etj., p.sh. «Kjo *ikje me bisht në shalë*.» (LMU, 273); «.. *ikja nga sytë këmbët*.» (KLSH); «.. nga të *ecurit udhë e pa udhë*, nga kalorimet majë shale.» (Xoxa LV, III 87) etj.

Konstruktet me + emër + mbiemër (ose një fjalë tjetër me funksion cilësues-përcaktues) përbëjnë gjithashtu një grup më vete e të pasur në gjuhën tonë. Më të zakonshme janë ato me gjymtyrë të dytë mbiemërore, si me gjak të ftohët, me zemër të hapur / ~ të hapët / ~ të çelur, me zemër të ngrirë, me zemër të mirë, me faqe të bardhë, me sy të keq, me sy të mirë, me veshë të ngrehur, me zemër të vvarë, me zemër të djegur / ~ të tharë / ~ të zhuritur, me këmbë të mbarë, me buzë të qeshur, me hundë të varur / ~ të lëshuar / me buzë ~, me zemër të thyer, me mendje të ngritur, me gojë të kyçur, me gjak të ndezur, me dorë të shtrirë / ~ të nderë, me këpucë të kuqe, me këmbët e para, me këmbë të mbarë, me ujë të vakët, me zë të lartë, me shpirt të plasur etj. [P.sh. «I huaji s'e prishi terezinë, qeshi nën buzë dhe *vijoi me gjak të ftohët*.» (Sinaeri, DP 125); «.. e *marrim punën me gjak të ftohtë*.» (Estrada, 1967 VIII 67); «.. ata, si komunistë e revolucionarë, të papajtueshëm me të metat e dobësitë e punës së tyre, me zemër të hapur bënë *autokritikë*.» (E. Hoxha, FKT 8); «Pali nuk gënjen, është burrë me karakter, *flet me zemër të hapët*.» (Bashkimi, 18.3.1969, 2); «*Me të folë me zemër të hapët*, moj shoqja N/kryetare, më vjen turp me më pa kush te kroni me bulierë.» (Estrada, 1967 VII 33); «*Të folë me zemër të hapur* xha Tush, se kemi shumë besim te ti.» (KNDH, 116); «Do të më lejosh të të *flas me zemër të çelur*?» (Marko, AM 227); «Zani asnjëherë në jetën e tij nuk e kishte fyer njerinë që i kishte vajtur si mik; e *kishte pritur me zemër të çelur*.» (Marko, AM 309); «*Rojmë me zemër të ngrirë*, / nga frika kërkush s'gëzon!» (Çajupi, M 27) «Njëri si tjetri *mbretëruan një-zet vjet me drejtësi, me faqe të bardhë*.» (KLSH); «*Të gjithë pritshin me padurim e me veshë të ngrehur* se çfarë përgjigje do jepte.» (Stërmilli, SD 108); «Kryetari i Bashkisë kish ca kohë që po e *shikonte djalin me sy të keq*.» (Sinaeri, DP 115); «Ti kujton se hoxha, që ka hedhur lëkurën e qengjtit, i *sheh me sy të mirë fitoret tona*? Kurrë...» (Marko, AM 74); «Nuk i besoj vetëhes dhe më duket sikur e kam pamë n'andërr atë grindje që... e *ndijnë* edhe fqijt *me veshë të ngrehun*.» (Stërmilli, SD 52); «Dhe *rrija pranë zjarrit me veshë të ngritur*.» (Marko, AM 364); *Fashistët u kthyen me duar bosh dhe me hundë të lëshuara*.» (Sinaeri, DP 126); «*Reizi iku andej me zemër të thyer*, plot urrejtje. . për ata që e *shihnin me sy të keq* e që mirreshin me thashë e theme.» (Shaplo, BH 72); «— Lopa duhet të hajë çdo ditë nga 6 kuintalë silazh. — Luaj nga vendi — i thashë vetes —. Një lopë e tillë e *nxirrka* kolegun tim të fermës apo kryetarët e kooperativave bujqësore *me këpucë të kuqe*.» (Ylli, 1968 VIII 17); «Ka të tjerë që bëjnë përpjekje të kritikojnë punën ose njerëzit, por *priten me këmbët e para*.» (E. Hoxha, ZNP 2); «Na *erdhe*, mor bir, *me këmbë të mbarë* në këtë shtëpi.» (KLSH); «*Mbaje me ujë të vakët* dhe hidhja dhe një herë fjalën për një pendë qe, një lopë

e një buacë. » (Xoxa, LV III 34); «. . është thënë *haptazi* dhe **me zë të lartë**.» (AK, 34); «Kishte ndezur zjarrin dhe kishte filluar të *pinte duhan me mendje të ngritur*.» (Marko, AM 428); «I merrej pakëz goja, me që nuk kishte folur për një kohë të gjatë. Dhe më thoshte: — *Tetë vjet me gojë të kyçur!*» (FF, 121); «Këta *flisnin me gjak të ndezur*, me këmbë e duar.» (Marko, AM 257) etj.l.

Jo rrallë këto konstrakte i gjejmë me një gjymtyrë të dytë ndajfoljore (edhe si pjesore): «Nga frikë shkretë / numuron çapët / *fle me sy hapët*, / *me vesh përpjetë*.» (Çajupi, M 80); «Gati *gjithë natën rrij me sy hapët*.» (Stërmilli, SD 142); «Një strukturë e tillë [e shkollës] nuk mund të huazohet, apo të *kopjohet me sy mbyllur* nga një sistem i huaj, por duhet t'i përshtatet vendit tonë.» (E. Hoxha, FKT 51); «Ky vend klimaterik të *pret me krahë hapët*.» (Sinaeri, DP 125); «Sa gëzim i madh kur të më presë kolektivi aty me *duar hapët*.» (Hosteni, 1968 XXIII 5); «*Qëndrojsa me gojë hapun* dhe s'merrsha frymë.» (Stërmilli, SD 62); «Nuk vonoi e *duel* për deret, / *me kokë ulët* n'zyrë u kthye.» (Estrada, 1967 VIII 7); «. . në Kongresin IV-të të Partisë ata *do të thonë me plot gojën, me ballë hapët* se detyrat u kryen. » (Bashkimi, 11.8.60, 2). «Po ky është një të *kuptuar me kokë poshtë* të problemit.» (Drita, 19.2.67, 2); «Fashistët u *kthyen me duar bosh* dhe *me hundë të lëshuara*.» (Sinaeri, DP 126); «— Zot kjo këshillë që të rrëfeva / sot, vlen më tepër / se copë djathit që të rrëmbeva / — tha zonja dhelpër / dhe *iku me bisht përpjetë*.» (Çajupi, M 46) — *ant. me bisht në shalë*, etj. Këta frazeologjizma si strukturë (kuptimore e formale) ruhen ende në përdorim, por paralelisht e shpesh i gjejmë edhe të formëzuar gramatikisht si njësi të vetme, nëpërmjet kompozimit: *rri me duar (të) lidhur(a) / — duarlidhur, rri me duar kryq / — duarkryq, e pres me krahë hapur / — krahëhapur, mbeti me gojë hapur / — gojëhapur, rrinte me kokë ulur / — kokëulur, e pres me ballë hapur / — ballëhapur, doli me faqe të bardhë / — faqebardhë, e lash me zemër (të) djegur / — zemërdjegur, rri me gojë kyçur / — gojëkyçur, ra me kokë poshtë / — kokëposhtë* etj. [P.sh. «Mëmëdheu na thërret dhe ne të *qëndrojmë duarlidhur?*» (Papa M, 192); «Dhe gjithë ato që i thoshte Sala, sikur ja gjenin zemrën Tafës, i cili e *dëgjonte gojëhapur*.» (Marko, AM 28); «*Nuk duhet ndenjuri duarkryq*. . » (Marko, AM 158) etj.l.

Konstruktet me një gjymtyrë tjetër me funksion cilësor-caktues nuk janë aq të shumta. Gjymtyrë e dytë mund të jetë një ndajfolje, emër, përemër (i pakufishëm) a numëror që luan, brendapërbrenda strukturës së frazeologjizmit, funksion cilësues a caktues kundrejt gjymtyrës tjetër, p.sh. «Mund të *them me plot gojën* se ma mbushe mendjen. » (Stërmilli, KS 233); «(Foni, shef plani, është në zyrën e tij. Ha mëngjezin. Troket dera). Foni — **(me gojën plot)** — Hyrë!» (Estrada, 1967 XII 47); «Vita, nga ana e saj, *i shikonte me plot syrin*, i zinte me dorë, mblidhte buzët. » (Xoxa, LV III 158); «Ai nuk dinte në duhej të nxirrte ndonjë fitim nga kjo zbutje. . e Suat bej Vërdhomës, apo në duhej t'i *qëndronte me brirët përpara*.» (Xoxa, LV II 78); «Në çastin kur *priste me veshët bigë*. . të pëlliste ndonjë ka a buall, dëgjoi në rrugë fërshëllimën e të birit.» (Xoxa, LV III 39-40); «Ne jemi punëtorë të botës së re. . dhe *s'mbytemi me një lugë ujë*.» (Estrada, 1968 II 10-11); «Fija bëri sikur u tremb e *murmuriti me gjysmë goje*. . » (Kuteli, NT 68); «Milo Shini uli kryet e *i tha me gjysmë goje*. . » (Kuteli, TM 224); «Troktharakët *prisnin tani, me veshët katër e sytë bigë* ç'do bënin muhaxhirët: . . a do ta nisnin

sherrin. . apo do t'i shtroheshin fatit. .» (Xoxa, LV II 227 = **me veshët bigë e sytë katër**); «*vjedh ai me të dyja duart*» (KLSH) etj.

Përgjithësisht edhe frazeologjizmat e këtij grupi lëkundën, nga ana e vlerës funksionale, ndërmjet ndajfoljes dhe mbiemrit. Si gjymtyrë e kallëzuesit emëror ose si një plotës predikativ zakonisht kanë vlerë mbiemërore. Në shumë raste të tilla ata bashkërenditen edhe me gjymtyrë të tjera mbiemërore, p.sh. «*Kur ish i mitur kish qenë flegmatik, i plogët e me një dërrasë mangut.*» (N, 245): «*Pa tokën pjellore, kooperativa jonë do të jetë e varfër, me dorë të shtrirë nga pushteti ynë.*» (Spasse, AS 4); «*Njeriu në këtë botë, / kur s'ka dituri të plotë, / është si plepi pa fletë, / fodull me kryet përpjetë.*» (Çajupi, V 237); «*Xhemilja mbetet si e shastisur e me gojë hapur.*» (Estrada, 1968 I 60); «*Zani nuk i priti as entuziast e as me buzë të varura.*» (Marko, AM 271); «*Mbeta me gojë hapët dhe e harlisun.*» (Stërmilli, SD 59) etj. Po edhe në rastet e mësipërme vlera e frazeologjizmave përcaktohet, përveç nga lidhjet e tyre sintagmatike, edhe nga motivimi semantiko-funksional. Kështu: *iku me zemër të thyer, doli me këpucë të kuqe, fle me sy hapët / ~ me veshë përpjetë, qëndronte me gojë hapur / ~ hapët, u kthyen me duar bosh, iku me bisht përpjetë, priste me veshët bigë e ndonjë tjetër mund të shtjellohen edhe me ndajfolje (togje ndajfoljore) edhe me mbiemra, sepse mund të motivohen nga ana semantiko-funksionale edhe si shprehëse të mënyrës (a të një rrethane), edhe si shprehëse të një cilësie, në raport me gjymtyrën, me të cilën lidhen.*

Përgjithësisht frazeologjizmat me strukturë të tillë kanë karakter figurativ dhe ekspresiv të qartë. Ata shënojnë mënyrë, bashkë me një shkallë të lartë. Janë, në shumicën e rasteve, të gjuhës së folur popullore. Gjithashtu në shumicën e rasteve janë njësi frazeologjike, sepse mund të motivohen dhe semantema, që përbëhet nga kuptimi i drejtpërdrejtë i togfjalëshit gjenetik, është e qartë. Si edhe grupi i «**sa të hapësh e të mbyllësh sytë**», ka variante formale e leksikore të zhvilluara.

2. **Konstrukte që nisin me parafjalën PËR.** — Ky grup kap pak njësi, po variantet strukturore janë të shumta. Brendapërbrenda është e vështirë të bësh grupime të tjera, si për shkak të varfërisë së njësive të një tipi, ashtu edhe për shkak të mungesës së tipit në vetvete. Ka frazeologjizma me strukturë të brendshme të bashkërenditur e të nënrenditur, me gjymtyrë emërore, mbiemërore etj., me gjymtyrë të dytë me parafjalë e pa parafjalë etj. Shpesh një rast nuk përsëritet më dhe me të nuk mund të formosh as lloj as nëngrup, aq më pak tip. P.sh. «*Gjon Kastrioti dhe bijtë u këthyen Muhamedanë për sy e faqe.*» (Noli, HS 24); «*Në prill t'atij viti u likujdua fraksioni që kryerët e ish grupit të të Rijve kishin krijuar mbrenda në parti, pasi për sy e për faqe e shkrinë grupin e tyre në formimin e partisë.*» (Shuteriqi, Ç II 10)<sup>34</sup>; «*Thonë se dikur për mustaqet e Çelos u bë hataja.*» (Hosteni, 1969 I 11); «*Qenë fjalosur dy veta se të sejtja i kish mustaqet Çelua (Picari), të verdha apo të zeza dhe vranë njeri tjetrin: U vranë për mustaqet e Çelos.*» (A 2 IF, III/a 169); «*Është një turp që njerës të lartë si ne të vritemi për dhjamë qeni.*» (DK, 328); «*. . na shkon. . materiali kot, për dhjamë qeni.*» (Estrada, 1967 XII 48); «*Tani në Mirditë nuk shkon më për dhjamë qeni po të sëmuresh: tre spitale. . 17 ambulanca.*» (Ylli, 1966 XI 18); «*Do të na shkojë mundimi për dhjamë qeni.*» (Sinaeri, DP 122). «*Zhuritej Vurgu,*

34) Krh. me sa për sy e faqe, f. 26-27.

..digjej jeta e vurkarit, digjej dhe *shkonte për dhjamë qeni.*» (ZP, 27.8.67, 2); — «kot, dëm, humbur»; «Ja mbush mendjen edhe kryetarit tonë. *t'i shesin* (dhentë) të gjitha **për dhjamë qeni.**» (Hosteni, 1959 V 8) — «lirë»; «Ju hodh në fyt dhe fut e bjerë e më ta bëri beun **për ujë të ftohtë.**» (Nëndori, 1968 V 27); «U kapën. Dy minuta më vonë, Miti e bëri Tahirin **për ujë të ftohtë.**» (Abdihoxha, NK 95); «Edhe të ndodhë një gjë e tillë **është për faqe të zezë.**» (ZP, 9.III.68, 2); «.. na *mbetnë.* **për faqe të zezë.**» (Kuteli, NT 56); «.. pse na bëre kështu **për faqe të zezë më keq** se ditën e vdekjes.» (Kuteli, TM 184); «**Për fat të mirë** dhe *për çudi* em atë *nuk m'u vërsul* me atë mëllef që më mësyni njerka.» (Stërmilli, SD 94); «**Për fat të keq** vetë e *shkuli nga zemra* e eme at lule dashunije.» (Stërmilli, SD 164); «.. e bleu *sa frengu pulën* dhe e *shiti për një copë bukë*, se theu këmbën në gjah. » (Xoxa, LV III 172); «Edhe fshatarët e tjerë, .. e *kishin shitur* bagëtinë **për një copë bukë.**» (Marko, AM 318) — «shumë lirë»; «Dhjeta e *qëndosur për shtatë palë qeje* dhe e nënvizuar me dy vijëza nga mësonjësja tregonte të kundërtën.» (Ylli, 1968 VIII 17) — «bukur, me merak»; «Ndësinin nga një cigare e *ja shtronin bisedës për shtatë palë qeje.*» (Cerga, DF 15); «Prindërit e Themos na *ishin prishur* me prindërit e nuses. . Dhe përse do thoni ju. **Për pesë para spec.**» (Shuteriqi, Ç I 87) etj.<sup>35</sup>.

Këta frazeologjizma tregojnë mënyrë në një shkallë të lartë dhe me ngarkesë të theksuar emocionale. Ata janë që të gjithë popullorë dhe me përmbajtjen e tyre, duke përfshirë edhe shprehësinë (ekspresivitetin), janë semantikisht të përqendruar (të koncentruar) dhe me fuqi të madhe domethënëse. Në këtë drejtim, frazeologjizmat e përmendur janë më të fortë se korespondueset e tyre njëfjalëshe (p.sh. «kot», «keq», «lirë» etj.), sepse kanë nuancë vlerësuese-emocionale, që nuk e kanë fjalët neutrale «kot», «keq» etj.

**3. Konstrukte të tjera.** — Këtu, nga numri i pakët i rasteve nuk arrijmë dot të krijojmë grupe të veçanta. Si cak nistor i konstrukteve mund të jetë një parafjalë tjetër, si **në, më, nga, tek, pa.** Më të shpeshta janë ato me **në**, pastaj me **nga.** P.sh. «.. një person i tillë *ndodhet në rrugë kryq*, nuk din nga të shkojë. » (M. Shehu, ZD 2); «Apo *s'e kanë në majë të gjuhës* atë, kritikën.» (Estrada, 1967 VII 42); «Salës i turbullua gjaku. Ai për pak sa nuk u ngrit për të thënë fjalët që *i kishte në majë të gjuhës.*» (Marko, AM 339); «Po *na la në bisht të urës.* » (Shuteriqi, Ç I 233) — edhe **te bishti i urës, te këmëza e urës;** «.. *të pritemi me shpata në shesh të burrave*» (Kuteli, TM 173); «.. *mbeti në ditë të pikës.* » (Xoxa, LV III 120) — edhe **në ditë të hallit;** «*Më kini vënë në mes dy zjarresh.* » (Xoxa, LV II 68); «.. do të të gjej edhe **në bri të buallit të futesh.** » (Xoxa, LV III 50); «Tani *mbete në pikë të hallit.* Të vjen festja rrotull moj e zezë.» (Shaplllo, BH 86); «— Ah, mre Tajar, unë *i njoh qentë në majë të gishtave.*» (Abdihoxha, NK 120); «.. *do t'i linin në mes të katër rrugëve gratë e tyre.* » (AK, 193); «.. *vjershat e tyre janë të hartuara në këmbë e në dorë.* » (HLSh, II 386); «.. *mburret e lëvdohet më të katër anët.* » (Çajupi, M 74); «.. *e kaloi.* si i thonë **në vrimën e gjëlpërës.** » (Estrada, 1968 I 5); «.. *bënte allshverishe më të djathtë e më të majtë.* » (KLSH); «*Shko nga sytë këmbët.* » (Cerga, DF 34); «.. më fanitej ajo mjekrra e tij e gjatë. . rasa e tij e zezë. . *ikja nga sytë këmbët* dhe llahtarisesha.» (Marko, UDP 85); «Pastaj, *u vërsulën*

35) Konstrukti e **bëj për pesë para** duhet marrë së bashku, me vlerë foljore.

teposhtës, nga këmbët kokën.» (Shuteriqi, Ç I 66); «E a të keqen, pse vjen nga anë e anës e më bie më qafë mua.» (ShP, 1968 VI 13); «E fituam betejën pa çak pa bam.» (KLSH); «. . kur mblidhen kuajtë, do kemi luftë pa një pa dy.» (Xoxa, LV III 258); «Vërtet ne të vjetrit lypset ta shpejtojim hapin, që t'ju ndjekim pas, po edhe ju mos vraponi kurrë pa mend në kokë.» (Brahimi, ZP 123); «. . kur punon pa mend në kokë, keq të del.» (KLSH) etj. Nuk duhet të përfshihen me këta frazeologjizma rastet, si: *pa hapur gojë, pa çarë kokën, pa lënë gjurmë, pa u vënë re, pa u marrë vesh, pa i rënë më qafë, pa i vënë veshin* etj., që nuk janë njësi të vargut frazeologjik (emëror-foljor-ndajfoljor), po forma frazeologjizmesh foljorë.

Edhe këta frazeologjizma, kur janë gjymtyrë të kallëzuesit emëror ose në funksion të një plotësi kallëzuesor, ose kur lidhen me një emër jofoljor mund të merren me kuptim mbiemëror, p.sh. «. . të mos e lëshonte më kalin, që *la pa mend në kokë* atë dhe beun.» (Xoxa, LV III 173); «Ti, Hilmi gjithnjë *ke qenë pa mend në kokë*. Pra, tani në pleqëri dhe atë pak mend që pate, e humbe fare. U shushate, rrodhe. . .» (Marko, AM 356); «I diktuen në një prozhëm, i qitën me pushkë, *i rrethuen atë të plaguem*, vjazën *pa mend në krye*.» (Xoxa, LV III 110) etj.

Frazeologjizmat e mësipërm tregojnë mënyrë në një shkallë të lartë (si në këmbë e në dorë, *pa çak pa bam, pa një pa dy, pa mend në kokë* etj.; përgjithësisht konstruktet me *pa* tregojnë mënyrë), vend (në bri të buallit, nga sytë këmbët etj.). Në disa raste ata me *pa* u kundërvihen frazeologjizmave me *me*: *me mend në kokë — pa mend në kokë* etj. dhe sikurse ata kanë si koresponduese funksionale «lokucionet» ndajfoljore me *pa*: «*pa mend*», «*pa tjetër*» etj.

**Frazeologjizma-fjali.** — Këta janë konstruktet frazeologjike me strukturë fjalie, d.m.th. kanë gjymtyrë predikative. Ky problem në shqipen rregullisht lind vetëm për rastet kur gjymtyra predikative (foljore) është e pashtjellë. Kur ajo është në një mënyrë të shtjelluar, janë shumë të rralla rastet e frazeologjizmave ndajfoljorë, sepse tiparet kategoriale të frazeologjizmave foljorë, në radhë të parë ana semantiko-funksionale, janë fare të qarta. Frazeologjizmat fjali në gjuhën shqipe, me pak përjashtime, ruajnë modelin sintaksor, të atyre fjalive prej nga janë formuar. Ata kanë zakonisht strukturën e një fjalie të thjeshtë dygjymtyrëshe. Ka edhe raste me më shumë gjymtyrë. Përgjithësisht frazeologjizmat-fjali të shqipes janë rrjedhojë fjalish të varura, prandaj nisin me një fjalë shërbyese ose ndonjë ndajfolje etj., si: **me, sa, tek, ku** etj.

Megjithatë, ngjashmëria e strukturave të frazeologjizmave-fjali me strukturat e fjalive koresponduese gjenetike është thjesht e jashtë. Kjo na ndihmon për të gjykuar vetëm për mënyrën e formimit të këtyre njësisve frazeologjike. Nga vlera semantiko-funksionale frazeologjizmat-fjali barazohen me fjalët.

Megjithë këto, edhe kur kemi konstruktet me gjymtyrë foljore të pashtjella, rrallë kemi të bëjmë me frazeologjizëm jofoljor (d.m.th. mbiemëror e ndajfoljor), meqenëse të shumtën e rasteve kemi thjesht një formë paradigmatiche të frazeologjizmave foljorë dhe jo një njësi tjetër. Kjo duket qartë nga që frazeologjizmat në këto raste janë bërthama predikative të fjalive të caktuara dhe rreth tyre ka një organizëm të tërë fjalësh a fjalish të lidhura me to (si fjalë ose fjali të varura). Kështu, kemi forma paradigmatiche të frazeologjizmave foljorë në fjalitë e pashtjella me paskajoren me *pa* dhe me përcjelloren me **duke**: «Ky të ka ndihmuar për udhëtimin e shpejtmë *pa e marrë vesh ti aspak*.» (DK.

247); «**pa lënë asnjë gjurmë...**» (Abdihoxha, NK 115); «**. pa i rënë më qafë askujt.**» (DK,173); «**.pa i vënë veshin mësuesit.**» (Xoxa, LV III 285); «Diç llomotiti me zë, **pa e çarë kokën për doktorin**, që fliste para tij plot gjallëri.» (Abdihoxha, NK 191); «Ata vraponin përkrah njeri tjetrit **pa vënë re rrëketë e ujit**, **pa çarë kokën për shiun** që u rrihte fytyrën.» (Abdihoxha, NK 89); «**. pa çarë kokën se si ato i mbulonte pluhuri.**» (AK, 28); «**. duke u zënë besë fjalëve të tjerëve.**» (AK, 198); «**.duke i mbyllur çdo shteg bisedimit me kosovarin.**» (Xoxa, LV II 265); «**. duke hequr pas dhe një shumicë të madhe.**» (Noli, HS 6) etj.

Frazeologjizmat-fjali mund të jenë frazeologjizma jofoljorë në dy raste:

Së pari, kur është frazeologjizuar vetëm njëra formë paradigmatiche e frazeologjizmit foljor dhe si njësi e ngurosur ajo përdoret si cilësor, përcaktor ose plotësor i një gjymtyre tjetër foljore ose jofoljore. Kështu kanë përfunduar historikisht ose janë në përfundim e sipër forma paradigmatiche konstruktesh foljore, të cilat në forma të tjera nuk janë frazeologjizma, p.sh. «**Ne kemi lindur këtu, ku ha pula gur.**» (Shuteriqi, ShG 101); «**. pse vjen nga anë e anës e më bie më qafë mua këtu ku ha pula strallë?**» (ShP, 1968 VI 13); «**Ai kthen nga të fryjë era.**» (Nëndori 1968 V 65); «**Bërtiste me sa kish në kokë.**» (ZP, 30.3.63, 3); «**Dhe befasi ai ja mori një kënge të vjetër. Unë e pasova me gëzim sa më hante zëri.**» (Karadaku, RrP 18); «**Shkretojnë mëmëdhenë, / tek perëndon dielli venë!**» (Çajupi, V 86); «**Vinin tek i shpij era.**» (Çajupi, M 117) etj. Këta janë frazeologjizma-fjali me gjymtyrë foljore të shtjelluar dhe kanë vlerë ndajfoljore, më rrallë mbiemërore. Në këtë rrugë janë edhe pak konstruktet me gjymtyrë foljore në formën e pashtjellë të paskajores me për, si: «— A po ky malukati i Kozit, **për të qitur sytë është.** . E pe, e ngatërroi? (Xoxa, LV II 57); «**Ish i bukurë si çupë / dhe për të pirë në kupë.**» (Çajupi, V 68); «**Janë për të qarë hallë, / se të tjer' u hanë mallë.**» (Çajupi, V 110) etj. Këta janë frazeologjizma mbiemërorë dhe në fjali janë gjymtyrë të kallëzuesit emëror.

Së dyti, kur frazeologjizmi në një formë paradigmatiche, pavarësisht nga format e tjera, përdoret si njësi e mëvetësishme në fjali, pa varësi me ndonjë gjymtyrë tjetër, d.m.th. pa u plotësuar prej ndonjë fjale tjetër, p.sh. «**. mue më kaloi dita tue vra miza!**» (Estrada, 1967 VII 75); «**Ruante duke i bërë sytë katër.**» (KLSH); «**. kërkon të dalë fshehurazi pa u vënë re.**» (Estrada, 1968 II 70); «**Me të dëgjuar këto fjalë, pa humbur kohë, dha urdhër.**» (PP, I 388); «**Që të gjitha këto ai i duron pa bërë zë.**» (AK, 53); «**. sëkëlldisem gjithë ditën e Perëndisë vetëm, pa hapur gojë.**» (Xhai, DC 26) etj. Padyshim, këto janë raste të lëkundshme, që mund të merren edhe si frazeologjizma foljorë. Si ndajfoljorë këta frazeologjizma tregojnë mënyrën e veprimit që shpreh folja, me të cilën lidhen, por në formë të fjalës apo të fjalisë kjo është e vështirë të përcaktohet.

\* \* \*

Siç shihet edhe nga materiali që u paraqit këtu për frazeologjizmat ndajfoljorë të shqipes, ky grup është i pasur me lloje të shumta strukturalash, me nuanca të ndryshme kuptimesh. Më të kristalizuar si frazeologjizma janë veçanërisht ata të grupit të dytë, d.m.th. konstruktet me kufi-nistor një lidhëz a një parafjalë. Grupi me përsëritje është më pak i kristalizuar dhe disa raste të veçanta mund të merren edhe si për-

dorime të lira fjalësh me vlerë gati njëplanëshe. Në këtë punim ato megjithatë janë përfshirë, me qëllim që të vihet në dukje ai dallim kuptimi, ngarkese e stili që kanë në krahasim me fjalët përgjegjëse, që vjen, siç është thënë në vendin e vet, nga një zhvillim i mëtejshëm i semantemes me një «zhvendosje» përgjithësuese dhe të figurshme dhe që u jep tipare të frazeologjizmave. Ky vështrim besojmë se ndihmon në zbërthimin dhe ndriçimin e mëtejshëm të strukturës semantike të këtyre konstrukteve. Këtu kemi dhënë grupimet kryesore, me tiparet strukturore e semantiko-ekspresive kryesore. Por nga vetë natyra e frazeologjisë, kërkohet një thellim studimi me analizë semantiko-strukturore më të imtë të grupeve më të vogla, madje edhe të njëjste të veçanta.

Materiali zbulon jo vetëm vlerën semantiko-funksionale të frazeologjizmave, por edhe veçoritë e lidhjes së tyre në fjalitë e dhëna, gjerësinë e fushës leksikore të fjalëve që plotësojnë, variantet dhe format paradigmatiche, nuancat e kuptimit e të përdorimit etj. Por këto mbeten gjithnjë probleme për t'u shtjelluar më tej në mënyrë më të gjerë. Nga materiali del gjithashtu se shumë frazeologjizma ndajfoljore shqipja i ka për të shënuar mënyrën, një mënyrë të përgjithësuar (duke përfshirë edhe krahasimin), kohën, vendin dhe më pak për llojet e tjera të kuptimeve ndajfoljore. Por më tepër se ndajfoljet njëfjalëshe ose lokucionet gramatikore ndajfoljore, frazeologjizmat ndajfoljorë kanë një mbivlerë semantiko-ekspresive dhe stilistike (shënojnë shkallë, zgjatje, përsëritje, mbarim, vazhdimësi, periodicitet, reciprocitet etj.). Në një vështrim më të gjerë, frazeologjizmat ndajfoljorë të mënyrës (veçanërisht ata të tipit me *si*, që përmbajnë një krahasim), bashkë me frazeologjizmat mbiemërorë, mund të përmbliken në një grup me një vlerë më të përgjithshme, — në grupin e frazeologjizmave të cilësisë (të cilësisë së vendit e të veprimt).

Një pjesë e frazeologjizmave ndajfoljorë janë edhe njësi të vargut frazeologjik, veçanërisht në lidhje të afërt me konstruktet foljore. Megjithatë lidhja nuk është gjithnjë në vijë të drejtë, nga ana e prejardhjes kuptimore, kështu që këtu duhen dalluar dy lloje: Lloji i parë përbëhet nga frazeologjizmat ndajfoljorë me lidhje strukturore me ata foljorë, po me ndryshime të mëvetësishme kuptimi (jo vetëm me ndryshime semantike kategoriale), që nganjëherë shkojnë mjaft thellë. Të tillë frazeologjizma nuk janë të shumtë, por ata duhet të veçohen e të dallohen prej të tjerëve, në mënyrë që të mos vihen në një plan semantik e frazeoformues me togfjalëshat frazeologjikë gjenetikë. Kështu kemi: **mbyll sytë** «vdes» — **me sy mbyllur** «kuturu, hë tym»; **hap sytë** «fig. e bëj të zgjuar, e dituroj» — **me sy hapur** «vigilent, me kujdes të madh»; **hape gojën!** «fol!» — **me gojë hapur** «me habi» etj. Këtu ndoshta kemi formime të pavarura mbi bazën e një ideje të përbashkët. Lloji i dytë përbëhet nga frazeologjizmat ndajfoljorë që kanë një rrjedhje të drejt-përdrejtë semantike, d.m.th. që përveç shndërrimit kategorial, ruajnë të plotë semantikën e togfjalëshit foljor gjenetik, pa pësuar ndryshime të dukshme kuptimore, si **përvesh llërët** — **me llërë përveshur**, **i hap zemrën** — **me zemër të hapur**, **më plasi zemrën** — **me zemër të plasur**, **m'u ngrit mendja** — **me mendje të ngritur**, **e fle mendjen** — **me mendje të fjetur**, **ngre veshët** («Kish plot që ngrinin veshët e hapnin sytë me interes të math. ») (Shuteriqi, Ç I 72) — **me veshët ngritur**, **kyç gojën** («U droth nga inati, po e kyçi gojën.» — (Shuteriqi, Ç I 239) — **me gojë kyçur**, **ngroh zemrën** — **me zemër të ngrohët**, **fut bishtin në shalë** — **me bisht në shalë**, **ja bëj mendjen dhallë**, — **me mendjen dhallë**, **var hundët**

(buzët) — me hundë (buzë) varur, ul kokën — me kokë ulur, shtrohen gjakrat — me gjak të shtruar, ndizen gjakrat — me gjak të ndezur, prish gjakun («Pse na prish gjakun përditë baba?») (Shuteriqi, Ç II, 169) — me gjak të prishur etj.

Por, në gjuhën shqipe, jo gjithmonë frazeologjizmat ndajfoljorë janë njësi të vargut frazeologjik dhe anasjelltas, jo gjithmonë me frazeologjizmat foljorë lidhen frazeologjizma ndajfoljorë me të njëjtën përbërje leksikore. Kështu p.sh., prej frazeologjizmave foljorë bëj ballë, shes mend, marr nëpër këmbë, marr vesh, më zuri goja lesh, bëj be, më jep dorë, ndaj lakrat, i vë kapak, më bie në dorë, mbaj në gojë, ngre krye etj.etj. nuk dalin ata ndajfoljorë (ta zemë: «me mend të shitur», «me lakra të ndara», «me kapak të vënë etj.) ose prej të tillëve si **i hap barkun, i thyej hundën** etj. do të kishim «me bark të hapur», «me hundë të thyer» etj. që s'janë frazeologjizma. Po kështu për frazeologjizmat **me ballë hapur** etj. nuk kemi në shqipe tipin foljor (b.f. **hap ballin** etj.). Prandaj, krahas vargjeve të plota, si: **ul kokën — me kokë ulur — kokëulur** etj., kemi edhe vargje jo të plota si: — **me ballë hapur — ballëhapur** etj.

Nga materiali i paraqitur del edhe një çështje me rëndësi jo vetëm për frazeologjizmat ndajfoljorë, por për gjithë frazeologjizmat gjuhësorë: a mund të flasim për **tipa** frazeologjizmash dhe a mund të bëhet një klasifikim i frazeologjizmave në **tipa**, në kuptimin e mirëfillët të këtij termi?

Në literaturën gjuhësore për frazeologjinë bëhen klasifikime në **tipa** të ndryshëm, si përngjitje, njësi e bashkime frazeologjike, emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore, pasthirmore etj. mbi bazën e parimeve të ndryshme. Po mendojmë se si klasifikimi, ashtu edhe tipat e frazeologjizmave janë konvencionalë. Në bazë të një klasifikimi ose të përcaktimit të një tipi zakonisht qëndron një kriter themelor, p.sh. për përngjitje-njësi frazeologjike motivimi ose mosmotivimi, për njësi-bashkime frazeologjike karakteri i kuptimit të gjymtyrëve (figurativ ose i drejtpërdrejtë), për frazeologjizmat emërorë-foljorë-mbiemërorë etj. ekuivalenca semantiko-funksionale me kategoritë leksiko-gramatike etj. Padyshim, është një klasifikim, por jo një vlerësim i plotë e i drejtë i kriterëve që përcaktojnë tipin në tërësi.

Për karakterizimin e një grupi frazeologjizmash si **tip** duhet të vlerësohen njësoj kriteret semantike, strukturore, funksionale dhe frazeologjizuese. Mirëpo për arsye të veçantisë së formimit historik të frazeologjizmave, gjatë të cilit idiomatizimi thyen orë e çast vijën e drejtë të rregullsisë strukturore dhe semantiko-funksionale, nuk krijohet mundësia e një modeli unik frazeologjizues, pra nuk krijohet **tip**, sipas të cilit të ecin formimet e mëtejshme. Njësi të shkëputura i largohen grupit të vet semantiko-strukturor me një nuancim kuptimi, shprehësie, stili etj. Kështu p.sh. në se ne mund t'i grupojmë në një tip, sipas strukturës, togje të tilla si: **brez pas brezi, djalë pas djali, fjalë pas fjale, kohë pas kohe, natë pas nate** etj. ato shpërndahen në linja të tjera: tri të parat tregojnë vazhdimësi pa shkëputje, **kohë pas kohe** vazhdimësi me shkëputje, kurse **natë pas nate** «vonë», s'tregon fare vazhdimësi. Gjithashtu togjet e fundit nuk kanë arritur në atë shkallë idiomatizimi si **brez pas brezi**. Mund të themi bile se është karakteristikë e frazeologjizmave që gjatë formimit historik dhe gjatë përdorimit të tyre të vazhdueshëm e të dendur fitojnë nuanca të veçanta kuptimore, emocionale, ekspresive, stilistike, duke iu shmangur vazhdimisht tipit semantik të grupit të vet formal. Shkurt, këtu nuk kemi një përgjithësim

strukturor e semantiko-funksional që të çonte në formimin e një tipi, ashtu siç ndodh p.sh. në sistemin e fjalëformimit. Në këtë pikë çështja mund të përqohet me fjalët e përngjitura, ku gjithashtu mungon modeli fjalëformues. Edhe rruga e karakteristikat e formimit të fjalëve të përngjitura dhe frazeologjizmave në përgjithësi janë të njëjta: formim historik, gjatë bashkëpërdorimit të vazhdueshëm e të dendur, desemantizime e shkrirje semantike etj.<sup>36</sup>, veçse te fjalët e përbëra procesi i njëzimit ka përfunduar edhe me formëzimin gramatikor në një njësi të vetme gjuhësore. Përkundrazi, në fushën e formimit të fjalëve të përbëra ka rregullsi, krijohen tipa: emra vepruesish me **-(ë)s, -ar, -tar, -or, -tor** etj. ose emra veprimi me **-im** prej foljesh më zanore dhe me **-je** prej foljesh me bashkëtingëllore etj. — pra një përgjithësim strukturor dhe semantiko-funksional dhe një model formimi të hapur. Modeli strukturor frazeologjik **brez pas brezi**, nga ana e karakteristikave të tij është i njëjtë me modelin strukturor të fjalëve të përngjitura **kudo (cilido, ngado, kushdo** etj.). Ata që të dy mbështeten mbi anën strukturore. Kjo anë është më e dukshme dhe më e lehta për t'u kapur në analizat tona. Ky është edhe shkak që në bazë të klasifikimit të frazeologjizmave ndajfoljorë të shqipes kemi marrë si kriter strukturën dhe vetëm mbi bazën e kësaj ane grupimet e mësipërme mund të quhen tipa, megjithëse nuk është kjo ana themelore<sup>37</sup>. Shembujt grupohen në tipa, kurse tipi në vetvete nuk ekziston, në kuptimin që sipas një modeli të krijuar njësi. Një klasifikim më i mbështetur mund të bëhet mbi bazën e strukturës semantike e formale të brendshme të frazeologjizmave.

Një vëmendje e veçantë gjatë studimit të frazeologjisë i duhet kushtuar kontekstit të ngushtë të frazeologjizmit, fjalës a fjalëve me të cilat lidhet ngushtësisht ai, d.m.th. lidhjeve sintagmatike të frazeologjizmit.

Vështrimi i këtyre lidhjeve ka rëndësi për të kuptuar gjithë natyrën e frazeologjizmit:

36) Në planin e togfjalëshave të lirë e të fjalive, d.m.th. në planin e njërive bazë sintaksore, kemi një abstragim më të madh, të një shkalle më të lartë se në planin e njërive të frazeologjisë, d.m.th. në planin leksikor. Kështu sintaksa studjon strukturat e njërive të veta si mjete shprehëse të ideve (raporteve) të përgjithshme (abstrakte), p.sh. strukturat që shërbejnë si mjete shprehëse të lidhjeve të ndryshme të nocioneve e të gjykimeve; frazeologjia studjon strukturat që shprehin nocione të veçuara, kanë kuptim leksikor dhe që nuk arrijnë të përgjithësohen e të abstragohen deri në atë shkallë sa të shërbejnë si mjete shprehëse të ideve (raporteve) të përgjithshme (abstrakte), sikurse mjetet e planit sintaksor. Prandaj idiomatizmi leksikor nuk lidhet me përgjithësimin (abstragimin) e tipave strukturorë, por me shndërrime (transformime) semantike individuale (të njërive të veçuara). Si rrjedhim, klasifikimi i frazeologjizmave sipas vlerës semantiko-funksionale është i mundshëm vetëm për tipat kryesorë (emëror, mbiemëror, foljor, ndajfoljor), klasifikimi sipas kuptimit nuk është absolut dhe ndihmon për dallimin e grupeve shumë të kufizuara dhe të njërive njëra prej tjetrës, kurse klasifikimi sipas strukturës ka vlerë praktike dhe lehtëson studimin.

Në lidhje me këtë çështje, E.D. Polivanov shkruan se frazeologjia «operon me shprehëse nocionesh individuale (kuptimesh leksikore)», ndryshe nga sintaksa dhe morfologjia, «që kanë si objekt të tyre studimin e simboleve të ideve të përgjithshme (abstrakte)», — E.D. Polivanov, *O foneticeskih priznakah socialno-grupovyh dialektov i v çastnosti ruskovo standartnovo jazyka*, në «Za marksistkoe jazykoznanie», M. 1931, 119.

37) «Njësitë me karakter idiomatik në gjuhë — shkruan V.N. Telija — nga natyra e tyre janë të papërsëritshme dhe individuale. Por ekziston mundësia që, duke u nisur nga tipare të përgjithshme të ekuivalentëve funksionalë idiomatikë të fjalëve në të folur, të trajtohen këto tipare si veçori të një klase.» — V.N. Telija, *vep. e cit.*, f. 189.

1) Këto lidhje kanë rëndësi në radhë të parë për të përcaktuar kufijtë dhe vëllimin e frazeologjizmit. Kështu p.sh. tek sintagma «*flas me zemër të hapur*» frazeologjizmi është «*me zemër të hapur*» kurse tek «*lë me gojë hapur*» (mbetem me gojë hapur») mund të merret si frazeologjizëm edhe gjithë konstrukti «*lë (mbetem) me gojë hapur*», frazeologjizëm i tipit foljor me kuptimin «*habis (habitem), çudis (çuditem)*». Përcaktimi i kufijve dhe i vëllimit të frazeologjizmit, d.m.th. i kufijve nistorë e fundorë të tij dhe i fjalëve që janë elementë organikë të strukturës së tij, ka lidhje edhe me përcaktimin e tipit të frazeologjizmit, të vlerës leksiko-gramatikore të tij, d.m.th. në se është foljor, emëror mbiemëror a ndajfoljor. Kështu, në shembujt e mësipërm *me zemër të hapur* është i tipit ndajfoljor, kurse *lë me gojë hapur* do të merrej si foljor.

2) Kanë rëndësi për të dalluar një frazeologjizëm nga një frazeologjizëm tjetër, sipas tipit, brenda sintagmash të ndryshme. Kështu, p.sh. nga njëra anë kemi «*nuk punohet shkel e shko*», «*e kontrolluan shkel e shko*», «*arna të qepura shkel e shko*» etj., ku «*shkel e shko*» është një frazeologjizëm me vlerë ndajfoljore dhe nga ana tjetër «*pregatitja është shkel e shko*», «*hedh dritë mbi punën shkel e shko*» etj., ku «*shkel e shko*» është një frazeologjizëm mbiemëror. Prej këtej kemi nxjerrë përgjithësimin, që lidhjet sintagmatike kanë vlerë jo vetëm leksikologjike, por edhe gramatikore, se të njëjtat konstrukte frazeologjike që me foljen *jam* (si gjymtyrë e kallëzuesit emëror) me emra jofoljorë ose në funksion të plotësit predikativ janë mbiemërore, me fjalë të tjera janë ndajfoljore (*shkonin udhë e pa udhë, të ecurit udhë e pa udhë; na ndiqnin këmba këmbës, të ndjekur këmba këmbës; e bën punën shkel e shko, hartë e punuar shkel e shko* etj.). Kjo rregull është një përgjithësim, një vijë e përgjithshme dhe si e tillë, padyshim, ka përjashtimet e veta (p.sh. është *për faqe të zezë, mbeta për faqe të zezë, mbeti në ditë të pikës, ishin me kohë në torbë* etj. — ndërkaq janë ndajfoljore).

3) Kanë rëndësi për të dalluar frazeologjizmin nga jofrazeologjizmi. Kjo vlen në radhë të parë për gjithë njësitë frazeologjike, d.m.th. për ata frazeologjizma, togfjalëshi gjenetik i të cilëve funksionon në gjuhë si togfjalësh i lirë. Kështu p.sh. «*e shtynte dheun me këmbë e me duar*» dhe «*fliste me këmbë e me duar*» — «*gjallërisht*», «*e lexoj ditë për ditë*» (= çdo ditë) shtypin» dhe «*ditë për ditë po ky muhabet*» — «*shpesh, dëndur, gjithnjë*», «*çap e jak shpejt!*» (= ec edhe hajde shpejt) dhe «*bariste çap e jak*» — «*varaving*», «*i dogji me rrënjë e (me) degë* dhe *e njoh me rrënjë e (me) degë*» — «*me të gjitha, shumë mirë*», «*roja rrinte me armë në dorë*» dhe «*shqiptarët qëndruan me armë në dorë*» — «*në gatishmëri; me trimëri; duke luftuar*» etj.

4) Kanë rëndësi gjithashtu edhe për të dalluar kuptimet, nuancat kuptimore dhe vlerën ekspresivo-emocionale të fjalëve. Kështu kemi: «*ka ardhur lumi degë më degë*» dhe «*kur flet këcen degë më degë*»; «*ishte lyer vesh më vesh*», «*flisnin vesh më vesh*» (fshehurazi) dhe «*fjala vajti vesh më vesh*»; krhs. edhe *gojë më gojë*; «*u gjend ballë për ballë*» (kundrejt, njëri karshi tjetrit) dhe *luftuan ballë për ballë*» (trimërisht) etj.

5) Këto lidhje kanë rëndësi edhe për të vendosur drejt lidhjet e përmbytjes së frazeologjizmit me realitetin, me botën sendore (p.sh. me njerëz, kafshë, sende, veprime, cilësi etj.). Kjo ka të bëjë edhe me përdorimin e frazeologjizmit.

6) Ato kanë rëndësi së fundi për të identifikuar vlerën semantike e

funkionale të frazeologjizmit me njësi të tjera homogjene, që përdoren si identifikuese në fjali. Kështu identifikohen në fjali frazeologjizma të tillë si: «ishte *thellësisht* fetare, **me mish e me shpirt**, fetare në kulm», «do të bëheshin barabar, si **këmbët e dhisë**», «vinte pas *i menduar*», **si kali qorr**, *pa hapur gojë*», «luftonin *trimërisht*, **si burri me burrin**», «e pagoi *shtrenjt si frengu pulën*», «ashtu *ara-marra e shkel e shko*», «ikën *kuturu, rrugë pa rrugë*» etj., ose me shprehje e fjali të tëra shtjelluese e krahasuese (si: «Puna stërvitore.. është bërë **shkel e shko sa për të kaluar radhën**»; «punohet **shkel e shko, pa e vlerësuar kohën e punës, pa zbatuar disiplinën dhe rregullin në punë**...»).

Po si identifikues mund të merren edhe fjalë e fjali që s'kanë të njëjtin kuptim me frazeologjizmin, porse kanë të njëjtën vlerë e funksion (ndajfoljor a plotësor). Këta janë identifikuesit funksionalë, si «flet *shtruar dhe me mend në kokë*»; njohuritë të fitohen *mirë e jo shkel e shko e shpejt*; kish qenë *flegmatik, i plogët e me një dërrasë mangut*; «nuk i priti as *entuziast e as me buzë të varura*» etj. Identifikues të tillë ndihmojnë për të përcaktuar tipin e frazeologjizmit nga ana e vlerës së tij. Përgjithësisht identifikuesit bashkërenditen me frazeologjizmat. Por në gjuhën shqipe një rol identifikues luan nganjëherë edhe vetë frazeologjizmi, siç ndodh p.sh. me frazeologjizmat që nisin me **si**: (e pagoi *shtrenjt, si frengu pulën* etj.), ku fjala identifikon frazeologjizmin nga funksioni dhe kuptimi, kurse frazeologjizmi identifikon fjalën nga kuptimi, e shtjellon dhe e plotëson përmbajtjen e saj në rolin e një identifikuesi semantik.

Trajtimi leksikografik i frazeologjisë në fjalorin e adhshëm shpjegues të gjuhës së sotme shqipe është dhënë në vija të përgjithshme prej A. Kostallari në «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»<sup>38</sup>.

Nga vendi që do të zënë në strukturën leksikografike të fjalës bazë, frazeologjizmat ndajfoljorë do të ndahen në dy grupe: frazeologjizma që lidhen me kuptime të veçanta të fjalëve bazë e si rrjedhim do të vihen nën këto kuptime dhe frazeologjizma që nuk lidhen me kuptime të veçanta të fjalëve bazë e si rrjedhim do të vihen pas shënjes konvencionale të frazeologjisë. Të grupit të parë janë frazeologjizmat ndajfoljorë plotësisht të motivueshëm, me lidhje të qarta ndërmjet kuptimit frazeologjik dhe semantemës, pa karakter të theksuar idiomatik etj., siç janë një pjesë e frazeologjizmave me përsëritje të së njëjtës gjymtyrë: **anës e anës, fët e fët, larg e larg, mirë e mirë, shpejt e shpejt, keq e më keq, thellë e më thellë, breg më breg** (në një kuptim), **derë më derë, fshat më fshat, gur më gur, ballë për ballë, sot për sot, natë për natë, ditë për ditë, fjalë për fjalë, fjalë pas fjale, herë pas here, punë e pa punë, dalë e pa dalë, dita ditës, këmba këmbës** etj. dhe një pjesë e frazeologjizmave që formohen nga dy fjalë të lidhura kuptimisht: **natë e ditë, fund e majë, urtë e butë, lart e poshtë, gjerë e gjatë, rreth e rrotull, andej e këndej, rrallë e për mall**.

Por pjesa më e madhe e frazeologjizmave ndajfoljorë do të jepen në Fjalor pas shënjes konvencionale, si njësi më vete e të pavarura, me shpjegime për kuptimet dhe vlerën e tyre emocionale e stilistike, si dhe me ilustrimet përkatëse<sup>39</sup>. Kështu do të jepen një pjesë e frazeologjizmave

38) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, në «Studime filologjike», 1968 II 82-91.

39) Shih A. Kostallari, *art. i cit.*, f. 87-91.

me përsëritje të së njëjtës gjymtyrë ose që përbëhen nga dy fjalë të lidhura kuptimisht, kur semantema është errësuar dhe kanë karakter të theksuar idiomatik, si: **degë më degë, flakë më flakë, pikë për pikë, brez pas brezi, hundë e buzë, shkel e shko, fill e për pe** etj. si dhe përgjithësisht frazeologjizmat e grupeve të tjera. Megjithë këto gjatë punës së hartimit të fjalorit trajtimi leksikografik i frazeologjizmave ndajfoljorë do të bëhet një për një dhe në raport edhe me tipat e tjerë. Në këtë lidhje sistemore dalin dy probleme:

1. Vendi i frazeologjizmave ndajfoljorë në lidhje me foljorët e mbiemërorët dhe mënyra e trajtimit leksikografik të tyre. Frazeologjizmat ndajfoljorë që s'kanë lidhje prejardhjeje me tipin foljor do të jepen në fjalor njësoj si togfjalëshat frazeologjikë të tipave të tjerë, duke mbajtur parasysh po ato shpjgohet dhe në lidhje me formën (p.sh. kur ka sinonime për gjymtyrët, kur ka variante formale, kur ka gjymtyrë fakultative, si përemra etj.). Kuptohet që për gjithë tipin ndajfoljor nuk shtrohet problemi i formave dhe i varianteve formale të frazeologjizmave.

Frazeologjizmat ndajfoljorë që kanë lidhje prejardhjeje me ata foljorë dhe që formojnë me ta një varg frazeologjik, gjithashtu do të jepen në fjalor, por gjithnjë në lidhje me këtë varg frazeologjik: në fillim do të jepet, do të shpjgohet dhe do të ilustron konstruktin foljor, pas tij ai emëror (kur ka të tillë) dhe pastaj konstruktin ndajfoljor (p.sh. **jap llogari... dhënia llogari; e mbylli gojën... mbyllja e gojës... me gojë mbyllur** etj.). Meqenëse tipi emëror nuk është i zakonshëm në përdorim dhe është karakteristik vetëm për gjuhën e shkruar, atëhere frazeologjizmat ndajfoljorë më të shumtat e herëve do të vijnë menjëherë pas atyre foljorë.

2. Frazeologjizmat që do të jepen në fjalor do të shpjgohen dhe do të ilustron, jo vetëm kur kanë ndryshime kuptimi në krahasim me frazeologjizmin foljor të vargut të tyre, por edhe kur nuk duken ndryshime të tilla<sup>40</sup>. Kjo përputhet edhe me mënyrën e trajtimit leksikografik të fjalëve (si p.sh. **natë-a f.** dhe **natën ndajf., buzë-a f.** dhe **buzë prfj.** etj.), me ndryshimin se frazeologjizmat nuk do të jepen në titull dhe nuk do të kenë shënime gramatikore. Funkcioni gramatikor i tyre do të dalë përmes shpjgimit.

Shpjgimi jo vetëm do të jetë një identifikues semantik e funksional i frazeologjizmit, por do të përmbajë të dhëna edhe për veçoritë stilistike, për vlerën emocionale. Formulimi i shpjgimeve do të jetë i njëjtë me ato të të gjitha ndajfoljeve. Frazeologjizmat që në lidhje të caktuara sintagmatike kanë vlerë edhe të mbiemrit edhe të ndajfoljes, do të jepen e do të shpjgohen dy herë — si mbiemra e si ndajfolje, — si njësi të një vargu frazeologjik.

Në lidhje me çështjen se te cila fjalë do të jepet frazeologjizmi puna është më e thjeshtë: frazeologjizmat me një fjalë të përsëritur do të jepen te kjo fjalë; frazeologjizmat e tjerë do të jepen me shpjgimet e ilustrimet përkatëse te fjala e parë shënuese, kurse te fjala tjetër shënuese do të jepen me referim.

Frazeologjizmat ndajfoljorë, së bashku me tipat e tjerë të frazeologjizmave, duhet të zënë vend edhe në tekstet shkollore të gjuhës, si dhe në punën praktike për pasurimin e fjalorit të nxënësve.

<sup>40</sup> Këtu është fjala për ndryshime kuptimore të mëvetësishme, jo për ndryshime semantike kategoriale.

## SHKURTIMET

- Abdihoxha, VS** — A. Abdihoxha, «Një vjeshtë me stuhi», 1959.  
**Abdihoxha, NK** — A. Abdihoxha, «Tri ngjyrat e kohës», I, 1965.  
**AIF** — «Arkivi i Institutit të folklorit».  
**AK** — «Artikuj kritikë», përkth. V. Angoni e Z. Xholi, 1965.  
**Andoni, DÇ** — S. Andoni, «Dasmë e çuditshme».  
**AP** — «Arësimi popullor», viti, numri.  
**BFM** — «Bazat e filozofisë marksiste», 1960.  
**Brahimi, ZP** — R. Brahimi, «Zgjim pranveror», në «Nëndori» 1968 XI.  
**BP** — «Besnike të pandara», 1958.  
**Bulka, MÇ** — N. Bulka, «Maska të çjerra», 1966.  
**Cerga, DF** — A. Cerga, «Dritë në fushë», 1966.  
**Cipo, S.** — K. Cipo, «Sintaksa», 1952.  
**Ç** — A. Kronin, «Citadela», përkth. H. Kokalari, 1961.  
**Çajupi, M.** — A.Z. Çajupi, «Mëmëdheu», 1958.  
**Çajupi, V.** — A.Z. Çajupi, «Vepra», 1957.  
**Ço** — A. Moravia, «Çoçarja», përkth. S. Caci, 1962.  
**D** — A. Çehov, «Drama», përkth. A. Malo, 1961.  
**DK** — M. Servantes, «Don Kishoti i Mançes», përkth. F. Noli, 1956.  
**DMH** — «Dokumenta e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci: 1917-1941», 1959.  
**Domi, S** — M. Domi «Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa II, Sintaksa», 1957.  
**DP** — «Drejtësia popullore», viti, numri.  
**E. Hoxha, FKT** — «Fjala e shokut Enver Hoxha në Konferencën e 17-të të organizatës së partisë të Tiranës», në «Zëri i popullit» 22.12.1968.  
**E. Hoxha, FVH** — «Fjala e shokut Enver Hoxha me vullnetarët e hekurudhës Rrogozhinë-Fier», në «Zëri i rinisë», 29.6.1968.  
**E. Hoxha, ZNP** — E. Hoxha, «Mbi zbatimin e normave të partisë», në «Zëri i popullit» 7.2.67.  
**F, II** — «Folklorë», II, Shkodër 1940.  
**FG** — M. Gorki, «Foma Gordejev», përkth. P. Zhej, 1960.  
**FGjSh** — «Fjalori i gjuhës shqipe», 1954.  
**FF** — E. Tadei, «Fabrika flet», përkth. H. Selfo, 1960.  
**Frashëri, TNV** — Th. Frashëri, «Trimat nuk vdesin», 1962.  
**Gurakuqi, VZ** — L. Gurakuqi, «Vepra të zgjedhura», 1961.  
**Gjata, K** — F. Gjata, «Kënetë», 1959.  
**Gjata, PJ** — F. Gjata, «Në pragun e jetës», 1960.  
**HLSh** — «Historia e letërsisë shqipe», I 1959, II 1960.  
**HS** — M. Barleti, «Historia e Skënderbeut», përkth. S. Prifti, 1964.  
**Isufaj, E** — P. Isufaj, «Entela», në «Shqiptarja e Re» 1968, III.  
**Jakova, KL** — K. Jakova, «Kopësht i lulëzuem», 1958.  
**Jorgaqi, EP** — N. Jorgaqi, «Ëndërra dhe plagë», 1963.  
**Kallamata, SL** — M. Kallamata, «Shokë lufte».  
**Karadaku, RrP** — Sh. Karadaku, «Rrugët e para», 1968.  
**KLSH** — Materiale të Kartotekës së leksikut të shqipes.  
**KNDH** — «Këto nuk duhen harruar», 1968.  
**Kokona, VL** — V. Kokona, «Me valët e jetës», I 1961.  
**KP** — «Kultura popullore», viti, numri.  
**Kristo, F.** — A. Kristo, «Fabula», 1955.  
**Kuteli, NT** — M. Kuteli, «Një natë tetori», në «Nëndori» 1965 VII.  
**Kuteli, TM** — M. Kuteli, «Tregime të mocme shqiptare», 1965.  
**Kuteli, X** — M. Kuteli, «Xinxifillua», 1962.  
**KZ** — Stendal, «E kuqja dhe e zeza», përkth. R. Xheneti, I 1958, II 1959.  
**L** — P. Pavlenko, «Lumtëria», përkth. H. Selfo, 1956.  
**LB** — E. Denis, «Letra nga burgu», përkth. Dh. Pasko, 1958.  
**LMU** — B. Apitz, «Lakuriq në mes të ujçërve», përkth. R. Shvarc, 1961.  
**LP** — L. Tolstoi, «Lufta dhe paqja», përkth. S. Caci, I 1957, II 1958, III 1959, IV 1961.  
**Marko, AM** — P. Marko, «Ara në mal», 1968.  
**Marko, QF** — P. Marko, «Qyteti i fundit», 1960.  
**Marko, UDP** — P. Marko, «Urata, dhia dhe perëndia», 1967.  
**M. Shehu, ZD** — M. Shehu, «Për zbatimin e detyrëve në lidhje me revolucionarin zimin e mëtejshëm të shkollës sonë», në «Zëri i popullit» 12.4.1968.  
**Musaraj, ÇR** — Sh. Musaraj, «Isha unë Çobo Rrapushi», 1960.

- Musaraj, PA** — Sh. Musaraj, «Para agimit», në «Nëndori» 1963 XI.  
**Nepravishhta, PNF** — R. Nepravishhta, «Pelikanët ndërrojë fole», 1962.  
**N. Frashëri, LV** — N.H.F., «Luletë e verës», Bukuresht 1890.  
**NL** — «Dy njerëz të lumtur», 1959.  
**Noli, HS** — F. Noli, «Historia e Skënderbeut», 1962.  
**Papa, M** — L. Papa, «Marga», (dramë), në «Nëndori» 1968 XII.  
**Petrela, KV** — H. Petrela, «Kronikë e viteve të paharruara», 1965.  
**Postoli, LK** — F. Postoli, «Lulja e kujtimit», 1959.  
**PP** — Instituti i folklorit, «Folklor shqiptar — Proza popullore». I 1963, II 1966, III 1966, IV 1966.  
**Rafail, NG** — K. Rafail, «Njësitë gueril në veprim», 1962.  
**RP, IV** — «Rrezet e para», 1965 IV.  
**RUP** — «Revista ushtarako-politike», viti, numri.  
**S** — A. Xonkada, «Skënderbeu», përkth. S. Caci, 1967.  
**SF** — «Studime filologjike», viti, numri.  
**Sinaeri, DP** — N. Sinaeri, «Ajo që ndodhi në drekën e psaltit», në «Nëndori» 1960 I.  
**SKÇ** — N. Ostrovski, «Si u kalit çeliku».  
**SP** — «Sporti popullor», data.  
**Spasse, AS** — S. Spasse, «Ata ishin shumë», në «Nëndori» 1968 II.  
**Stërmilli, KS** — H. Stërmilli, «Kalorësi i Skënderbeut», 1967.  
**Stërmilli, SD** — H. Stërmilli, «Sikur t'isha djalë», 1959.  
**ShA** — «Shënime për agjitorët», viti, numri.  
**Shaplo, BH** — D. Shaplo, «Në bregun e hijes», 1965.  
**ShF** — «Shkenca dhe feja janë të papajtueshme», 1963.  
**ShP** — «Në shërbim të popullit», viti, numri.  
**Shuteriqi, Ç** — Dh. Shuteriqi, «Çlirimtarët», I 1952, II 1954.  
**Shuteriqi, KP** — Dh. Shuteriqi, «Kënga dhe pushka», 1963.  
**Shuteriqi, ShG** — Dh. Shuteriqi, «Shkallët e gurta», në «Nëndori» 1967 VII.  
**TB** — Liang Pin, «Tre brezat», përkth. S. Caci, 1967.  
**Tira, ZA** — N. Tira, «Zbulime në shtrofkat e fundit të armikut», 1962.  
**TP** — F. Maçioki, «Treni i posaçëm», përkth. E. Biba, 1959.  
**Thirrje, PKSh** — «Thirrje dhe trakte të P.K. të Shqipërisë 1941-1944», 1962.  
**VA** — M. Gorki, «Vepra e Artamanovëve», përkth. V. Kokona, 1959.  
**Xoxa, LV** — J. Xoxa, «Lumi i vdekur», I-III 1965.  
**Xhai, DC** — S. Xhai, «Dashuri cigane», 1965.  
**Zaloshnja, HT** — M. Zaloshnja, «Nën hijen e Tomorrit», 1961.  
**Zaloshnja, KN** — M. Zaloshnja, «Kohët ndryshuan», 1957.  
**ZP** — «Zëri i popullit», data.  
**ZR** — «Zëri i rinisë», data.  
**100 P** — «100 përralla», përkth. Dh. Pasko, 1958.

## R é s u m é

### UNE CLASSIFICATION DES GROUPES DE MOTS PHRASEOLOGIQUES A VALEUR ADVERBIALE EN ALBANAIS

*Cette étude se rattache à plusieurs autres travaux faits dans le domaine de la phraséologie de l'albanais, et qui ont paru antérieurement surtout dans les colonnes de ce bulletin. Dans cet exposé on a traité le type de groupes de mots phraséologiques à valeur adverbiale et l'on a dressé une classification générale, s'appuyant notamment sur la structure extérieure et intérieure formelle des unités adverbiales, sur leurs liens dans la syntagme, ainsi que sur la valeur générale sémantique et structurelle. D'après ces critères, les groupes de mots phraséologiques à valeur adverbiale en albanais sont répartis en deux grands groupements: I. Groupes de mots phraséologiques à liens extérieurs non exprimés de syntagme; II. Groupes de mots phraséologiques à liens extérieurs exprimés de syntagme (à l'aide d'un moyen grammatical).*

*Ces deux grands groupements sont divisés en sous-groupes, d'après la structure intérieure formelle des groupes de mots phraséologiques, d'après le moyen grammatical qui extériorise les liens de syntagme, d'après la valeur de sémantique et de fonction, etc. A la fin, en un petit sous-groupe sont compris les groupes de mots phraséologiques adverbiaux à structure de proposition.*

*Du premier groupement sont étudiés en un sous-groupe les groupes de mots phraséologiques formés à l'aide de la répétition du même mot (anës e anës, fët e fët, mbarë e mbarë, degë më degë, vesh më vesh, ballë për ballë, aty për aty, dorë për dorë, brez pas brezi, fjalë pas fjale, rrug(e) pa rrugë, vend e pa vend, nata natës, këmba këmbës, etc.). Le membre répété est coordonné ou bien subordonné à l'aide de différentes prépositions, ou bien sans aucun moyen.*

*Dans un autre groupement sont compris les groupes de flots phraséologiques formés notamment à l'aide de la coordination de deux mots différents, mais qui ont entre eux un lien donné de sens (ditë e natë, gjatë e gjerë, lesh e li, hundë e buzë, kryq e tërthor, shkel e shko, ec e jak, etc.).*

*Le deuxième groupement a été divisé également en deux sous-groupes. Dans le premier sous-groupe on a soumis à analyse des groupes de mots phraséologiques commençant par les conjonctions si et sa (si kofini pas së vjelash, si sëpata pa bisht, si mishi me thoin, si frëngu pulën, etc.; sa për sy e faqe, sa çel e mbyll sytë, sa gjatë gjerë, etc.).*

*Du deuxième sous-groupe font partie les groupes de mots phraséologiques commençant par une préposition exprimant les rapports grammaticaux des groupes de mots. Telles sont les prépositions me (me mish e me shpirt, me këmbë e me duar, me duar në presh, me shpirt ndër dhëmbë, me bisht në shalë, me gisht në gojë, me zemër të hapur, me gjak të ftohtë, me dorë të shtrirë, me ballë hapët, me veshët bigë, etc. — à structure intérieure coordonnée ou subordonnée); për (për dhjamë qeni, për pesë para spec, për musteqet e Çelos, etc.); në, më, nga, tek, pa (në udhë kryq, më të katër anët, nga sytë këmbët, te bishti i urës, pa mend në kokë, etc.).*

*Dans le groupement des phraséologismes-propositions sont faites rentrer les unités à structure de proposition, mais à valeur adverbiale (ku ha pula gurë, me sa kish në kokë, për të qarë hallin, pa bërë zë, etc.).*

*Durant l'étude et la classification du matériel l'auteur a donné aussi la valeur sémantique et fonctionnelle des groupes, sous-groupes et unités particulières, les nuances durative, itérative, intensive, etc. Tous les cas sont illustrés par des exemples tirés de la littérature artistique, scientifique, la publicistique, le folklore, etc. de la Cartothèque du Lexique de l'albanais, etc.*

*Durant son analyse, l'auteur a dû prendre position aussi sur les limites et le volume de la phraséologie, sur la distinction du type adverbial de celui adjectival et celui simplement verbal, quand les phraséologismes-propositions sont comparés aux formes paradigmatiques des groupes de mots phraséologiques verbaux. On a traité également le développement ultérieur du processus d'agglutination des groupes de mots phraséologiques, de leur accouplement, qui se manifeste aussi avec la formation grammaticale (comme dans les délocutifs ecejaket, etc.).*

*Une importance particulière a été accordée, durant l'étude, aux liaisons des groupes de mots phraséologiques dans la proposition, aux*

membres qu'ils complètent ainsi qu'aux mots servant à identifier la sémantique ou la fonction des groupes de mots eux-mêmes. Ces éléments sont tenus continuellement présents et ils ont été employés aussi comme moyens à découvrir les acceptions et les nuances sémantiques des groupes de mots phraséologiques, leur degré de fixation, leur fonction, etc. De même, on a tenu présent aussi le caractère morphologique des membres des groupes de mots phraséologiques, leur valeur et leur champs lexical, etc., notamment pendant l'analyse ultérieure des groupements et des sous-groupes.

Dans les conclusions de l'auteur, outre les généralisations et solutions résultant de l'analyse du matériel, sont soulevés et donnés des avis pertinents sur des problèmes généraux des types de groupes de mots phraséologiques, sur les liens de syntagme, sur leur traitement lexicographique, sur les possibilités de classifications basées sur d'autres critères intérieurs, etc.

ALI DHRIMO

## MBI DISA ÇESHTJE TË KLASIFIKIMIT MORFOLOGJIK TË MBIEMRAVE NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

Një nga pjesët e ligjëratis, për të cilat mungon një trajtim i plotë e me prirje të theksuara normative, është edhe mbiemri. Megjithëse është trajtuar në kapitujt përkatës të gramatikave tona, shkollore dhe joshkollore nga të huaj e vendas, prapëseprapë, për vetë qëllimin për të cilin ishin caktuar ato gramatika — gramatikat e hartuara nga të huajt kanë më tepër karakter përshkrues, informativ, kurse gramikat e hartuara nga vendasit kanë shërbyer si tekste mësimore — ato nuk kanë mundur të rrokin të gjitha çështjet që dalin në trajtimin e kësaj pjese të ligjëratis. Veç kësaj, një numër problemesh nuk janë shpjeguar drejt ose në një masë të mjaftueshme. Ndërkaq numri i problemeve që presin zgjidhje, si në fushën e fjalëformimit ashtu edhe në atë të trajtëformimit të kësaj pjese të ligjëratis, është relativisht i gjerë. Në këtë artikull ne do të merremi me një problem të vetëm: me klasifikimin morfologjik të mbiemrave të gjuhës shqipe.

Një kategori gramatikore që është karakteristike kryesisht për mbiemrin në krahasim me pjesët e tjera të ligjëratis<sup>1</sup> dhe që përbën deridiku një veçori dalluese të gjuhës shqipe në krahasim me simotrat e saj, është *paranyjëzimi* i mbiemrave (me përdorim të kondicionuar e ka edhe rumanishtja, pjesërisht greqishtja dhe gjuhët nordike). Edhe mbiemrat e gjuhës shqipe jo që të gjithë e kanë këtë kategori gramatikore; ata ndahen në dy klasa të mëdha: në mbiemra të *nyjshëm* dhe mbiemra të *panyjshëm*<sup>2</sup>.

Megjithëse nuk do të futemi në konsiderata historike, ne bashkohemi me mendimin e A. Desnickajës që mbiemrat e nyjshëm përbëjnë «tipin themelor»<sup>3</sup> të mbiemrave të shqipes, ndërsa praninë në gjuhën shqipe të mbiemrave të panyjshëm e shpjegojmë me tezën që mbiemrat e parë të kësaj klase janë fjalë me origjinë emërore, pra, së pari kanë njohur përdorimin emëror, — sigurisht këtu është fjala për ekzemplarët më të vjetër të këtij lloji e jo për formimet e mëvonshme analogjike

1) Themi kryesisht, sepse, siç dihet, nyje të përparme marrin edhe disa emra farefisnie (*i ati, e ëma* etj.), disa përemra (*i tillë, të gjithë, i tij*) dhe numërorët rreshorë (*i pari, i dhjeti* etj.) e themelorët në disa përdorime (*të tre, të gjashtë*). Por sistem me kundërvënje të rregullt kemi vetëm tek mbiemrat.

2) Me plot të drejtë G.j. Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908, 103, e quan këtë tipar «karakteristika krvesore e mbiemrit të shqipes». N. Jokli e quan «eksponent të adjektivit» (cituar sipas E. Çabejt, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe* — «BUSH, SSHSH», 3/1963, 82).

3) A.V. Desnickaja, *Dva tipa pridlagatelnyh v sovremennom albanskom jazyke*, «Voprosy grammatiki», 1/1960, 295.

(kh. p.sh. *punëtuar-ori*, *punëtore-ja*<sup>4</sup> dhe klasa *punëtore*, njeri *punëtor*; *fshatar-i*, *fshatare-ja* dhe revolucion *fshatar*, masat *fshatare*; *qytetar-i*, *qytetare-ja* dhe lirika *qytetare*; *punonjës-i*, *punonjëse-ja* dhe masat *punonjëse*; *myzeqar-i*, *myzeqare-ja* dhe vajzë *myzeqare*; *vlonjat-i*, *vlonjate-ja* dhe punonjësit *vlonjatë*; *trim-i* dhe djalë *trim*, vajzë *trime*; *plak-u*, *plakë-plaka* dhe një burrë *plak*, një grua *plakë*; *fitimtar-i*, *fitimtare-ja* dhe pala *fitimtare* — etj. etj.). Ne e përfytyrojmë procesin e formimit të kësaj klase mbiemërore në këtë mënyrë: në fazën e parë këto fjalë kanë qenë emra. Në një fazë të dytë — për ne kronologjikisht e vështirë për t'u përcaktuar bindshëm — këta emra u përdorën njëherazi edhe në funksion mbiemëror, dhe pastaj, krahas këtyre e në analogji me këta emra - mbiemra, u formuan edhe mbiemra përkatësorë të panyjshëm të drejtpërdrejtë si p.sh. *leshtor*. Pra, ne procesin e formimit të këtyre mbiemrave dhe mungesën e nyjës tek këta e shpjegojmë kështu — dhe këtu bashkohemi me mendimin e A. Desnickajës, — që «prejardhja e mbiemrave pa artikull, që përfaqësojnë një formim të ri, që duket qartë se është i mëvonshëm në sistemin morfologjik të gjuhës shqipe, me sa na duket ne, duhet kërkuar në bashkimin e emrit që cilësohet me një emër tjetër, që del në funksionin sintaksor të ndajshtimit cilësues.

Si vërtetim i një supozimi të tillë është bashkësia e prapashtesave që formojnë nga njëra anë, mbiemra të këtij tipi, nga ana tjetër emra. Në shumë raste mbiemrat, që përdoren si përcaktorë pa nyjë, kanë si homonimi gramatikore emrat që përputhen me ta nga forma, por jo nga funksioni sintaksor. Kh. *fshatarak-e* (mb.) dhe *fshatarak-u* (em.); *fajtor-e* (mb.), dhe *fajtor-i* (em.).

Gjithashtu ndodh edhe me disa të parmë: *trim-e* (mb.) dhe *trim-i* (em.); *armik-e* (mb.) dhe *armik-u* (em.); kh. *burrat trima* dhe *trima të rinj*.

Duhet vënë re se emrat që qëndrojnë krahas këtij tipi, nuk mund të shihen si formime të dyta, që kanë lindur si rezultat i substantivimit të mbiemrave përgjegjës<sup>5</sup>.

Duam të shtojmë këtu që në përdorimin e emrave të këtij tipi edhe si mbiemra, mendojmë se ka lojtur një rol të rëndësishëm jo vetëm përdorimi i tyre si ndajshtime cilësuese, por edhe përdorimi i tyre si kallëzues emërorë (ai është *plak*, *trim*, *fshatar* etj.) dhe si plotës kallëzuesorë, pasi në përdorime të tilla spikat më tepër tipari i sendit të treguar nga emri se sa vetë sendi.

Duke pasur parasysh sa u tha më lart, nuk na duket e drejtë teza

4) Mendimi se prapashtesa *-tor(e)* për pasojë fjala *-punëtor* është mbiemërore, nuk qëndron, po të kemi parasysh së pari vërejtjen e Xhuvanit-Çabejt në *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, 92, 93; «Me këtë prapashtesë (*-tor*, (*-tuar*, *-tuer*) — A.Dh.) janë formuar prej emrash më tepër, emra vepronjës, dhe disa pak mbiemra.

1. Emra vepronjës, p.sh. ... *blegtuer*, ... *gjahtor*, ... *kangtuer*, ... *punëtor*, *punëtuar*, *punëtuer*...». Këtu hyjnë edhe *murator*, *vjershëtor*. Ne mendojmë se kjo fjalë ka qenë së pari një emër vepruesi që tregonte frymorin (personin) që bënte (merrej me) punë (kh.: Një ditë dërgoi një bujk (*punëtuar*) të shoqen në pazar të shit një ka — Mbledhës, I, 403), ashtu si *murator* tregonte e tregon personin që bënte e bën *mur*, *vjershëtor* — personin që bën (harton) *vjersha*, *gjahtor* — personin që merret me gjah (populli thotë: Bëre ndonjë *gja* sot — për *vrave* ndonjë...), *fajtor* — personin që bën *faj* etj. dhe pastaj, meqenëse këta emra ishin bartës cilësish të ndryshme, u bë e mundshme që të kalohej në përdorimin mbiemëror: djalë *punëtor*, qen *gjahtar* etj. (kh.: Ish një njeri *punëtuar* që punonej me qe — Mbledhës, I, 392).

5) A.V. Desnickaja, *art. i cit.*, 296

e E. Çabej që «në të tilla formime nuk u vu artikulli, sepse sufiksi përmbushte një funksion morfologjikisht të ngjashëm me të»<sup>6</sup>, sepse sufikset e këtyre mbiemrave janë barabar (e bile në radhë të parë) tipike për emrat. Nga ana tjetër, po të ishte e vërtetë që sufiksi mund të përmbushë një funksion morfologjikisht të ngjashëm me nyjën, pse nuk mjaftoi vetëm prapashtesa tek tipet: *i sotëm*, *i fisëm*, *i leshtormë*; *i arë-syeshëm*, *i dëmshëm*; *i afërt*, *i ngadaltë*, *i hekurt*, *i artë* etj? Dhe së fundi, po të mos jetë e vërtetë prejardhja e mbiemrave zanafillës të panyjshëm nga emrat përgjegjës, nuk ka si të shpjgohet përdorimi i gjithë emrave të vepruesit dhe emrave të banorëve si mbiemra. I. Gëlbov bashkohet gjithashtu me A. Desnickajën që «sintaksa e veçantë e grupit të dytë të mbiemrave të shqipes (mbiemrave të panyjshëm — A. Dh.) duhet të lidhet me ato konstruktive ndajshtimore, në vendin e dytë të të cilave qëndrojnë emra që tregojnë bartës të cilësive të dhëna»<sup>7</sup>. Veç kësaj ai pohon që prapashtesat *-nik*, *-ac*, *-ak*, *-ec* etj. në bullgarishten formojnë vetëm emra (shih titullin e artikullit të Gëlbovit dhe brenda në artikull<sup>8</sup>) dhe se në shqipen «emrat me *-nik*, *-ec*, *-ak* etj. që janë formuar me prapashtesa bullgare për emra, ndonëse kanë marrë funksionet e mbiemrave, prapëseprapë kanë një regjim të veçantë në gramatikën shqipe nga ai i mbiemrave të pammë»<sup>9</sup>. Por, duke kundërshtuar me të drejtë mendimin e A. Desnickajës, sipas të cilit «meqënëse në fillim kjo (fjala emërore — A.Dh.) qe vetëm një ndajshtim dhe jo përcaktor atributiv, në konstruktet e këtij lloji nuk mund të hynte nyja e përparme, e cila në gjuhën shqipe përbën një komponent të domosdoshëm të togjeve përcaktore me mbiemër në kuptimin e vërtetë të fjalës ose me formën e rasës gjindore të emrit»<sup>10</sup>, sepse — vazhdon autori — këtej nuk del e qartë se cilat shkaqe i kanë dhënë një mbisundim kaq të madh përdorimit ndajshtimor të këtyre emrave, përdorim që gjendet edhe në gjuhë të tjera, po nuk gjendet shkaku për një kapërcim kaq masiv në kategorinë e mbiemrave, është përpjekur të shpjgojë moslindjen e nyjës para këtyre emrave-mbiemra, duke arritur në përfundimin se «nyja = sufiks»<sup>11</sup>, pra me tezën që atë funksion që kryen nyja tek mbiemrat e nyjshëm, kryen edhe prapashtesa tek mbiemrat e panyjshëm, pra, me tezën e mbrojtur edhe nga E. Çabej (cituar më lart). Ne nuk jemi të një mendimi me autorin që tek tipi *i thartë* — *thartanik*<sup>12</sup> etj. kemi të njëjtën semantikë themelore, kurse i njëjti funksion sintaksor i tyre shprehet me mjete të ndryshme: njëherë me nyje të përparme njëherë me prapashtesë<sup>13</sup>. Nyja është mjet gramatikor (dhe mungesa ose prania e saj — kur është i qartë kuptimi dhe funksioni sintaksor i fjalës së dhënë — as e ka tjetërsuar as e tjetëron këtë kuptim e funksion, vetëm e errëson, e vështirëson kapjen e tij, ose përkundrazi e evidencon, e eksplicifikon atë, kurse prapashtesa është mjet fjalëformues, ajo fjalës prodhuese ia tjetëron kuptimin në fjalën e prodhuar,

6) E. Çabej, *art. i cit.*, 82

7) I. Gëlbov, *Bölgarski nomina agentis kato prilagatelni v rumönski i albanski*, «Bölgarski Ezik», 4/1966, 308.

8) *Po aty*.

9) *Po aty*, 307

10) A. Desnickaja, *art. i cit.* 306

11) I. Gëlbov, *art. i cit.*, 308

12) *Po atje*, f. 308

13) *Po atje*.

s'kemi të bëjmë më me të njëjtën semantikë — në rastin e dhënë nga mbiemrat përkatës lindin emra, pra edhe funksioni gramatikor i këtyre prapashtesave nuk është të dallojë mbiemrat e nyjshëm nga të panyjshmit, por përkundrazi të formojë një klasë të re emrash nga mbiemrat përkatës.

Pra, në qoftë se këta emra të tipit që përmendëm, u përdorën edhe në konstrukte ndajshtimore e kallëzuesore e prej këtej kaluan në përdorim edhe mbiemëror, u bënë edhe mbiemra, këtu nuk duhet harruar për asnjë çast fakti, që këto fjalë, duke njohur me kohë edhe funksionin mbiemëror, në asnjë mënyrë, nuk pushuan së qeni njëherazi edhe emra të mirëfilltë. Pra, këta funksionuan e funksionojnë edhe sot e gjithë ditën edhe si emra edhe si mbiemra. E pikërisht ky faktor shumë i rëndësishëm (të cilin si A. Desnickaja dhe I. Gëlbov e lënë mënjanë), që këto fjalë gjithë duke njohur edhe funksionin mbiemëror vazhduan t'i përkasin në thelb edhe sistemit emëror<sup>14</sup>, bëri të pamundshme shfaqjen e nyjës së përparme tek ky tip mbiemrash<sup>15</sup>. Sa për mbiemrat e vonë të mirëfilltë që i përkasin këtij tipi e që janë formuar pikërisht për analogji me emrat-mbiemra, këta vetkuptohet që nuk u paranyjzuan, sepse veproi analogjia: këta u përfshinë në sistemin e mbiemrave të prejardhur për konversion nga emrat përgjegjës, sepse ishin identikë me ta, qoftë nga rruga, qoftë nga mjetet e fjalëformimit të tyre. Pikërisht kjo arësye e fortë që fjalët *trim*, *plak* etj. i përkasin në pari e vazhdojnë t'i përkasin edhe sot e gjithë ditën sistemit emëror e pastaj edhe sistemit mbiemëror, shpjegon qartë shkaku e mosparanyjzimit të tyre, sepse, po të pranojmë tezën e kundërt që këto fjalë janë mbiemra të parmë e prej këtej kaluan në funksion emëror, atëhere arësyeja e mosparanyjzimit të tyre, në kundërvënje me mbiemrat e tjerë të parmë: *i mirë*, *i keq* etj., mbetet e pashpjegueshme<sup>16</sup>. Sa për pyetjen që shtron I. Gëlbovi më sipër, se cila qe arësyeja që shkaktoi këtë kalim masiv të emrave në mbiemra, ne mendojmë se kjo është vetë semantika e këtyre emrave, të cilët, sikurse thekson edhe ai vetë, janë kryesisht bartës të një cilësie të dhënë ose emra vepruesi.

14) Shih për këtë edhe mendimin e K. Cipos për prapashtesat që prodhojnë këta emra, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1949, 41-42.

15) Megjithatë si në Veri edhe në Jug hasen disa emërtime banorësh, të formuara edhe me prapashtesë edhe me paranyjzim, p.sh. *i mirditas*, *i shkodëran*, *i vlonjat*, *i borshiot*, *i fteriot* etj. Këtu ka dy mundësi interpretimi: a) që nja të jetë më e lashtë (kh. *i dukat*, *i kallarat*, *i çorraj*, *i borsh*, *i hot*, *i grud* dhe kjo, megjithë shtimin e mëvonshëm të prapashtesës, vazhdoi të përdorej edhe para këtij formimi të ri për analogji me rastet pa prapashtesë ose b) që nja të jetë tejshtirë më vonë tek formimet me prapashtesë (nga *mirditas*, *borshiot* etj. të ketë dalë forma: *i mirditas*, *i borshiot* etj.). Meqenë se format *i dukat*, *i zhulat*, *i dukagjin*, *i hot*, *i grud* duket të jenë më të lashta në shqipen, ne anojmë nga mundësia e parë, pra nga *i mirdit* > *i mirditas*). Sido që të jetë ky fakt përforcon mendimin tonë që nja dhe prapashtesa nuk e përjashtojnë dot njëra-tjetrën.

16) Sa për arësyeën pse shqipfolësi i sotëm nuk u vendos nyje të përparme jo vetëm mbiemrave tashmë të njohur të këtij tipi, por edhe formimeve analogjike që krijon ai vetë, në të vërtetë kjo shpjegohet me faktin se për ndjenjën e tij gjuhësore ky tip është tashmë i njohur si mbiemër dhe jo me bindjen e rreme (ndoshta edhe të vetë folësit) që prapashtesat përkatëse që formojnë mbiemra të këtij tipi janë të njëvlershme me nyjen e përparme të mbiemrit. Pra ndjenja e sotme e shqipfolësve të zakonshëm, edhe po ta pranojmë këtë barazim, nuk vërteton arësyeën historike të mosnyjzimit të këtyre mbiemrave, por është një fenomen më i vonë.

Pra, ne, te fjalët e tipit: *trim*, *plak*<sup>17</sup>, *punëtor*, *dibran*, *vlonjat*, *detar* etj., ku shfaqen dy kategori gramatikore: kategoria emërore dhe kategoria mbiemërore, do të pranojmë si *primare kategorinë emërore* dhe *sekondare kategorinë mbiemërore*<sup>18</sup> veç të tjerave edhe për arsye se kalimi i emrave në mbiemra, i cili vazhdon edhe sot e gjithë ditën, bëhet pa ndonjë ndryshim të jashtëm, por thjesht nga përdorimi i tyre funksional, pra me konversion (kh. qeveri *kukull*, problem *kyç*, ushtri *armike*, vende *mike* etj.).

Nyja e përparme e mbiemrave përbën, sikurse thekson Bopi, «një të tërë fonetike»<sup>19</sup> me trupin e mbiemrit, është element i parë përbërës i tij; ajo është shndërruar sot, si rregull, në një pjesë përbërëse të domosdoshme, pra, të pamungueshme të mbiemrave. Kjo nyjë (duke përjashtuar këtu tipin *gjallë*, *shëndoshë* etj.) nuk lot asnjë rol në substantivimin e mbiemrit, siç mendon I. Gëlbov<sup>20</sup>, e as për kategorinë gramatikore të shquarjes<sup>21</sup>. Sikurse nënvizon me të drejtë E. Çabej, përdorimi i nyjës së përparme tek mbiemri është i rregullt «qoftë kur emri të cilit i përket ky të jetë në trajtën e shquar, qoftë që të jetë në të pasquarën: *njeriu i mirë* dhe *njeri i mirë*<sup>22</sup>.

Por në ligjërimin e vjershërimin popullor, në ligjërimin emfatik, tek disa mbiemra me kuptim leksikor afektiv shpeshherë mungesa e nyjes së përparme në togfjalëshin *emër + mbiemër* ka çuar në univërbimin (njëfjalëzim) e këtij togfjalëshi, në formimin e kompozitave afektive të një tipi më vete, p.sh. *O mikziu të më dije* (Mbledhës, III, 124); *Ç'u bë Lon ziu që s'po vjen!* (S. Çomora, Karnavalet, 129); *Ti moj, Mozë zezë... Na këtu!* (N. Jorgaqi, DeM, 95); *E ç'luftë zezë kërkon nga unë, aman* (V. Vinçani, Lumturia, 138); *Rexha dekë o në çardhak Nuse zezë nën duvak* (M. Kallamata, shokë, 19); *Ç'berber - ziu* (Q. Buxheli, Rrugë, 43); *Ç'tregëtizeza* (po aty, 77); *Mos jini e motra ju? — pyeti*

17) Jo aq pa interes na duket edhe fakti që kur janë emëruar brezat e ndryshëm, mendojmë se duhet të jenë emëruar me një sistem unik emëror ose mbiemëror e jo në mënyrë të pëzier, p.sh. *fëmijë*, *djalë*, *burrë*. *plak*; *fëmijë*, *çupë* (*vajzë*), *grua*, *plakë*: nga ana tjetër: *i vogël*; *i ri*, *i vjetër*, (*e vogël*, *e re*, *e vjetër*). Edhe kundërvenja: *i vjetër* — *plak*. besojmë se e mbështet këtë mendim.

18) Do pasur parasysh fakti që shumica e këtyre fjalëve e kanë kapërcyer atë fazë, kur tek e njëjta fjalë shfaqeshin të dy kategoritë gramatikore dhe janë bërë dy fjalë të mvetësishme homonime me njëra-tjetrën dhe si të tilla duhet të figurojnë edhe nëpër fjalorë. Kështu me të drejtë, në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, jepen ndaras së pari si emra e pastaj si mbiemra, fjalë të tilla si: *plak*, *trim*, *detar*, *punëtor* etj.

Mendojmë se në këtë drejtim është mjaft kuptimplote luhatja që vihet re në këtë fjalor në përcaktimin e përkatësishë kategoriale të fjalëve të tilla si: *thumbac* (*thumbec*), *fshatarak*, *fsharak*, *shtyranik*, *shfrytëzonjës*, *shumëzues*, *shurraq*, *shurraq*, *tatalosh* etj. të cilat jepen vetëm si emra, ndërsa *mburracak*, *mburrevec*, *thatiq*, *trazovaç*, *trashaluaç*, *trashaman*, *trashëgimtar*, *tradhëtar*, *trembëlak*, *zbatharak*, *zanatli*, *xhabaxhi*, *xhahil*, *vendës* etj. jepen së pari si emra e pastaj si mbiemra dhe *teleshman*, *torcman*, *shushaq*, *vjedhacak*, (*vjedharak*, *vjedharash*) *zgjebarak*, *thatanik* etj. jepen së pari si mbiemra e pastaj si emra.

19) F. Bopp, *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, Jena, 1854, 518.

20) I. Gëlbov, *art. i cit.*, 309.

21) Për këtë kategori gramatikore të mbiemrit bëjnë fjalë: Xylander, J. Ritter von, *Die Sprache der Albanesen oder schkipetaren*, Frankfurt am M., 1835, 29; K. Kristoforidhi, *Grammatiki tis Alvaniqis glosis*, 1882, 29; Kamarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, 1864, I, 207; S. Frashëri, *Shkronjtore e gjuhës shqip*, 1886 36; G. Meyer, *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, 1888 17; Gj. Pekmezi, *rep. e cit.*, 103; K. Cipo, *Sintaksa*, 27, *Gramatika*, 72.

22) E. Çabej, *art. i cit.*, f. 73.

Alerti. *Motër zeza* jam (Sh. Musaraj, Para agimit, I, 477); — Bir, Jani nënës, ti je? — Unë, unë jam, po dil shpejt! — *Ç'dil zeza*, o bir, zbrit, thuaj më mirë (J. Xoxa, Lumi, II, 110).

Një shtrirje të pazakontë, anormale të këtij njëfjalëzimi kemi në klithmat vajtuese:

*U vëllaziu!* (Mbledhës, I, 75); *U baba zeza* (po aty, 74); *U vëlla zeza* (po aty, 78); Hajde, hajde, *vezirzeza* (po aty, III, 461), ku për mendimin tonë kemi njëfjalëzim të togfjalëshit *vëllai i zi, babai i zi* për analogji me përdorimet: *U derëziu, u derëzeza; u fatziu, u fatzeza* etj.

Një mënyrë e tillë ndërtimi haset edhe tek shkrimtarë të ndryshëm, kur shprehja përmban ndjenja afektive, p.sh. *Prenkë shkreta* ishte mësue fushave (I. Zamputi, Atje, 31); E ti, moj *lule shkreta* (H. Mosi, Lule, 109). Pra shtine n'tr'u o *njeri shkreta* se (po aty, 19); Por jo moj *zemër-shkreta*, ti mos qaj! (Ll. Siliqi, Rruga, 31); Ku është *Selimi, burrëziu!* (S. Spasse, Afërdita përsëri, 87); E *nanbardha* tui shikjue (M. Mjeda, Vjersha, 68); Çfarë kryetari je ti more *Ligor ziu* (F. Gjata, Tana, 87); Se *ç'zanat ziu* është ai, kur një herë del mbarë e tre herë prapë (N. Prifti, Lëkura, 21).

E që këtu kemi të bëjmë me njëfjalëzim të mbarë togfjalëshit e jo me një togfjalësh *emër + mbiemër* të panyjshëm (prkt. të çnyjzuar), del po të vërejmë edhe format e lakuara të kësaj kompozite, ku mbare-sat rasore e nyjën shquese i merr vetëm elementi i dytë, si tek çdo kompozitë normale p.sh. A e din ti, more, shtasë se çka e gjënë *pijetar-shkretën*, po kje i mendimit tand! (Të fejuemit (përkth.), 240); ishin përpjekur qysh e qysh ta coptonin ndërmjet tyre *Shqipëri zezën* (Sh. Musaraj, Para agimit, I, 144); Po çudi ama, Demko — ndërroi papritur fjalën vajza — ajo puna e *Bakall ziu*, desha të thosha, (po aty, 263).

Po kështu ndodh edhe me shqimin e tyre — elementi i parë nuk pëson asnjë ndryshim, kurse i dyti merr gjithmonë nyjën përkatëse shquese.

*Shënim.* Në dialektin verior kjo lloj kompozite përdoret për të dyja gjinitë në trajtën e femërores (kh. Lum ju për *kryetar-zezën* tuaj (F. Ndocaj, Vlagë, 94); Hajde-hajde, *vezirzeza* / s'kam nevojë për urumesha, / se i kam hanmat shkodranesha. (Mbledhës, III, 461).

Ndër disa autorë, kryesisht gegë, besojmë nën ndikimin e poezisë popullore (kh. *Madhi zot* na ka nimue / katër vdekun një â varrue — Mbledhës, III, 13), çnyjzëmi afektiv i mbiemrit vërehet edhe kur ai i prin emrit ose edhe për arsye thjesht metrike — e kjo vërteton tezën e F. Bopit (*vep. e cit.*, 518) që nyja e përparme pjesëpërbërëse e mbiemrit nuk ka kuptim në vetvete, bile mungesa e saj e bën mbiemrin më afektiv, p.sh. *Forta* borë që ra n'Mirditë (M. Gurakuqi, Gjeto, 38); *Madhi Zot* a ka ku shkon ma zi? (po aty, 20).

*Shënim.* Përsa u përket rasteve të tipit: Ky është zjarr i dashurris / Që i ra kallamit *mjerë* (N. Frashëri, Lulet, 47); Nata në Shëndre si motra e gruas *ve* (Mbledhës, III, 210); Prej portës *vogël t'kalasë*.. (Këngë popullore historike, 48) etj., — këto për ne nuk përbëjnë rënjë të nyjes së mbiemrit, por, siç vëren edhe G. Majeri<sup>23</sup>, «nyja para mbiemrit për dukë mungon». Këtu kemi mosdiferencimin, bashkëshkrirjen në një të vetme të të dy nyjeve e për pasojë mosdjerjen e nyjës së përparme të mbiemrit, e cila formalisht është e njëllotjtë me nyjën e prapme

<sup>23</sup> G. Meyer, *Kurzegefasste albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888, 20.

të emrit. Mendimi se në këto raste nuk ka as mungesë për dukë, as rënje, po ka një kurrë të mospasur të nyjës, besojmë se nuk qëndron. Nga një shqyrtim i veprës së Grigor Gjirokastritit, përrallave të mbledhura nga H. Pedersen, Th. Mitkua e S. Dineja na rezultoi se:

1) Tek Grigori (1827), kemi: *Jusuf i biri Davidit* (f. 3), *E Josifi bur'i saj* (f. 2), *Engjell'i Zotit* (f. 3).

2) Tek H. Pedersen (1895)<sup>24</sup> — nyja e përparme, kur është fonetike dhe e njëjtë me të prapmen, nuk është shënuar jo vetëm në gjindore-dhanore, por edhe në emërore dhe jo vetëm nyja e përparme e mbiemrit (prk. gjindores së emrit pasues), por herë kjo e herë nyja e prapme e emrit të përcaktuar e herë janë të pranishme që të dyja: a) *Mos do vajzën e mbretit xhineret* (f. 37); i ktheu topin *pallatit mbretit* (f. 34); ish e *shoqe kapllanit* (31) në fund të *bakshesë vogël* (f. 41); të *bakshës madhe* (f. 42) etj. b) U thotë *vëlla i vogëlë* (f. 31); S dëgjoi *djal i mesëm* (f. 34); mori *djal i mbretit* të bukurën e dheut (35); e ravunosi vajzën atje ne *mbret i xhinëret* (f. 37); prëmë fjeti *vajz e madhe* (f. 143); ai ishte toidhjuja *burr inë* (f. 46) etj. c) edhe i thotë *djalit të mbretit* (f. 40); e kupëtoi *vajza e mbretit* (f. 44) etj.

3) Tek «*Valët e Detit*» të Spiro Dines (1908) vihet re e njëjta lëkundje, pra gjejmë të regjistruar herë njëjën e prapme të emrit të përcaktuar dhe mbiemrin pa një të përparme e herë rastin e anasjelltë — emrin pa një të prapme e mbiemrin (prkt. gjindoren) të paranyjësuar. Është me interes të shënojmë që edhe vendoren (aq karakteristike për atë kohë) e gjejmë ndonjëherë pa nyje të prapme: a) m'i *madhi të tre këtyre* (f. 133 (shkruar nga K. Hoxhi); Njeriu i pa mësuar, si *druri pa punuar* (f. 708); *Kali mirë* njihet nën mutafë (f. 738); *Pipi kuq* i Korçës (f. 766); *Kali huaj* të lë mbë udhë (f. 738); veç *zoti math* Perëndi (f. 90); Kur bie *lisi math*, dëgjohet (f. 691) etj. b) po unë përse të mos bënem *djal i plakës* (f. 84); pa shkuarë edhe *mez'i natësë* (f. 843); Si duket *qeveri e verbër* turke, si e shpunë Selanik (f. 305); *Djall'i djallit / Qen'i qenit / Trim'i trimit* (f. 685); *Borxhi i mënauar*, në kohë të shtrënguar (f. 689); *gjum'i tepër*, rrob'e vjetër (695); *Hesap'i lashtë* lahet si kashtë (f. 696); *Hidhnim'i fort*, *dem'i të zot* (696); *Dem'i njerit, fitim i tjetrit* (f. 724). Duhet shënuar se rasti i dytë është më i rëndomtë se i pari. c) Qënke prej *fisit të math* të lirë (f. 884); Kështu *djali i mbretit* i la shëndenë (f. 800) etj. ç) Kur dolla në *mest avllisë* (f. 331); Një kala *n'anët gjolit* (196).

4) Tek «*Bleta*» e Thimi Mitkos (1924) vërehet po ajo gjë: a) *Filli i mustaqesë zezë* (f. 88); së bukurës dheut (f. 277); *Vate të pallati çupësë* (f. 295); Të djelën pas *mezit ditësë* (f. 48) etj. b) nga *pallas'i çupës* (f. 294); edhe shkoj pameta te *fshat'i çupës* (f. 290); Të djelën nga *mes'i ditësë* (f. 47); Nga *gjiri'i babajt* më nxorre (f. 54) etj. c) *Filli i mustaqesë zezë* (f. 88); iu duk atij *pallas'i së bukurës*. (f. 277); i *jati i djalit* (f. 283) etj. ç) Kur dolla në *mest t'avllisë* (f. 43 — kh. Dine) etj.

Shihet se në një numër të madh rastesh këta mbledhës folklori janë të ndërgjegjshëm për praninë e të dyja nyjave dhe kanë përdorur apostrofin për të treguar se në të folur ndjehet vetëm njëra. Në rastet e tjera ata herë kanë ndjerë njëjërën e herë tjetrën. Edhe Grigori, siç duket nga shembujt, i ka diferencuar të dyja nyjat. Veç kësaj, dihet se

24) Kh. për mendimin tonë të bashkëshkrirjes së dy tingujve të njëjtë edhe: ... nga *frik ai* pastajet vate e i tha babait... (H. Pedersen, 35); *Djersa jot' e faqesë / Djersa jot' e gushësë / Djersa jot' e gjiritë* (S. Dine, 375); *Djersa jot' e faqesë* (Mbledhës, 11, 295).

fenomeni i rënjes së njerit nga dy tingujt e njëjtë është një karakteristikë e mbarë shqipes.

Nga ana tjetër, kur emri është i pashquar, pra nuk ka mundësi që të takohen dy nyja fonetikiisht të njëjta, nyja e përparme e mbiemrit e shoqëron këtë të fundit në të gjitha rasat. (kh. një *miku të mirë*, një *vajzë të urtë* etj.).

Së fundi, sa herë që nyja e përparme e mbiemrit është fonetikiisht e ndryshme nga nyja e prapme e emrit, ajo është gjithmonë e pranishme dhe asnjëherë nuk mungon edhe kur emri është i shquar.

Këto fakte dhe arësye na bëjnë që të pranojmë mendimin e G. Majerit për një bashkëshkrimje të nyjës së përparme të mbiemrit (prkt. të gjindores së një emri çfarëdo) me nyjën e prapme të emrit në shqiptim e sipër, sa herë që këto nyje janë fonetikiisht të njëjta dhe në këtë vështrim ne e quajmë plotësisht të drejtë vendosjen e normës letrare nga Sami Frashëri për t'i përfaqësuar edhe në shkrim të dyja nyjat që në gjuhën e folur bashkëshkrimi në një të vetme.

Me gjithë rrudhjen që ka pësuar asnjësi në gjuhën shqipe, prapëseprapë në asnjë mënyrë nuk mund të mendohet që ai është zhdukur krejt, prandaj edhe nyjet e përparme pjesëpërbërëse të mbiemrit të shqipes janë *i, e, të* (respektivisht me tri gjinitë që ka mbiemri si forma përshatjeje me emrin e përcaktuar prej tij).

Përsa i përket zotërimit në shqipen të mbiemrave të nyjshëm në krahasim me të panyjshmit ose anasjelltas, mund të thuhet se që të dyja klasat janë mjaft produktive, por megjithatë statistikisht më e pasur duket të jetë klasa e mbiemrave të nyjshëm<sup>25</sup>.

Në përgjithësi shihet një prirje për të formuar mbiemra nga mjaft pjesë të tjera të ligjëratës origjinarisht jo mbiemërore — e këtu nga njëra anë pasurohet klasa e mbiemrave të nyjshëm nga togu *pa+emër* dhe *emër (ndajfolje) + shëm* (kh. *i papunë, i pander, i paturp, i pagojë*,

25) Nga një statistikë që u bë lidhur me raportin midis mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, botuar më 1954, rezultojnë 2132 të panyjshëm dhe 1651 të nyjshëm, por duke marrë parasysh që në Fjalor nuk figurojnë mbiemrat prejpesorë pa prapashtesa (me përjashtim të rasteve kur është zhvilluar një kuptim i ri leksikor), del se numri i mbiemrave të nyjshëm bëhet shumë më i madh se i të panyjshëmëve. Nga ana tjetër, duhet pohuar se në stadin bashkëkohor të zhvillimit të gjuhës shqipe mbiemrat e panyjshëm që formohen me prapashtesën *-or*, janë më të shumtë se sa formimet me anë të paranyjëzimit të togut *pa+emër* ose me paranyjëzim dhe me prapashtesën *-shëm*, për këtë mjafton të krahasojmë formimet më të reja që në disa raste janë të diskutueshme e të pagoditura, sidomos në publicistikë e në artikuj kushtuar problemeve të teknikës, p.sh. urtësinë *pleqësore* — Zëri i Rinisë (më tej ZR), 2. VII.67, 6; forcat *rrudhore* — ZR, 9.IX.67, 5; punën *stërvitore* — ZR, 19.VII.67, 6, koha *stërvitore* — Përpara, 9.IX.67; anijet *lumore*, ZR, 12.VIII.67, 6; njësi *lumore* — Bashkimi, 17.IV.68, 4; furnizimeve *lumore* — Zëri i Popullit (më tej ZP), 21.II.68, 3; lëndës *drusore* — Puna (më tej P), nr. 64, 1; mbeturina *drusore* — Përpara, 1.XI.67, 4; fibra *drunore* — P. 30.V.67, 3; esencë *vajore* — P.6.VI.67, 3; përmirësimi *racor*, Përpara, 5. VII.67; bërthamës *racore* — ZP, 15.II.68, 3; puna *racore* — Sesioni I tekniko-shkencor i punëtorëve të NESH Kamzë, Tiranë, 1968, 82; lufta... *ekipore* — Përpara, 12.VII.67; në vendbanimin *shpe-llor* — Përpara, 11.XI.67, 4; punimi *vetullor* — Adriatiku, 21.XI.67, 2; 1; me regjim *stallor* — ZP, 16.II.68, 3; bimë *barore* — Prodhimi i hershëm i domateve, Tiranë, 1959, 5-6; tokat gëlqerore *gurishtore* — H. Ahmataj: Kultivimi i disa bimëve aromatike, Tiranë, 1966, 8; tokat... *zallore* — po aty, 8; gjethet... *pendore* — aty, 14; gjethet *pëllëmbore* — aty, 30; qime të murme *gjëndrore*, po aty; pyjet e lisit... janë me origjinë *llastore* — V. Koçi: Që çdo kooperativë bujqësore të ketë pyllin e saj, Tiranë, 1966, 52; tokave *livadhore* — M. Çuni: Rendimente të larta me lule dielli, Tiranë, 1968, 7; bimë *vajore* — aty, 14; tokë... mjaft *plisore* — Sesioni I tekniko-shkencor i punëtorëve të NESH Kamzë, Tiranë, 1968, 25.

*i ndershëm, i ndërgjegjshëm, i mëvonshëm, i vjetshëm* etj.) e nga ana tjetër klasa e mbiemrave të panyjshëm, nga grupi përkatësor i mbiemrave (kh. *atëror, diellor, drunor, drusor, mësimor, qiellor, pyjor, ujor* etj.).

Lidhur me problemin se cilët mbiemra janë të nyjshëm dhe cilët të panyjshëm do të vërehet se janë të nyjshëm:

a) gjithë mbiemrat lëndorë të formuar me anë të prapashtesës *-të* (t) (si në kuptimin e tyre të mirëfilltë ashtu edhe kur cilësorizohen), p.sh. Në këtë kohë në shkallët e *gurta* dolli Donika. (D. Agolli, Zhurma, 66); Monellat e *argjëntta* e të *nigelta* do të jenë vetëm për të mbushurë sumat e vogëla (S. Frashëri, Shqipëria, 85); dielli po vërtiste mbi qytet tufën e rrezeve të tija, që ngjanin me vandakë zhukash të thata, të *arta*. (J. Xoxa, Lumi I, 16); (kh. edhe *i drunjte, i florinjte, i hekurt, i mënda-fshhtë, i mermertë* etj.).

b) Gjithë mbiemrat e prejardhur nga ndajfoljet, p.sh. iu afrua kandiles që kërciste nga ujët e *tepërt* (J. Xoxa, I, 21); Është vërtetë që shumat e pagesave janë të *tepëra* (S. Frashëri, Shqipëria 84); dramaturgjia e figurës nuk është e *mjaftë* (M. Gjini, Qielli — Drita, 22.4.66), (kh. *i shpeshhtë, i paktë, i sotëm, i nesërm, i largë, i afër*).

c) Gjithë mbiemrat prejfoljorë (të prejardhur nga pjesoret pa ndihmën e ndonjë prapashtese), p.sh. firoma e brazdave i dha jetë fushës së *përgjumur* (J. Xoxa, Lumi, I, 7); le shtepin'e njerëzinë / me zëmër të *përvëlur* (N. Frashëri, HeS. 299); Bes'e shqiptarit është edhe ka qenë gjithmonë e *ditur'e* e *dëgjuar* ndër gjithë botët. (S. Frashëri, Shqipëria, 66); Për çudi toskët e *zbutur* e buzëqeshur, dhe jo gegët e ashpër e të *mvrojtur*, qenë të parët (F. Noli, HeS., 78). (kh. edhe *i afruar, i larguar, i goditur, i plasur* etj.).

ç) Gjithë mbiemrat e formuar me anë të prapashtesës *-shëm, -ëm*, p.sh. *i djeshëm, i sotshëm, i afrueshëm, i këshillueshëm, i mrekullueshëm, i habitshëm, i sotëm, i mesëm* etj.

Ndërsa të panyjshëm janë:

a) gjithë mbiemrat përkatësorë (gjithashtu në të dy kuptimet) — me përjashtim të atyre që janë të prejardhur prej ndajfoljeve si edhe mbiemrat lëndorë të formuar me prapashtesën *-or*, p.sh. Ajo fliste pak; ... kish një zë *metalik* (A. Cerga, Mëngjez. 34); Ky është plumb pushke *gjermane* (D. Agolli, Zhurma, 6); të vihet një qeveri *mëmëdhetare* (S. Frashëri, Shqipëria, 69); Drejtori raportonte plotësimin e planit *tremujor*. (M. Kallamata, Gjëmbat. 27); në moshën e tij *djaloshare* (V. Kokona, Me valët, 9); Fabulat *ezopike*, ndryshuan shumë nga forma e tyre e parë (A. Kristo, Fabula, 3); Toka të thata *argjilore*; Toka *argjilore, argjilore ranore, ranore argjilore* (K. Çika — D. Malaaj, Manual për teknikët e mesëm të ndërtimit, Tiranë, 1967, 68, 69.)

Pra janë të tillë gjithë mbiemrat e formuar me prapashtesat: *-ar, -tar, -or, -tor, -ak, -as, -ik* etj.

b) mbiemra prejfoljorë, të prejardhur nga pjesorja ose nga e tashmja e foljes me anën e prapashtesës *-(ë)s*, p.sh. Zotëronte një qetësi *paralizonjëse* (A. Cerga, Mëngjez, 85); Letrën ia shkruanin me një ton miqësor dhe në të njëjtën kohë *qortonjës* (A. Cerga, Mëngjez, 67); Ka ardhur një letër *demaskonjëse* për ty! (D. Agolli, Zhurma, 75); ndjenja vlagën *dehëse* të buzëve (D. Agolli, Zhurma, 74); Dhe përmbi të endet kujtimi /. Porsi një mjegull *shëtisëse* (I Kadare, Përse, 22); E ngrehin valle dora-dora

e kundoshin kresh'nik't'e ilirve e anmiqt e ngelun, *ngadhnyjes* Bardhy e Perdikën e thye. (Nd. Mjeda, Lissus, Po shqipe, 275); gjithfarë bagtie e gjind e trenu, qi ndër shpia mblodhi rrjedha *shkumbuese* e Drinit, (Nd. Mjeda, Lissus, 278).

c) të gjithë mbiemrat kompozita, p.sh. Dragonjtë — *dorë-hekurt* i xveshnë shpatat me zëmërim (N. Frashëri, Iliadhë, 72); Jeni *kokëtrashë*, Majki (M. Kallamata, Gjëmbat, 13); Ke të drejtë moj e ngratë — i tha lepuri *veshggjatë* (A. Kristo, Fabula, 80; Po i mir'asht Mark *shalë-gjati?* (K. Kristoforidhi, Gjaja, 13); Sulejman *buzëburbuqe*, Ç'i vrave gegët ç'i sose (M. Kuteli, Kapllan, 15). Kjo Marina e Mani *Kapëbardhit* ka qenë një bukuroshe, një *syshkrUAR* e *cullufezezë* e *lajkamadhe* sa m'a prishi gjumën. (M. Kuteli, Netë, 66).

Lidhur me funksionet dhe përshtatjen e nyjeve me trupin e mbiemrave përkatës referojmë në punimin e botuar mbi nyjet.

Shënim: Tek F. Noli gjejmë një kompozitë të vetme mbiemërore të tipit bahuvrihi gabimisht të paranyjzuar: dhe kështu nukë dinë se ç'ti thonë veç sa t'a quajnë të *zemërgurtë*, (F. Noli, Don kishoti, 108), veçse që është e *zemërgurtë*, pak arrogante dhe shumë përbutzëse. (po aty, 18).

#### *Forma reliktove e mbiemrave sot të nyjshëm.*

Një nga problemet ende të diskutueshme për gramatikat shqipe është edhe ai i atij grupi fjalësh me formë të pandryshueshme, por me një funksion mjaft të diskutueshëm, e në disa raste me funksion mbiemëror të qartë. Këtu dallohen dy nëngrupe fjalësh: a) fjalë, të cilat nga forma janë ndajfolje dhe janë trajtuar si të tilla dhe b) fjalë të cilat nga forma janë pjesore, por nuk janë trajtuar gjithmonë si të tilla, p.sh.

a) Po ai, malsori, mbeti *gjallë?* — pyeti gjenerali (I. Kadare, Gjenerali, 102); Se si kish shpëtuar *gjallë* qe me të vërtetë për t'u habitur (Sh. Musaraj, Para, II, 525); Razie! — Lep! thotë qo. — *Gjallë* je? — thotë. *Gjallë* jam! — thotë qo. (Folklor I, IV, 192); Jam këtu, jam këtu, i varrosun, o shokë, i coptuem nga anmiqt. *gjallë* i futun në tokë Ll. Siliqi, Mësuesi, 29); ishte *njësoj* sikur t'u pritje kokën të gjithë atyre burrave (Gj. Zheji, Tregimet, 150); Është kërkesë e komandës së grupit, s'kemi si e kundërshtojmë. *Qartë?* — *Qartë*, shoku komisar; (Sh. Musaraj, Para, II, 148); nuk fjeti deri vonë / kujtimet *qet s'e lanë* (A. Banushi, Rugë, 10); Votrën kush e tradhëtovi, toka *randë* e ka! (Ll. Siliqi, Mësuesi, 38); Hajde udhëmbarë, e na u këthefsh *shëndosh* (F. Gjata, Tana, 72); po s'ma dhatë at gastare, ju s'daheni *shëndosh* (Folklor, I, II, 196); ajo u bë prapë e sëmure. Edhe *sëmure* po jam, i tha (Mbledhës, II, 167); faqet e saja *ma kuq* se molla (F. Ndocaj, Vlagë, 66); e plaku veç ndigjonte pa nxjerë fjalë, nxi fytyrë e ba *ma zi* se futa (po aty — 102); në krye mbante një qeleshe të butë Shkodre, *bardhë* si bora (po aty — 110); ishte ba *bardhë* e *kuq* si kokrra e mollës (po aty — 18); Ajo tani e kishte ngritë shaminë deri mbi vetulla e ajo fytyrë *bardhë* e *kuq* (po aty — 205); *Mjerë* kush është i dobët (S. Frashëri, Shqipëria, 47); Qershijat janë pjekun, janë bamë *kuq* si gjaku (Migjeni, Novelza, 136); Dritat e bukura... *kuqë*, blue, jeshil, *verdhë* (aty, 209); Ftyra e juej tek asht bam *edhe ma verdhë* se limoni (H. Mosi, Cubat, 105); Veshja e tyne *kuq* që nga mezi e nalt dhe *zi* poshtë (Lipi, Fatbardha, 19); edhe buka *thatë* ose me pak gjizë e Beqir

Koçit u dukesh si kadaif (Q. Guranjaku, Tetë, 57); (kh. edhe gjermanisht: *trocken* Brot essen; auf *gut* Glück: Jung Siegrfried: *gut* Ding: *unrecht* Gut etj.)

Po këtu përfshihen edhe rastet e përsëritjes së këtyre fjalëve: *Zi zi* si kusi / *kuq kuq* si lulkuq / *Bardh bardh* si buldardh (Gjë e gjëza 49); / *Ato* faqet *kuq - kuq*, flokët mbledhë kulaç (G. Kongoli, Vajza, 26) etj.

Në përdorime të caktuara, po këtu përfshihen edhe disa fjalë historikisht pjesore në *-t(ë)*, por që sot nuk ndihen më si të tilla, lumi na marrtë në qoftë se s'jemi të zotë t'i mësojmë sot që i kemi *hapët* gjithë dyert (Sh. Musaraj, Të shkuara, 27); Nana i ndigjonte me gojë *hapët* këto fjalë (Q. Guranjaku, Tetë, 97); fle me sy *hapët* (Çajupi, Përralla, 165); (Kh. Zotnia jote, kur t'urdhoin me ardhë, derën e gjen të *çilë* — Mbledhës, III, 499). Përtaci mbetet *urëtë* (S. Frashëri, Abetare, 43); Mysliman'e të krishterë.. lanë mëmëdhenë *shkretë* (Çajupi, Baba, 24). E turbull është vërtetë në gotë, po kokën ta mban *kthjellët* (J. Xoxa, Lumi, I, 201) etj.

b) Ashtu dalç *gëzuar* (Mbledhës, III, III, 50) (kh. Dil moj dale e *kuqe* — Mbl. III, 50); ktheheshin *ngarkuar* me ar e me ergjënt (S. Frashëri, Shqipëria, 27); Në brez gjerdanin *ngjeshur* (D. Agolli, Në rrugë, 79); E pashë *ngrënë* e *pa ngrënë* (N. Bulka, Skica, 27); Ramizi rrinte *mbështetur*, me kokën në pëllëmën e dorës (N. Jorgaqi, Ëndra, 29); Dhe tek dera qenin *zgjidhur* lenë (I. Kadare, Shekulli, 9) etj.

Trajtimi i këtij problemi është rrokur tërthorazi nga S. Frashëri, A. Xanoni, O. Myderrizi, I.D. Sheperi, K. Cipo e Sh. Demiraj dhe drejt-përsëdrejti nga E. Çabej.

Themi tërthorazi nga autorët e lartpërmendur, sepse ata nuk janë marrë direkt me këtë problem e megjithatë, kur kanë trajtuar formimin e mbiemrave (prkt. ndajfoljeve), kanë marrë qëndrim ndaj tij<sup>26</sup>. Kështu pesë të parët janë të një mendimi që mbiemrat: *i shtrembër*, *i shtrenjtë*, *i keq*, *i shëndoshë*, *i gjallë*, *i hapët* etj. janë formuar nga paranyjëzimi i ndajfoljeve përgjegjëse: *shtrëmbër*, *shtrenjtë*, *keq*, *shëndoshë*, *gjallë*, *hapët* etj. Ndërkaq S. Frashëri dhe A. Xanoni shënojnë edhe faktin që pjesorja nga njëra anë është folje, nga ana tjetër mbiemër, pra «bëhet prej foljeje dhe ruan shënimin e foljesë, po përdoret si miemërë». O. Myderrizi shënon se si ndajfolje përdoret edhe pjesorja: «shkoi *gëzue*» K. Cipoa vëren se një nga funksionet e pjesores është «të ketë vlerë pjesore: një letër *shkruar* me të dhëmbura» I.D. Sheperi përmend se si ndajfolje «përdoren... pjesoret: punofsh *gëzuar*».

Sh. Demiraj bashkohet me tezën e anasjelltë që ndajfoljet përgjegjëse kanë dalë nga mbiemrat e dhënë. Kjo tezë mbrohet nga F. Bopp e G. Vaigand<sup>27</sup>. Sh. Demiraj, në gramatikën për shkollat pedagogjike, shkruan: «Mbiemrat, që janë fjalë të para, janë shumë të paktë në gjuhën tonë. Të tillë janë mbiemrat *trim*, *plak*, *i ri*, *i zi*, *i bardhë*, *i ver-*

26) S. Frashëri, *vep. e cit.*, 37, 129; A. Xanoni, *Gramatika shqip*, 1909, 56, 91; O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, 1944, 74, 273; I. D. Sheperi, *Sindaksa e gjuhës shqipe*, 19, 137, 122; K. Cipo, *Gramatika*, 77, 121; Sh. Demiraj, *Morfologjia*, Tiranë, 1962, 87, 214, 198 dhe në dispencë, I, 82, II, 244, 266.

27) F. Bopp: «Këto (ndajfoljet — A. Dh.) sa kohë që rrjedhin prej një mbiemri, nuk ndryshojnë nga forma prej tij», *Das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, Jena, 1854, 495. G. Weigand: «mbiemri pa artikull shërben si ndajfolje» — *Albanesische Grammatik*, 1913, 47. Arësytet pse tek mbiemri ka *-ë* e tek ndajfolja jo, sipas këtij autori, janë thjesht fonetike.

*dhë, i mirë, i keq* etj.»; nga ana tjetër tërë ndajfoljet *mirë, keq, lehtë, bukur, qartë, errët* etj. «janë formuar nga mbiemrat, kryesisht nga ata mbiemra cilësorë që në shqipen e sotme janë të nyjshëm». Mendojmë se një parashtrim i tillë nuk e zgjidh problemin, sepse nuk përcaktohet, nëse këto ndajfolje që janë formuar nga mbiemrat «që në shqipen e sotme janë të nyjshëm», janë formuar në shqipen e sotme, apo ekzistojnë prej shekujsh a më mirë të themi kanë bashkëekzistuar me mbiemrat përgjegjës. Edhe nga pohimi i Sh. Demirajt nënkuptohet që edhe ai pranon se mbiemrat sot të nyjshëm të tipit *i mirë, i keq*, nuk kanë qenë që në krye të herës të tillë, por përkundrazi të panyjshëm — e atëhere nuk mund të hetohet si u formuan këto ndajfolje nga mbiemrat përgjegjës, sepse mbiemri ka qenë: *mirë, bukur, keq, lehtë, rëndë* etj. dhe ndajfolja ka qenë po kështu; si përfundim nuk mund të dallohet se cila pjesë e ligjëratës është formuar nga tjetra. Edhe Sh. Demiraj pohon se «pjesorja, e cila është quajtur kështu, sepse shërbente edhe si fojle edhe si mbiemër, në shqipen e sotme kthehet në mbiemër, duke marrë nyjen e përparme». Nga ana tjetër: «Pjesorja mund të përdoret edhe si fjalë më vete... p.sh. Drita u gjet *ndezur*. Dritën e gjetëm *ndezur*». Më tej Sh. Demiraj pranon se «edhe sot e kësaj dite» «mbiemra të tillë si *i shëndoshë, i sëmurë*» «përdoren edhe të panyjzuar e atëhere prej ndajfoljeve korrespondonjëse dallohen vetëm nga funksioni sintaksor. P.sh. Nënën e lashë (të) *shëndoshë* dhe e gjeta (të) *sëmurë*. Në shtëpi arrita *shëndoshë* e *mirë*».

Duke u marrë me problemin e nyjës së përparme të shqipes, E. Çabej ka prekur disa herë edhe problemin në fjalë. Ndër të tjera ai pohon se «Mendimi i Boppit... që adverbet nuk ndryshojnë në formë nga mbiemrat (f. 518, 495), për përdorimin e sotmë të gjuhës nuk është i drejtë<sup>28</sup>. «Gjuha m'anë tjetër paraqet edhe sot rasi, të cilat me mbiemrin e tyre pa artikull hyjnë në këtë kompleks më të madh *lum* ti! pranë *i lumi* ti»<sup>29</sup>. «Artikulli mënefund edhe te participi është shtrirë përherë e më shumë. Me këtë zhvillim, i cili vazhdon edhe sot e gjithë ditën, u bë në shumë rasi një shpërngulje e kësaj pjesë të ligjëratës në mbiemrin foljor (adjektivin verbal)»<sup>30</sup>. «Këto rasi së bashku me ato që u përmendën më sipër (f. 82), dëshmojnë që kufitë e participit me mbiemrin dhe të mbiemrit me adverbën, ashtu si në disa të tjera gjuhë, edhe në shqipen nuk kanë qenë të prera, as për nga forma as për nga funksioni. Ka pasur këtu një periudë, në të cilën... pjesët e ndryshme të ligjëratës nga shumë anë u barazuan e u njësuuan në mes të tyre... Për atë periudë më të lashtë është fund e krye i drejtë mendimi i Boppit... (82), që adverbë e mbiemri nuk ndryshojnë në mes të tyre nga forma. Për një gjendje të tillë dëshmojnë trajta si *i gjallë, gjallë, i sëmurë; sëmurë, i shtrenjtë; shtrenjtë, i lirë; lirë*, të cilat ekzistojnë njëra pranë tjetrës dhe përmbajnë ndryshime të imta, të kondicionuara shpeshherë dhe stilistikisht;...» «Në këtë mes marrin një kuptim të ri ato vise të Buzukut, në të cilat mbiemrave latinisht u përgjigjen trajta pa artikull,

28) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, «BUSHT, SSSHSH» 3/1963, 82. Edhe në *Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund*, në «Les problemes fondamentaux de la linguistique balkaniques», Sofia, 1966, 62-63. E. Çabej pohon se «në një periudë pak a shumë të lashtë të gjuhës... këto të dy pjesët të ligjëratës (mbiemri dhe ndajfolja — A. Dh.) në raste të caktuara nuk ndryshojnë prej njëra-tjetrës», pra, jo në shqipen e sotme.

29) Po aty, f. 82.

30) Po aty, 88.

të cilat sot në shqipen kanë vlerë ndajfoljesh: *A do banesh shëndosh? Vis sanus fieri*»<sup>31</sup>.

Ne mendojmë se përderisa edhe sot e gjithë ditën vazhdojnë të ekzistojnë krahas njëra-tjetrës: *i gjallë: gjallë; i sëmurë: sëmurë; i shtrenjtë: shtrenjtë; i lirë: lirë*, të cilat «përmbajnë ndryshime të imta, të kondicionuara shpeshherë dhe stilistikisht», atëhere format e dyta në shqipen e sotme nuk janë ndajfolje; ndërkaq, megjithëse procesi i paranyjëzimit të pjesoreve vazhdon edhe sot e gjithë ditën, d.m.th. ka raste që edhe sot përdoret forma pjesore e panyjëzuar formalisht, por funksioni i saj është po ai që do të ishte, po të ishte e nyjëzuar, kjo formë në këto raste mund të merret si pjesore (për arësyet që do të shtjellohen më poshtë), por me një farë rezerve; përderisa format *lum* etj. janë «mbiemra pa artikull», atëhere edhe «trajtat pa artikull» si *shëndoshë* që u korespondojnë mbiemrave latinë në përkthimet e Buzukut, në shqipen e sotme nuk kanë vlerë ndajfoljesh. Si përfundim përderisa format *lum* etj. me kuptim e funksion mbiemëror ekzistojnë edhe sot e gjithë ditën, si në gjuhën e folur ashtu edhe në të shkruarën dhe quhen «mbiemra pa artikull», mendimi i Boppit është i drejtë edhe për rastet në fjalë të shqipes bashkëkohore.

Dihet se ndarja e pjesëve të ligjëratës në bazë të kategorive gramatikore përbën një problem mjaft të ndërlikuar në vetvete e kushtëzohet nga më se një faktor: megjithatë tre faktorët e parë e kryesorë që parashtron Vinogradovi janë këta: 1) Ndryshimet e atyre funksioneve sintaksore që plotësojnë kategoritë e ndryshme të fjalëve në ligjërimin e lidhur, në strukturën e fjalisë; 2) ndryshimet e ndërtimit morfologjik të fjalëve dhe formave të fjalëve; 3) ndryshimet e kuptimeve sendore (leksikore) të fjalëve<sup>32</sup>.

Pra thelbësorë janë këta tre faktorë: *kuptimi, funksionet sintaksore dhe karakteristikat morfologjike*<sup>33</sup>.

Dihet gjithashtu që kategoria e pjesëve të ligjëratës është kategori *leksiko-gramatikore*, pra nuk merren parasysh vetëm karakteristikat gramatikore e aq më pak vetëm ato morfologjike, por kihen parasysh lidhjet gramatikore dhe format gramatikore që karakterizojnë fjalën e jo format e saj.<sup>34</sup> Por, përderisa klasifikimi në pjesë të ligjëratës është një klasifikim fjalësh e jo formash, atëhere kuptimi i këtyre fjalëve nuk mund të mos lozë një rol të rëndësishëm në këtë klasifikim — bile që në formimin historikisht të pjesëve të ligjëratës e deri në ekzistencën e tyre të sotme. Të nisesh vetëm nga tiparet morfologjike ose vetëm nga ato sintaksore është një gabim i madh, sepse siç vërejnë Shçerba dhe Smirnicki «emri është emër jo sepse lakohet, por përkundrazi ai lakohet, sepse është emër»<sup>35</sup>.

Në bazë të ndarjes së një pjese çfarëdo të ligjëratës qëndron të shënuarit e sendeve dhe fenomeneve reale të realitetit, prandaj ndryshimet *gramatikore* midis pjesëve të ligjëratës bëhen në bazë të ndryshimeve *reale* që ekzistojnë realisht në natyrë (kjo vlen në radhë të parë për fjalët emërtuese). Sipas Smirnickit «thelbi i ndryshimit të pjesëve të ligjëratës përfshihet në ndryshimet në semantikën e tyre të përgjith-

31) Po aty, 89.

32) V. V. Vinogradov, *Russkij jazyk*, Moskva, 1947, 38.

33) Shih: V. L. Kanshanskaja etj.; A. Grammar of the English language, 13.

34) Shih edhe I. A. Smirnickij, *Leksiceskoe igrammaticeskoe v slove*, «Voprosy grammatičeskogo stroja», Moskva, 1955, 19.

35) I.A. Smirnickij, *Morfologija anglijskogo jazyka*, Moskva, 1959, 102.

shme»<sup>36</sup>. Në karakteristikën e përgjithshme gramatikore të pjesëve të ligjëratës «tiparet morfologjike (...) dhe veçoritë sintaksore (...) lozin gjithashtu një rol të rëndësishëm. Por ana sintaksore është më e përgjithshme dhe zë vendin e parë në karakteristikën gramatikore të fjalës. Kjo lidhet me faktin që në planin morfologjik as për së largu jo që të gjitha kategoritë e fjalëve janë dalluar mjaft qartë nga njëra-tjetra, ndërsa sintaktikisht ato dallohen gjithmonë plotësisht prerë»<sup>37</sup> (kh. lidhur me këtë ndryshimin midis disa parafjalëve dhe ndajfoljeve, ndajfoljeve e lidhëzave ose ndajfoljeve dhe formave reliktove të mbiemrave që po shqyrtojmë — këto fjalë dalin si kategori të ndryshme, kanë kategori të ndryshme morfologjike, pikërisht në planin sintaksor). E këtu na duket me vend vërejtja e Shçerbës që «ne ndodhemi nën hipnotizimin e formave morfologjike, kurse gjuha ka... të tilla mjete shprehëse, me të cilat u shpëton formave morfologjike»<sup>38</sup>. Në bashkohemi me parimin që pikërisht përdorimi sintaksor i fjalëve bëri e, rrjedhimisht, bën të mundur formimin e pjesëve të ligjëratës; në fjali — e jo në vetvete e për vetvete — shfaqen marrëdhënjet e format e fjalëve<sup>39</sup>.

Nga të gjitha këto që thamë del se në përcaktimin e një pjese të ligjëratës rol thelbësor lozin ana *semantike* dhe *lidhjet sintaksore* të saj e pastaj forma morfologjike<sup>40</sup>, e cila të shumtën e herës në gjuhë flektive si shqipja u vjen në ndihmë dy të parave me mjete kaq të qarta, sa e bën të tepërt analizën e hollësishme të tyre (por me këtë errësim të jashtëm, formal nuk duhet menduar se dy faktorët e parë pushuan së qeni themelorë për pjesën e dhënë të ligjëratës).

Po të marrim në shqyrtim fjalët e nënvizuara në fillim (a), menjëherë bie në sy që ato shprehin një tipar të pamvetësishëm. Ky tipar gjithmonë presupozon një emër, pra i përket sendit, ekziston tek sendi — këtu gjithë kohën si të ishte i padukshëm ekziston mendimi për sendin, bartësin e tiparti të shënuar nga këto fjalë. Por të gjitha këto nuk janë gjë tjetër veçse veçori karakteristike të mbiemrit. Në qoftë se analizojmë shembëllat: As na këndonin një këngë, o djem të rinj, të ndjehemi të *gjallë* (K. Kristoforidhi, Gjaja, 16); Sot burrat... bëjnë një vesh të *shurdhër* e një sy *qorr* (V. Vinçani, Lumturia, 36), *Shtëpi e shurdhët* (Fjalori i gjuhës shqipe, T, 1954, 551) dhe: Të gjithë ishin me ty... ndërsa ti bëre veshët *shurdhër*, mbylle sytë (N. Jorgaqi, DeM, 204); na la *shurdh* (Fjalori i gjuhës shqipe, T., 1954) — detyra jonë e parë është të zbulojmë, nëse kemi të bëjmë me karakterizimin e veprimit, të shprehur nga folja, apo të bartësit të veprimit të shprehur nga emri. Folja

36) Po aty, 103.

37) Po aty. Ndoshta autori e ka tepëruar pak, kur nënvizon se sintaktikisht fjalët dallohen gjithmonë plotësisht prerë, por megjithatë ne na duket me vend tërheqja e vëmendjes mbi anën semantike dhe sintaksore të fjalës, mosabsolutizimi i formës së saj.

38) L.V. Shçerba, *Izbrannye rabety po jazykoznaniju i Fonetike*, Tom I, Leningrad, 1958, 101.

39) Shih edhe: L.A. Korobcinskaja, *K. diskussii o kategorii sostojaniya* «Voprosy russkogo jazykoznanija», 4/1960, 29.

40) Ky pretendim duket si i padrejtë e si i tepërt, sepse në gjuhët që kanë forma e karakteristika të veçanta morfologjike, gjithshka bëhet e qartë që në vështimin e parë, por megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk qëndrojnë në plan të parë semantika dhe lidhje sintaksore, por, siç shprehet Smirnicki «sistemi i përbërë morfologjik sikur e mbulon anën sintaksore» (*vepër e cit.*, 104). Drejtësia e këtij parimi vërtetohet pikërisht tek ato fjalë që nuk kanë tipare të mjaftueshme morfologjike për të bërë klasifikimin e tyre në pjesë ligjërate.

karakterizohet nga ndajfolje, që tregojnë rrethanat, në të cilat kryhet veprimi, mënyrën si kryhet ai, apo tiparin e atij veprimi, kurse këtu, si në fjalitë e para, ashtu edhe në të dytat, është sendi që fiton një tipar të caktuar e jo veprimi. Dhe në të dy këto grupe shembullash (të *shurdhër* — *shurdhër*) kuptimi dhe marrëdhënjet sintaksore janë po ato, gjithë ndryshimi qëndron në shfaqjen e jashtme, eksplicifikimin formal të kategorialitetit mbiemëror për të përjashtuar mundësinë e interpretimit si kategori ndajfoljore, pra, tek paranyjëzimi. Për mendimin tonë paranyjëzimi ka ardhur nga njëra anë për efekt theksimi të fjalës mbiemërore e nga ana tjetër, siç vëren me të drejtë E. Çabej, pikërisht për të ridiferencuar nga njëri-tjetri mbiemrin dhe ndajfoljen, të cilët si pasojë e humbjes së mbaresave të vjetra fleksionale u bënë të barabartë nga forma<sup>41</sup>.

Përsa i përket grupit të dytë (b), meqenëse është një tezë e pranueshme që pjesorja shpreh fare mirë edhe tipar të sendit (pra, është gjysmë folje, gjysmë mbiemër), mendojmë se sa herë që shfaqet e panjësuar, megjithëse karakterizon një send e nuk shpreh proces, mund të merret si pjesore, për më tepër sepse një fenomen i tillë është mjaft i gjallë në gjuhën shqipe (si edhe në gjuhë të tjera) dhe nuk mund të quhet fenomen reliktor për strukturën morfologjike të saj, por, megjithatë, duhet të shënohet këtu që funksioni e semantika mbiemërore e kësaj forme në rastet e dhëna më sipër janë të qartë.

Sa për pyetjen skolarese që bëhet në këto raste: *Si erdhi? Si mbeti?* etj. Kjo s'ka asnjë rëndësi, sepse edhe në rastet e mbiemrave të zakonshëm bëhet e njëjta pyetje (kh. Ai mbeti *gjallë* dhe: Ai mbeti *i gjallë* — në që të dy rastet pyetja shtrohet: *Si mbeti ai?*).

Pra, për të kuptuar, për ta zbuluar që kjo fjalë shpreh tipar të sendit dhe jo të veprimit, ne duhet të nisemi detyrimisht nga lidhjet sintaksore — karakterizohet një proces apo një send a fenomen, çfarë lidhjesh kemi? Në rastin e parë kemi ndajfolje mënyre a cilësie (kh. ai flet *mirë*, ai flet *hapët*, ai flet *qartë*, ai këndon *ëmbël* etj.); kurse në rastin e dytë kemi formë relikore të mbiemrit sot zakonisht të nyjshëm, d.m.th. mbiemër pa nyjë (kh. mbarë shembëllat e mësipërme). Në rastin e fundit kemi ose pjesë të domosdoshme të kallëzuesit emëror (kur kemi foljen këpujë *jam*), ose plotës kallëzuesor të kryefjalës prkt. të kundrinës, që në fakt është përsëri pjesë e domosdoshme e kallëzuesit; pa të e gjithë fjalia nuk është fjali, kurse ndajfolja në rastet e porsapërmendura përkundrazi është si gjymtyrë fjalie, vetëm një përcaktues më i afërm për foljen, po të mungojë ajo, fjalia prapësepapë mbetet. Në qoftë se kemi gjithmonë parasysh këtë fakt, atëherë për mendimin tonë nuk duhet të na bëjë të lëkundshëm fakti që në disa raste forma e dhënë transformohet me vështirësi e bile mund të jetë e patransformueshme edhe formalisht në një mbiemër; rëndësi ka fakti që edhe «gjendja» e shprehur nga kjo fjalë është një tipar që i përket sendit të përcaktuar prej saj e jo veprimit dhe mbiemri mund të shprehë fare mirë edhe gjendje të sendit që karakterizon, për më tepër ne mendojmë se gjendja në një vështrim të gjerë mund të kundrohët si tipar cilësor i sendit të dhënë. Këtu do të hynin pra raste të diskutueshme si: *Mirpo nga fishekët e ndjenin veten hollë* (A. Mara, Shtëpia, 18); *Që kur u martua shtëpinë e burrit e gjeti hollë* (Z. Sako, Bereqeti, 39); *Leka u gjend*

41) E. Çabej, *Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund*, në «*vep. e cit.*», 62.

*ngushtë* (M. Myftiu, Leka, 7); Përtaci mbetet *urëtë* (S. Frashëri, Abetare, 43) etj.

Pikërisht këtu meriton të shënohet edhe fakti se është plotësisht e vërtetë që duke vazhduar për një kohë kaq të gjatë e bile edhe sot e gjithë ditën të bashkekzistojnë krahas njëra-tjetrës forma e paranyjëzuar dhe forma e paparanyjëzuar, kjo e fundit në mjaft raste largohet kuptimisht mjaft prej së parës, pra, jo gjithmonë përmban vetëm ndryshime të imta, të kondicionuara stilistikisht, kështu p.sh. *bukë thatë* dhe *bukë e thatë* nuk janë sinonimike, por këtu i rëndësishëm mbetet vetëm fakti që përmendëm më sipër, që kjo fjalë të tregojë një tipar të sendit të dhënë e jo të veprimt dhe jo, nëse kjo fjalë është sinonimike me mbiemrin përgjegjës apo jo. Pra ajo që i dallon qartë këto fjalë nga ndajfoljet është fakti që këto nuk përdoren në varësi nga folja. Tipari themelor semantik e sintaksor i tyre është shprehja e një tipari (qoftë edhe gjendje) të sendit e jo të proceseve dhe përdorimi kryesisht si plotës kallëzuesor e rrallë si përcaktor atributiv.

Që këto fjalë duhen analizuar kështu, mjafton të hedhim një vështrim në dy gjuhë të huaja — nga njëra anë në gjermanishten, ku në funksionin kallëzuesor mbiemri ka gjithmonë formë të pandryshueshme e të njëjtë me të ndajfoljes, dhe nga ana tjetër në rusishten, e cila format mbiemërore i ka të diferencuara qartë nga format ndajfoljore.

Në gjermanishten: Er spricht *offen* «ai flet hapur»; Er spricht *gut* «ai flet mirë»; Sie lernt *gut* «ajo mëson mirë» etj. (të gjitha rastet kanë vlerë ndajfoljore) dhe: Sie ist *gut*, «ajo është e mirë»; Er ist *schön*: «ai është i bukur»; die Tür bleibt *offen* «dera mbetet hapur (e hapur)»: wir sind *gesund*, «ne jemi shëndosh (të shëndoshë)» etj. (të gjitha rastet kanë vlerë mbiemërore).

Në rusishten: On govorit *otkryto* «ai flet hapët (hapur)»; my *zdorovo* porabotali «ne kemi punuar shumë mirë»: ona mne *zhivo* napolinaet mat «ajo më kujton në mënyrë të gjallë nënën» (të gjitha rastet kanë vlerë ndajfoljore) dhe дверь *ostalozh otkrytoj* «dera mbeti hapur (hapët, e hapur)»: budzte *zdarovy* «qofshi shëndoshë»: on byl ishçjo *zhiv* «ai ishte ende gjallë (i gjallë)».

Duhet pasur parasysh që edhe në shembëllën «jam *mirë*», vërtet *mirë* është ndajfolje, por në fakt një gjë e tillë është një veçori idiomatike e disa gjuhëve (shqipes, italishtes, anglishtes), sepse dihet që folja *jam* për vetë semantikën e saj nuk duhet të merrte përcaktues ndajfoljorë cilësorë e mënyrorë, por vetëm mbiemërorë.

Por duhet vërejtur se në përgjithësi mbiemrat, edhe kur nga forma janë pa diskutim të tillë, në rolin e predikativit përcaktues dallohen nga një lidhje veçanërisht e ngushtë me foljen në krahasim me mbiemrat përcaktorë atributivë. Këta në thelb hyjnë në dy lidhje, në dy funksione sintaksore: të predikativit përcaktues të emrit që shpreh sendin dhe të foljes që shpreh veprimin. Ky funksion i fundit dhe pandryshueshmëria e formës për rastet në diskutim, mungesa e nyjës së përparme, errëson në vështrimin e parë realitetin, shfaqjen e tiparit të sendit nga këto fjalë. Edhe H. Pauli thekson se «midis predikativit dhe atributit ka diçka të ndërmjetshme që ne e quajmë atribut predikativ, kh. *er kam gesund an* «ai mbririti shëndoshë». Atributi predikativ ka të bëjë me subjektin, por ai ka edhe një lidhje me predikatin dhe në radhë të parë një lidhje kohore; ai tregon gjendjen në të cilën ndodhet subjekti në atë kohë në të cilën i vendoset ai predikat. Nëse kjo gjendje ka ekzistuar edhe më parë apo shfaqet së pari në momentin përkatës, kjo nuk bën asnjë ndry-

shim në formën e shprehjes»<sup>42</sup>. Në këtë funksion mbiemrat i quajnë edhe «mbiemra gjysmëpredikativë» (Halhpredikative Adjektive) që shërbejnë për përcaktimin e subjektit e të foljes<sup>43</sup>.

Këto forma reliktoze mbiemrash numerikisht nuk janë aq të pakta. Sidomos disa prej tyre, si *gjallë, shëndoshë, sëmurë, urët, kuq, bardhë, verdhë* dhe përsëritjet e këtyre tri të fundit etj., njohin vetëm kuptim e funksion mbiemëror në mbarë përdorimin e tyre, kurse mjaft të tjera në përdorime të caktuara funksionojnë edhe si ndajfolje. Megjithatë përdorimi i tyre është i kufizuar vetëm si pjesë përbërëse të kallëzuesit emëror ose si plotës kallëzuesorë të kryefjalës prkt. të kundrinës, pra përdorimin si caktuesorë, si epitete, nuk e njohin e si të tilla nuk njohin edhe mundësinë për t'u substantivuar. Nuk pësojnë asnjë ndryshim në formën e tyre, gjë që i barazon për nga forma, me ndajfoljet. Pra, janë reliktoze, sepse struktura e tyre pa një të përparme dhe pa mbaresa gjinore dhe numri nuk përbën më rregull në morfologjinë shqipe; këtyre mbiemrave u është gjymtuar potencialiteti i transformimit gramatikor dhe nuk mund të substantivohen; si rregull këta nuk e njohin funksionin caktuesor, por megjithatë hasim: Nëna i dëgjonte me gojë *hapët* (Q. Guranjaku, Tetë ditë, 97); Mbeti jetim me baba *gjallë* (populli). Sipas mendimit tonë, këta togfjalësha janë pikënisja për ekzemplarët e parë të kompozitave mbiemërore të tipit bahuvrihi e pastaj, për analogji me këto, tipi u përhap gjerësisht.

Në vështrimin historik ne e shikojmë kështu zhvillimin e këtij fenomeni: në krye të herës kanë ekzistuar dy pjesë të mvetësishme të ndryshme të ligjëratës, ndajfolje cilësore e mbiemra, që përputheshin midis tyre vetëm për nga tema prodhuese (nga trupi i tyre), por mbiemri (ndoshta edhe ndajfolja) kishte mbaresa të caktuara përkatëse. Për arësye të ndryshme e të panjohura ndodhën ndryshime që çuan në përputhjen formale të këtyre ndajfoljeve me këta mbiemra, pra ranë mbaresat që i dallonin<sup>44</sup> dhe kështu e njëjta formë, që në fakt përfaqësonte dy fjalë, dy kategori gramatikore, mbeti përfaqësuesja e vetme gramatikore e leksikore. E për të dalluar se me cilën kategori kishim e kemi konkretisht të bëjmë në kontekstin e dhënë erdhi e vjen edhe sot në ndihmë semantika dhe funksioni sintaksor. Një fenomen identik ka ndodhur edhe në gjermanishten<sup>45</sup>, ku sot ndajfolja cilësore nuk ka asnjë ndryshim formal nga mbiemri korespondues në funksion kallëzuesor.

Si përfundim thënia e Boppit që ndajfoljet «sa kohë që këto rrjedhin prej mbiemrash nuk janë të ndryshme prej tyre në formë» duhet vlerësuar kështu: Përsa u përket mbiemrave të parashtruar më lart është e drejtë e d h e p ë r s h q i p e n e s o t m e q ë ata për nga forma nuk ndryshojnë nga ndajfoljet përgjegjëse; por thënia e mësipërme është e pasaktë, sepse sipas mendimit tonë në rastet në diskutim nuk ka ndajfolje të prejardhura nga mbiemrat e as mbiemra të prejardhur nga ndajfoljet, por, siç thamë, është e njëjta fjalë (historikisht e prejardhur nga dy fjalë të ndryshme me temë të njëjtë) që u përdor në rrjedhën e kohës në dy funksione të ndryshme.

42) H. Paul, *Deutsche Grammatik*, III, Halle (Saale), 1956, 15.

43) J. Knobloch, *Sprachwissenschaftliches Wörterbuch*, Heidelberg, 1961, 39.

44) Një mendim të tillë ka shprehur para nesh edhe E. Çabej në artikullin e cituar më lart (Beitrag, 62-63).

45) Shih: A. I. Nikolaeva, *Iz istorii kačestvennogo narečija i prilagatel'nogo v gruppe glagola*, «Voprosy istopii i grammatiki romano-germanskih jazykov», Vyp. 50/1958, 176 v.

**Shënim:** Një problem më vete e mjaft të vështirë përbën përdorimi i fjalëve të tilla në raste kur sendi i karakterizuar prej tyre nuk është as i shprehur as i nënkuptueshëm dhe në bashkëvjajtje me folje pavarore, në fjali të pavarura ose që drejtojnë fjali kryefjalore prkt. kundrinore, p.sh. Kështu malësorët tanë e patën *keq* ato ditët e para (J. Rrota, Rreth, 26); Më vinte *keq* për të që e vinja në këtë provë (N. Sinaeri, Kokrra, 45); Tani në fillim do të të dhëmbë pak... pastaj do ta kesh më *lehtë* se vendi do të mpihet vetvetiu (N. Prifti, Një pushkë, 15); ndoshta s'do të qe *keq* që nesër të niseshe vetëm unë (I. Kadare, Gjenerali, 80); Por nuk ishte *lehtë* të bëhej kjo letër (po aty — 38); Po që ta thuash këngën s'është *lehtë* (M. Xhaxhiu, Lirika, 88); *Bukur* do të qe sikur të ishte Drita ajo që nuk do të dinte se kush është Tarasi (Sh. Musaraj, Para, II, 366); Ata të dy e kishin *vështirë* t'i flisnin Malait për atë (T. Laço, Rruga, 95) etj. Diakronikisht edhe këtu ne mendojmë se kemi pasur mbiemra, por, nëse duhet pranuar kjo edhe për shqipen e sotme kjo është e vështirë të pohohet.

## VEPRAT LETRARE TË PËRMENDURA DHE SHKURTIMET E TYRE

- 1) A. Cerga: Mëngjez — Agim Cerga: Mëngjez i largët — Nëndori, 9, Tiranë, 1965.
- 2) A. Banushi: Rrugë — Aleksandër Banushi: Rrugë të ndrituna, Tiranë, 1955.
- 3) A. Abdihoxha: Tri, I, — Ali Abdihoxha: Tri ngjyra të kohës, vëll. I, Tiranë, 1965.
- 4) A. Kristo: Fabula — Alqi Kristo — Fabula, Tiranë, 1955.
- 5) A. Mara: Shtëpia — Andon Mara: Shtëpia e xha Milit, Tiranë, 1955.
- 6) Çajupi — Baba — Çajupi: — Baba Tomorri, Tiranë, 1950.
- — Përralla — Pralla të zgjedhura, Tiranë.
- 7) D. Agolli: — Në rrugë — Dritëro Agolli: — Në rrugë dolla, Tiranë, 1958.
- Zhurma — Zhurma e erërave të dikurshme, Tiranë 1965.
- 8) F. Noli: — Don Kishoti — Fan Noli: — Don Kishoti (përkthim), Boston, 1932.
- Hes — Historia e Skënderbeut 1921-1962.
- 9) F. Gjata: — Fatmir Gjata: — Tana, Tiranë, 1958.
- 10) F. Ndocaj: Vlagë — Filip Ndocaj: Vlagë dheu, Tiranë, 1968.
- 11) Folklor I, IV, II — Folklor shqiptar I Proza Popullore, Tiranë 1966.
- 12) G. Kongoli: Vajza — Gazmend Kongoli: Vajza me vathë të kuq, Tiranë,
- 13) Gj. Zheji: Tregimet — Gjergj Zheji: Tregimet e Krujës, Tiranë 1967.
- 14) Gjë e gjëza — Gjë e gjëza, Tiranë, 1968.
- 15) H. Mosi: — Cubat — Hile Mosi: — Cubat, Tiranë, 1915.
- Lule — Lule Prendvere, Tiranë 1927.
- 16) I. Kadare: — Gjenerali — Ismail Kadare — Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963.
- Përse — Përse mendohen këto male (vëllimi, Tiranë, 1964).
- Shekulli — Shekulli im, Tiranë, 1961.
- 17) I. Zamputi: Atje — Injac Zamputi: Atje, nën hijen e Rozafës, Tiranë, 1944.
- 18) J. Xoxa: Lumi, I,II,III — Jakova Xoxa: Lumi i vdekur, I,II,III, Tiranë 1965.
- 19) J. Rrota: Rreth — Justin Rrota: Rreth votrës, Shkodër, 1945.
- 20) Këngë Popullore historike, Tiranë, 1956
- 21) K. Jakova: Qielli — Kolë Jakova: Qielli i kuq (kritikë letrare), Toka jonë, Tiranë 1955.
- 22) K. Kristoforidhi: Dhiata — Kostandin Kritoforidhi: Gjaja e Malësorëvet, Tiranë, 1950.
- 23) K. Floqi: Kundërshtarët — Kristo Floqi: Kundërshtarët e prikës, Shkodër, 1922.
- 24) Lipi: Fatbardhi — Lipi (Filip Papajani): Fatbardhi, Korçë, 1934.
- 25) Ll. Siliqi: — Mësuesi — Lllazar Siliqi — Mësuesi, Tiranë, 1955.
- Rruga — Rruga e lumtunis, Tiranë, 1950.
- 26) M. Gurakuqi: Gjeto — Mark Gurakuqi: Gjeto Plaku, Tiranë. 1955.

- 27) Të Fejuemit — Të fejuemit (përkthim), Shkodër, 1941.  
 28) Mbledhës, I,II,III — Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vëll. I-1961 vëll. II-III, 1962.  
 29) M. Myftiu: Leka — Mehmet Myftiu: — Leka, Tiranë 1960.  
 30) M. Kallamata: — Gjëmbat — Miço Kallamata: — Gjëmbat e trandafilët Tiranë, — Shokë — Shokë lufte, Tiranë, 1962.  
 31) Migjeni: Novelza — Migjeni: Novelza, Tiranë 1936.  
 32) M. Kuteli: — Kapllan — Mitrush Kuteli: — Kapllan Aga i Shaban Shpatës, Tiranë, 1944.  
 — Netë — Netë shqiptare, Tiranë, 1944.  
 33) N. Frashëri: — Hes — Naim Frashëri — Histori e Skënderbeut, Korçë, 1923.  
 — Iliadhë — Iliadhë e Omirit, Bukuresht, 1896.  
 — Lulet — Lulet e verës, Korçë.  
 34) N. Jorgaqi: Ëndra — Nasho Jorgaqi: Ëndra e plagë, Tiranë, 1963  
 — DeM — Dashuria e Mimoszës, Tiranë, 1960.  
 35) N. Prifti: — Lëkura — Naum Prifti: — Lëkurë e ujkut, Tiranë, 1958  
 — Një pushkë — Një pushkë më shumë, Tiranë 1966.  
 36) Nd. Mjeda: — Lissus — Ndre Mjeda: — Lissus, Poezia shqipe, I, Tiranë, 1965.  
 — Vjersha — Vjersha dhe poema, Tiranë, 1953.  
 37) N. Sinaeri: Kokrra — Nella Sinaeri: Kokrra aguridhe, Tiranë 1959.  
 38) Q. Buxheli: Rrugë — Qamil Buxheli: Rrugë të tërthorta, Tiranë, 1966.  
 39) Q. Guranjaku: Tetë ditë — Qamil Guranjaku: Tetë ditë pa bukë, Tiranë 1959.  
 40) S. Frashëri: — Abetare — Sami Frashëri: — Abetare e gjuhës shqipe, Bukuresht, 1886.  
 — Shqipëria — Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet, Tiranë 1962.  
 41) S. Çomora: — Karnavalet — Spiro Çomora: — Karnavalet e Korçës, — Drama, Tiranë, 1964.  
 42) S. Spasse: — Afërdita — Sterjo Spasse: — Afërdita përsëri në fshat, Tiranë 1956.  
 përsëri  
 43) Sh. Musaraj: — Shefqet Musaraj:  
 — Para, I,II — Para agimit, I, II, Tiranë, 1965.  
 — Të shkuara — Të shkuara të paharruara, Tiranë, 1957.  
 44) T. Laço: Rruga — Teodor Laço: Rruga e bardhë, Tiranë, 1967.  
 45) V. Vinçani: Lumturia — Vandush Vinçani: Lumturia, Tiranë, 1965.  
 54) V. Kokona: Me valet — Vedat Kokona: Me valët e jetës, I, Tiranë, 1961.  
 55) Z. Sako: Bereqeti — Zihni Sako: Bereqeti, Tiranë, 1951.

## R é s u m é

### QUESTIONS DE CLASIFICACION MORFOLOGIQUE DES ADJECTIFS EN ALBANAIS LITTERAIRE CONTEMPORAIN

Les adjectifs de l'albanais se divisent en deux grands groupements: a) adjectifs pourvus d'article prépositif; b) adjectifs dépourvus d'article prépositif. Les adjectifs pourvus d'article prépositif constituent le type fondamental et plus ancien des adjectifs de l'albanais et tirent leur origine de la préarticulation des adjectifs primitifs: mirë, keq > i mirë, i keq. Par la suite, cette classe est allée continuellement s'enrichissant par de nouvelles formations au moyen de la suffixation d'autres mots non adjectivaux (i sotëm, i nesërm, i sjellshëm, i ndërgegjshëm, i hekurt, i artë, etc.), ou seulement à l'aide d'articles prépositifs ajoutés aux mots non adjectivaux (i shumë, i pakë, i punuar, i sorrë, etc.).

Les adjectifs dépourvus d'article prépositif représentent une formation plus tardive par rapport à ceux pourvus d'article, et ils ont pris naissance par l'usage appositionnel des noms qui représentaient notamment des porteurs des différentes qualités ou des noms d'action.

Par conséquent, dans les mots du type fshatar, trim, plak, dibran, fitimtar, fajtor, punëtor, etc., où se manifestent deux catégories grammaticales: la catégorie nominale et la catégorie adjectivale, on doit admettre comme primaire la catégorie nominale et comme secondaire la catégorie adjectivale.

Le défaut de l'article prépositif chez les adjectifs dépourvus d'article prépositif ne peut être expliqué ni par la thèse qu'au commencement ces mots avaient représenté uniquement des appositions et non point des déterminants attributifs, et non plus aussi par l'autre thèse d'après laquelle l'article est l'équivalent du suffixe («l'article=suffixe»; c'est-à-dire que le service morphologique est accompli par le suffixe), mais par le fait que ces mots, tout en remplissant la fonction adjectivale, ont continué d'appartenir en essence aussi au système nominal, ce qui rendait impossible la manifestation de cet article. Cela explique parfaitement la raison pourquoi de tels mots comme trim, plak, etc., connus comme adjectifs dans les temps assez lointains, sont restés encore de nos jours dépourvus d'article prépositif. Il est de toute évidence qu'en analogie avec ces adjectifs primitifs dépourvus d'article prépositif (provenant par conversion des noms correspondants) sont formés plusieurs adjectifs dépourvus d'article proprement dits (leshtor, ushqimor, pyjor, etc.).

Chez les types «O mikziu të më dije» on a affaire à une universion qui provient d'une extériorisation emphatique, populaire, caractéristique pour quelques adjectifs d'acception lexicale affective.

Dans le génitif-datif, pour les exemples du genre: Nata në Shëndre si motra e gruas ve, on a, — comme le fait remarquer G. Meyer, — une absence seulement «apparente» de l'article préposé de l'adjectif (Isël ve), étant donné qu'il est identique à l'article postposé du nom (gruas) et finit par se fondre avec ce dernier. Cela arrive non seulement au génitif-datif, mais aussi au nominatif, et même au locatif.

A l'état actuel de l'albanais, comme adjectifs pourvus d'article préposé, on a:

- a) tous les adjectifs «matériaux» (en anglais: material adjectives) formés à l'aide du suffixe -t(ë);
- b) tous les adjectifs dérivés des adverbes;
- c) tous les adjectifs départicipiaux dépourvus de suffixe;
- d) tous les adjectifs formés à l'aide des suffixes -shëm, -(ë)m.

Dépourvus d'article sont:

- a) tous les adjectifs possessifs et matériaux formés à l'aide du suffixe -or.
- b) tous les adjectifs déverbatifs (provenant du participe ou du présent du verbe) formés à l'aide du suffixe -(ë)s.
- c) tous les adjectifs composés.

Un groupement à part sont les formes reliques des adjectifs pourvus actuellement d'article prépositif (gjallë, shëndoshë, kuq, njomë, bardhë, etc.). En cela on doit partir de la sémantique et de la fonction syntaxique de ces mots, du fait que leur forme inchangeable estompe leur essence, camoufle leur appartenance à la catégorie adjectivale. De là il ressort que l'affirmation de F. Bopp que «les adverbes ne diffèrent pas des adjectifs» est juste pour ces cas non seulement pour l'albanais ancien, mais aussi pour l'albanais contemporain. Pourtant, ce n'est pas juste ni

*l'opinion que les adverbes proviennent des adjectifs respectifs, ni celle contraire que les adjectifs proviennent des adverbes correspondants.*

*A notre avis, ni l'une ni l'autre catégorie de mots n'est formée par la catégorie correspondante, mais on doit y avoir eu deux catégories différentes et indépendantes de mots, lesquelles, au cours des âges, ont été simplifiées et identifiées, et, comme aboutissement, la même forme est devenue la représentante unique des deux catégories différentes l'une de l'autre.*

*Ces formes nous les appellerons des reliques, du fait que leur structure dépourvue d'article préfixé et de désinence de genre et de nom ne constitue plus une règle pour la morphologie albanaise. D'autre part, à ces mots a été amputée aussi la puissance de transition grammaticale et ne peuvent être substantivés. Ainsi, de règle, ils ne connaissent point l'usage comme épithètes (sauf quelques exceptions).*

*Quant aux participes, lesquels, dans les cas respectifs, au point de vue sémantique et fonctionnel sont analogues avec leurs formes correspondantes à articles prépositifs, nous croyons qu'ils peuvent être rangés dans les participes, parce qu'il est parfaitement admissible que le participe exprime aussi un trait de l'objet. D'autre part, un tel phénomène, un tel mode de caractérisation est assez vivant en albanais (comme dans d'autres langues d'ailleurs) et il ne constitue donc pas un phénomène relique pour la structure morphologique de l'albanais.*

